



**KONTRROLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në subjektin Prefektura**  
**Qarkut Fier**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**(Auditim përputhshmërie)**

**Tiranë, tetor 2024**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>3 – 8</b>
1.	<i>Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....</i>	
2.	<i>Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....</i>	
3.	<i>Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....</i>	
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	<b>8 – 12</b>
1.	<i>Objektivat dhe qëllimi .....</i>	
2.	<i>Identifikimi i çështjes.....</i>	
3.	<i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese .....</i>	
4.	<i>Përgjegjësitë e audituesve.....</i>	
5.	<i>Kriteret e vlerësimit.....</i>	
5.	<i>Standardet e auditimit.....</i>	
7.	<i>Metodat e auditimit.....</i>	
8.	<i>Dokumentimi i auditimit.....</i>	
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI AUDITIMIT</b>	<b>12 – 71</b>
1.	<i>Informacion i përgjithshëm mbi subjektin .....</i>	12 – 14
2.	<i>Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit</i>	<b>14 – 71</b>
2.1	<i>Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.</i>	14 – 38
2.2	<i>Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit periudha 2022 - 2023.</i>	38 – 50
2.3	<i>Mbi verifikimin e ligshmërisë së vendimeve, urdhrave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, viti 2022-2023</i>	50 – 71
<b>IV</b>	<b>GJETJE DHE REKOMANDIME</b>	<b>71 – 82</b>
<b>V</b>	<b>ANEKSE</b>	<b>82 – 87</b>

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.**

### **a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:**

Prefektura Qarkut Fier, është një institucion qendrorë në nivel vendor i cili funksionon në zbatim të Ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut” dhe akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e administratës shtetërore dhe nëpunësve civil. Misioni i prefektit është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave në nivel qarku. Prefekti për veprimtarinë e vet përgjigjet përpara Këshillit të Ministrave, Kryeministrit dhe Ministrave.

Për periudhën e audituar (01.01.2022 – 31.12.2023), menaxherët kryesorë të Institucionit të Prefektit Fier sipas nivelit të organizimit janë: ish- Prefekti L.SH deri datë 22.12.2023, në cilësinë e *Nëpunësit Autorizues* dhe S.Ç, me detyrë Përgj/Sektorit të Financave..., në cilësinë e *Nëpunësit Zbatues*.

Raporti i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejttimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

### **b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.**

Rëndësia e auditimit të përputhshmërisë të Prefektit të Qarkut Fier për periudhën e aktivitetit 2022 - 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor, konsiston dhe në kontrollin e përdorimit sa më efektiv e transparent të fondeve të akorduara, të burimeve në përdorim të këtij institucioni, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe të ndihmojë nëpërmjet rekomandimeve të dhëna për përmasimin e sistemeve.

Pra prefekturat janë subjekt i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien dhe administratës publike.

### **c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:**

Qëllimi është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me përdorimin e fondeve publike dhe verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Prefektura e Qarkut Fier funksionon në bazë Ligjit nr. 107/2016 datë 27.11.2024 “Për Prefektin”; Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, akteve ligjore/nënligjore dhe rregullores së brendshme.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.*
- *Auditim mbi zbatimin e procedurave të prokurimit periudha 2022 – 2023*
- *Auditim mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, viti 2022 – 2023.*

### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.**

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit.* Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi

përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 696 mijë lekë (*sipas Aneksit 1 bashkëlidhur RPA*), i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

#### **e. Paraqitja e gjetjeve kryesore.**

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, për periudhën nënauditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, duke evidentuar 18 gjetje për masa organizative dhe dhënë 18 rekomandime, si vijon:

##### *Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit:*

- Nuk ka të dokumentuar kërkesat për nevojat buxhetore nga secili sektor. PBA-të dhe Plani vjetor hartohen duke u mbështetur në realizimin e zërave buxhetorë të dy viteve pararendëse;

- Ka diferenca të vlerave të PBA-ve dhe të Projektplaneve vjetore si në raport me planin fillestar ashtu edhe me atë të ndryshuar, që në gjykimin e grupit të auditimit tregon për planifikim jo të studiuar të fondeve buxhetore në PBA mbi nevojat e institucionit, duke mos u mbështetur në kërkesat e strukturave, por vetëm në realizimet e viteve të mëparshme.

- Nga ana e titullarit dhe e GMS nuk janë bërë analizat e duhura për të hartuar plane masash për arkëtimin e debisë së mbartur ndër vite në vlerën 1,896,257 lekë për 23 raste;

- Nuk është hartuar dhe miratuar Plani i Emergjencave Civile për periudhën 2019 e në vijim mbështetur në Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 14 pika 5, pasi Plani Kombëtar i Emergjencave Civile u miratua me VKM nr. 807, datë 28.12.2023 “Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile”.

- Nga Prefekti i Qarkut Fier, GMS dhe SPPECK nuk janë bërë analiza të detajuara ku të përcaktohen prioritetet për nevojat e AKMC të investimeve emergjente të nevojshme në nivel qarku, me qëllim parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin nga fatkeqësitë. Kjo sipas arsytimit të SPPECK ka ardhur, pasi bashkitë janë ende në fazën e hartimit dhe miratimit të dokumentit të Strategjive Vendore për Zvogëlimin të Riskut nga Fatkeqësitë, që po zhvillohet në kuadër të projektit RESEAL.

##### *Auditim mbi zbatimin e procedurave të prokurimit periudha 2022 – 2023.*

- Në të gjitha rastet është konstatuar se mungojnë ftosat për ofertë drejtuar operatorëve ekonomik për pjesëmarrje; Anëtarët e komisioneve nuk kanë firmosur deklaratat e pavarësisë; Nuk është evidentuar përlllogaritja e fondit limit; Nuk është bërë inventarizimi i dosjeve të prokurimit; Në 1 një rast OE i shpallur fitues nuk përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim.

##### *Auditim mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, viti 2022 – 2023.*

- Nga bashkitë dhe Këshilli i Qarkut Fier i janë përcjellë Prefektit një total prej 245 vendime, për të cilat rezulton se 234 janë konfirmuar si në përputhje me kuadrin rregullator, ndërsa 11 vendime janë konstatuar si në kundërshtim me kuadrin ligjor, ku për 1 vendim është ngritur padi në Gjykatën Administrative të Apelit.

- Në **7 raste**, verifikimet e vendimeve të këshillave bashkiakë me objekt përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile kanë mungesë të dokumentacionit bazë si akti i vlerësimit të dëmit, referencë të gabuar ligjore etj. Për rrjedhojë, nuk ka një vendimmarrje të unifikuar për vendimet të kësaj natyre, duke sjellë si pasojë që verifikimet e ligjshmërisë të jenë kontradiktore për vendime që për nga natyra dhe objekti janë të njëjta.

- Në **1 rast**, verifikimi i ligjshmërisë së aktit normativ me objekt “Për përcaktimin e procedurës për negociim me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me bashkinë e Fierit nëpërmjet marrëveshjes për pronat në pronësi të saj” ka mungesë të bazës ligjore që i atribuon bashkisë të drejtën të përcaktojë me vendim këshilli bashkiak procedurat dhe kriteret për përdorimin e procedurës me negociim.

-Në **3 raste**, në verifikimet e ligjshmërisë së vendimeve të këshillave bashkiakë që kanë për objekt përditësimin e inventarit të pronave, rezultuan mospërputhje në sipërfaqe mes pasurive të përditësuar të bashkisë dhe statusit juridik të konfirmuar nga ASHK si dhe formulari i përditësimit nuk është plotësisht sipas formatit standard, pasi mungojnë të dhënat mbi faktin e inventarizimit apo jo të pasurive përkatëse me vendim të Këshillit të Ministrave.

-Në **2 raste**, Prefekti i Qarkut Fier nuk ka bërë një vlerësim nëse vendimet e këshillave bashkiakë janë në përputhje me Vendimin nr.9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

-Në **1 rast**, për verifikimin e ligjshmërisë së planeve social, u konstatua se është konfirmuar ligjshmëria e shtyrjes së afatit ndërkohë që kuadri rregullator përcakton se plani social është tre vjeçar dhe është i lidhur ngushtësisht me buxhetin e viteve përkatëse, çka nënkupton se ligji nuk parashikon shtyrje të këtij plani, për një vit buxhetor që nuk është përfshirë në planin 3 vjeçar.

- Në **3 raste**, në lidhje me përdorimin e fondit të emergjencave civile për blerje makinerie, Prefekti ka konfirmuar ligjshmërinë e VKB Fier nr. 71 datë 08.08.2022 “Për shpërndarjen dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile për vitin 2022”, për blerjen e mjetit tip autovinç me vlerë 6,000,000 lekë, Vendimit nr. 67 datë 30.06.2023 të Këshillit Bashkiak Fier “Për shpërndarjen dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile” për përdorimin e fondit prej 15,302,826 lekë për blerje mjete teknologjik “skrep me goma”, si dhe Vendimin nr. 75 datë 29.9.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për emergjencat civile 2023”, të Këshillit Bashkiak Lushnjë për blerjen e një mjete zjarrfikës në shumën 6,000,000 lekë. Këto investime nuk përputhen me përshkrimin e vendosur në shkresën nr. 86/6 datë 27.03.2023 të Agjencisë Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), e cila u ka kërkuar bashkive ndarjen e fondeve sipas kodit të produktit “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve edhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e njerëzve”, ku nuk përcaktohet blerja e makinerive. Në këto raste Prefekti Qarkut Fier, duhet të kishte kthyer si në kundërshtim me kuadrin ligjor.

- Prefekti i Qarkut Fier ka shprehur dy qëndrime të ndryshme, duke e refuzuar dhe e miratuar më pas. Në rastin konkret, VKM nr. 414/2021 e lejon bashkinë që të kryejë investim, përmes germës (b) dhe Prefekti duhet ta kishte miratuar VKB fillestare vetëm me shënim për korrigjimin e referencës, respektivisht, ka konfirmuar ligjshmërinë e Vendimit nr. 39 datë 24.07.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për ndërhyrjen e menjëhershme në pronën publike, shkolla Hajredin Fratarit”, por me shënimin se përdorimi i fondit duhet t’i përmbahet pikës 3.1, germa (c) të VKM nr. 414/2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, si dhe ka kthyer si në kundërshtim me ligjin VKB nr. 30 datë 27.06.2023 me të njëjtin objekt. Prefekti i Qarkut ka arsyetuar se baza ligjore ku është mbështetur vendimi është vendosur në interpretim të gabuar, konkretisht për shkak se kriteri “shërbim” që kërkon pika 3.1 germa (c) nuk përputhet me atë çka Këshilli Bashkiak ka vendosur, që përbën “investim”. Sikurse konstatohet, VKB nr. 39 dhe VKB nr. 30 janë në thelb të njëjta, me të njëjtën bazë ligjore dhe me të njëjtën objekt sipas relacionit.

- Prefekti i Qarkut Fier ka kthyer si në kundërshtim me ligjin Vendimin e Këshillit Bashkiak Roskovec nr. 83 datë 31.10.2022 “Për miratim fondesh dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencave civile për vitin 2022”, me qëllim rikonstruksionin e çatisë së shkollës “Alush Grepçka”. Prefekti i Qarku Fier e ka interpretuar aktin përkatës të investimit si jo në përputhje me qëllimin e masave parandaluese, duke arritur në konkluzionin se ky dëmtim “nuk sjell cenim të objektit infrastrukturë deri në atë pikë që të bëjë kërcënim serioz për jetën e nxënësve”. Ky konkludim nga Prefekti nuk bazohet në ndonjë akt ekspertize, por vetëm në interpretimin që i është bërë relacionit të hartuar nga Bashkia Roskovec dhe i përket sferës së trajtimit nga institucione të tjera që kanë tagrin dhe ekspertizën për të shprehur lidhur me rrezikshmërinë apo qëndrueshmërinë e objekteve. Për këtë qëllim, Prefekti i Qarkut Fier duhet t’i përmbahej

parashikimeve dhe kushteve të VKM nr. 414/2021, por në rast se e gjykonte të nevojshme për mirënxhimin e fondit të kushtëzuar, duhet t'i kërkonte bashkisë që të kryente një akt-ekspertize mbi rrezikshmërinë e objekteve të amortizuara.

#### **f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

##### **Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit:**

- Prefekti i Qarkut Fier në bashkëpunim me Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrin masa për të zbatuar me përpikmëri çdo hap të procedurave të përgatitjes së PBA dhe planit vjetor, për të hartuar plane buxhetore që i përgjigjen nevojave të Institucionit për arritjen e objektivave.

- Prefekti i Qarkut Fier, në bashkëpunim me Sektorin e Financës e shërbimeve mbështetëse të analizojnë situatën e krijuar nga debia e akumuluar për një periudhë afro 20 vjeçare me qëllim nxjerrjen e arsyeve të mos arkëtimit të vlerës prej 1,896,257 lekë e 23 rasteve, personat përgjegjës që nuk kanë ndjekur hapat administrativë dhe ligjorë sipas kuadrit ligjor në fuqi, arkëtimi i të cilës do ndikonte në rritjen e buxhetit të institucionit si e ardhur jotatimore e tij;

- Prefekti i Qarkut Fier, Sektori i Planifikimit, parandalimit të emergjencave civile dhe Sektori i Monitorimit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara, të analizojnë me vëmendje të shtuar bilancet e viteve të fundit nga fatkeqësitë natyrore për të përcaktuar arsyet dhe strukturat përgjegjëse që me veprimet joefektive apo mosveprimet e tyre kanë çuar në përkeqësimin e situatës.

##### **Auditim mbi zbatimin e procedurave të prokurimit periudha 2022 – 2023:**

- Në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të argumentojë teknikisht dhe ligjërish çdo kriter të vendosur, duke përdorur vetëm ato kriterë të cilat janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe të vlerësojë të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës, ftesën për ofertë apo dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme.

- Të marrë masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit, në lidhje me procedurat e prokurimit, si dhe ato që do të zhvillohen në vijim, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në RSH.

##### **Auditim mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, viti 2022 – 2023.**

- Prefekti i Qarkut Fier, për vlerësimin e vendimeve të këshillave bashkiakë për përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile, me objekt akordimin e ndihmave për banesa të dëmtuara nga fatkeqësi natyrore/të tjera, të kërkojë nga bashkitë dorëzimin e dokumentacionit mbi vlerësimin e dëmeve, ku të rezultojë qartë lidhja shkak-pasojë mes fatkeqësisë së ndodhur dhe dëmeve të shkaktuara.

- Prefekti i Qarkut Fier të marrë masa që t'i kërkojë zyrtarisht Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile konfirmimin nëse në kodet e produkteve për fondin e emergjencave mundësojnë përfshirjen e shpenzimeve për blerje makinerie, për rastet e konfirmimit të vendimeve për emergjencat civile.

- Prefekti i Qarkut Fier të marrë masa për të krijuar një vendimmarrje të unifikuar lidhur me verifikimin e ligjshmërisë për përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat. Në rast se konstatohen lapsuse apo referime të gabuara në bazën ligjore, të kërkojë korrigjimin e tyre por pa i konsideruar si akte në kundërshtim me ligjin, për aq kohë sa kuadri rregullator ua njeh tagrin për kryerjen e një shpenzimi të caktuar.

- Prefekti i Qarkut Fier, në bashkëpunim me bashkitë, për rastet kur vëren se përdorimi i investimit është jashtë sferës së kriterëve dhe qëllimit të fondit të emergjencave civile si masë parandaluese, të ngrejë një grup pune për verifikimin e situatës në terren ose të kërkojë një akt ekspertize nga bashkitë.

- Prefekti i Qarkut Fier të marrë masa që për periudhën 4 muaj para zgjedhjeve, si dhe gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, të përfshijë si kriter vlerësimi të ligjshmërisë përcaktimet e Vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ.

## **I.1. Opinioni i Auditimit.**

### **Për auditimin e përputhshmërisë:**

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit “Prefektura Qarkut Fier” për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, c) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

### **Opinion:**

*Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Prefektura Qarkut Fier janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar, e shprehur kjo në bazën për opinion.*

### **Baza për opinionin e kualifikuar:**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e opinionit të modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë dhe vlerën e materialitetit prej **696 mijë lekë**, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2023, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit është konstatuar se në të gjitha rastet mungojnë ftesat për ofertë drejtuar operatorëve ekonomik për pjesëmarrje; Anëtarët e komisioneve nuk kanë firmosur deklaratat e pavarësisë; Nuk është evidentuar përlllogaritja e fondit limit; Nuk është bërë inventarizimi i dosjeve të prokurimit; Në 1 një rast OE i shpallur fitues nuk përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim; Në një rast nuk është kryer oponenta teknike.

- Ka diferenca të vlerave të PBA-ve dhe të Projektplaneve vjetore si në raport me planin fillestar ashtu edhe me atë të ndryshuar, që në gjykimin e grupit të auditimit tregon për planifikim jo të studiuar të fondeve buxhetore në PBA mbi nevojat e institucionit, duke mos u mbështetur në kërkesat e strukturave, por vetëm në realizimet e viteve të mëparshme;

- Nga ana e titullarit dhe e GMS nuk janë bërë analizat e duhura për të hartuar plane masash për arkëtimin e debisë së mbartur ndër vite në vlerën 1,896,257 lekë për 23 raste;

- Në **7 raste**, verifikimet e vendimeve të këshillave bashkiakë me objekt përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile kanë mungesë të dokumentacionit bazë si akti i vlerësimit të dëmit, referencë të gabuar ligjore etj. Për rrjedhojë, nuk ka një vendimmarrje të unifikuar për vendimet të kësaj natyre, duke sjellë si pasojë që verifikimet e ligjshmërisë të jenë kontradiktore për vendime që për nga natyra dhe objekti janë të njëjta;

-Në **1 rast**, verifikimi i ligjshmërisë së aktit normativ me objekt “*Për përcaktimin e procedurës për negociim me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me bashkinë e Fierit nëpërmjet marrëveshjes për pronat në pronësi të saj*” ka mungesë të bazës ligjore që i atribuon bashkisë të drejtën të përcaktojë me vendim këshilli bashkiak procedurat dhe kriteret për përdorimin e procedurës me negociim;

-Në **3 raste**, në verifikimet e ligjshmërisë së vendimeve të këshillave bashkiakë që kanë për objekt përditësimin e inventarit të pronave, rezultuan mospërputhje në sipërfaqe mes pasurive të përditësuar të bashkisë dhe statusit juridik të konfirmuar nga ASHK si dhe formulari i

përditësimin nuk është plotësisht sipas formatit standard, pasi mungojnë të dhënat mbi faktin e inventarizimit apo jo të pasurive përkatëse me vendim të Këshillit të Ministrave;

-Në **2 raste**, Prefekti i Qarkut Fier nuk ka bërë një vlerësim nëse vendimet e këshillave bashkiakë janë në përputhje me Vendimin nr.9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”;

-Në **1 rast**, për verifikimin e ligjshmërisë së planeve social, u konstatua se është konfirmuar ligjshmëria e shtyrjes së afatit ndërkohë që kuadri rregullator përcakton se plani social është tre vjeçar dhe është i lidhur ngushtësisht me buxhetin e viteve përkatëse, çka nënkupton se ligji nuk parashikon shtyrje të këtij plani, për një vit buxhetor që nuk është përfshirë në planin 3 vjeçar.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit nr. 565/1prot., datë 31.5.2024 “Mbi auditimin e përputhshmërie” (i ndryshuar), të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 31.5.2024 – 12.7.2024, në subjektin Prefektura Qarkut Fier për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2022 - 31.12.2023, u krye “Auditimi i Përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. K.GJ, Përgjegjës Grupi,
2. S.J, Audituese,
3. R.A, Auditues.

### ➤ OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

**a- Objekti dhe qëllimi i auditimit:** Objekti i auditimit të përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar, i cili do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Në përfundim të auditimit, do hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Prefektit të Qarkut Fier.

**b- Identifikimi i çështjes:** Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi”, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Projekt raporti i auditimit, synon të identifikojë përmëshjen e rolit të prefekturës dhe përgjegjësitë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e



vazhdueshëm të punëve, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Prefektit të Qarkut Fier.

Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Prefektit të Qarkut Fier.

**c- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.** Prefekti i Qarkut Fier (*Administratori i Përgjithshëm*), në cilësinë dhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, si dhe shprehjen e ligjshmërive të vendimeve të këshillave bashkiak.

Prefekti nëpërmjet konfirmimit ose jo të vendimeve të Këshillave Bashkiak, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore fondet speciale të tyre, administrimin e pronave publike të bashkive etj.

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

**d- Përgjegjësitë e audituesve.** Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit “Prefektura Qarkut Fier” për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, c) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si: përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi, transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Prefektit të Qarkut Fier është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

**e- Kriteret e vlerësimit.** Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”; Ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimin MF nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2022”, pikat 95-122.

- Në fushën e prokurimeve publike: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në fushën e vlerësimit të vlefshmërisë së akteve: Ligji nr. 107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin”; Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/n, neni 54; Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” etj.

- Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; Ligjin nr. 152/2013 “Për Nënpunësin Civil” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; Urdhri nr. 50 datë 12.04.2017 të Kryeministrit “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”; VKM nr. 117/2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” i ndryshuar; VKM nr. 707/2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore” i ndryshuar; Urdhri nr. 4 datë 12.01.2016 “Për miratimin e strukturës organizative të Prefektit të Qarkut Fier” dhe VKM për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Institucionit të Prefektit.

- Në fushën e emergjencave dhe Mbrojtjen Civile: Ligji nr.45 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen civile” ; Ligjin nr. 107 dt. 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”; VKM nr. 923 datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimin e komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstytucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”; VKM nr. 345 datë 26.05.2022 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë”; VKM nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

**f- Standardet e auditimit.** ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”; INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit

Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

**g- Metodët e auditimit.** Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*<sup>1</sup>. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar.
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërcave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normale”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* – është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* – është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raportet dhe informacione* – janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

---

<sup>1</sup> *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

**h- Dokumentimi i auditimit.** Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren, nga grupi i auditimit janë dorëzuar në zyrën e protokollit Prefektura Fier 8 akte (*2 akt verifikime dhe 6 akt konstatime*) nr. 450/5-12 prot, datë 25.7.2024, të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara. Nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshtitë të cilat pasi u analizuan me kujdes dhe profesionalizim nga grupi i auditimit, duke marrë në konsideratë ato kundërshtitë të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion, u përgatit dhe u dërgua në subjekt Projektraporti i Auditimit me shkresën nr. 565/8 prot, datë 8.8.2024 për njohje dhe paraqitjen e kundërshtive rreth gjetjeve të tij.

Në përfundim të afatit 30 ditorë, nga subjekti i audituar (Prefektura e Qarkut Fier), me shkresën nr. 852/2 prot, datë 30.8.2024 (*prot. KLSH nr. 565/10, datë 3.9.2024*), janë paraqitur kundërshtitë mbi Projektraport Auditimin, të cilat pasi u analizuan me kujdes, profesionalizëm dhe paanshmëri nga grupi i auditimit, u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

### **III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT.**

#### **1. Informacioni i përgjithshëm.**

Misioni i prefektit të qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave, në nivel qarku. Prefekti i qarkut është përfaqësues i Këshillit të Ministrave në nivel qarku.

Prefektura e Qarkut Fier funksionon në bazë Ligjit nr. 107/2016 datë 27.11.2024 “*Për Prefektin*”; Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*” dhe Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*”, akteve ligjore/nënligjore dhe rregullores së brendshme.

- **1912-1924**

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Qeveria shqiptare bëri organizimin administrativ të sanksionuar në “Kanunin e Përtashëm të Administratës Civile të Shqipërisë” të shpallur më 22 nëntor 1913. Vendi u nda në prefektura dhe krahina. Prefekturat ishin tetë: Berati, Dibra, Durrësi, Gjirokastra, Elbasani, Korça, Shkodra dhe Vlora. Fieri ishte një nga Nënprefekturat, nën juridiksion të Prefekturës së Beratit.

- **1925-1945**

Organizimi dhe funksionimi i administratës vendore u përcaktua sipas Ligjit organik të Bashkisë, të miratuar më 1921 dhe më pas me Kodin Civil të miratuar gjatë vitit 1928. Nënprefektura ishte Njësia administrativo-territoriale, me funksione administrative. Prefektura ishte njësia më e madhe e Qeverisjes vendore e drejtuar nga Prefekti, i cili emërohej nga Ministri i Brendshëm dhe aprovohej nga Kryeministri dhe më pas nga Mbreti. Nënprefekti propozohej nga Prefekti.

Prefekti kishte funksione ekzekutive. Në Prefekturë e Nënprefekturë mungonin organet e zgjedhura. Këshilli Administrativ i Prefekturës përbëhej nga shefat e zyrave dhe nga disa (si rregull 2) anëtarë të zgjedhur nga populli për dy vjet.

Në vitin 1927 Shqipëria kishte 10 Prefektura, 39 Nënprefektura dhe 69 krahina me 2351 fshatra. Në vitin 1934 kishte 10 Prefektura, 30 Nënprefektura, 160 komuna, me 2351 fshatra. Në vitin 1940 kishte 10 Prefektura 30 Nënprefektura, 23 Bashki, 136 komuna dhe 2551 fshatra.

• **1945-1992**

Pas vitit 1945, u bënë shumë ndryshime në strukturën e ndarjes administrative. Në këtë periudhë kishte 10 Prefektura dhe 61 Nënprefektura. Në vitin 1946 u bë ndarja e re Administrative me 10 Prefektura, 39 Nënprefektura. Në vitin 1947 u suprimuan nënprefekturat dhe në vitin 1953 Qarku zëvendësoi Prefekturën.

• **Prefektët 1992 – ne vijim:**

Më pas në bazë të ligjit 7608, datë 22.09.1992 “Për Prefekturat” u krijuan 12 Prefektura si Njësi që drejtohen nga Këshilli i Ministrave.

- **Fushat e veprimtarisë së Institucionit të Prefektit të Qarkut:**


- + Marrëdhëniet e prefektit të qarkut me degët territoriale;
- + Verifikim i ligjshmërisë së akteve;
- + Verifikim i përgjegjësive të deleguara;
- + Shqyrtim i ankesave dhe zgjidhja e konflikteve;
- + Emergjencat Civile.

Prefektura e Qarkut të Fierit është njëri nga 12 prefekturat në Shqipëri me një sipërfaqe prej 1.887 km<sup>2</sup>. Prefektura e Qarkut Fier përfshin bashkitë Fier, Lushnje, Mallakastër, Roskovec, Patos dhe Divjakë.

Ajo kufizohet në veri nga Bashkia Durrës, në veriperëndim nga deti Adriatik (me dalje në det), në verilindje me Bashkinë Elbasan, në lindje me Bashkinë Berat, në juglindje me Bashkinë Gjirokastrë dhe në jug me Bashkinë Vlorë. Prefektura e Qarkut Fier ka një popullsi prej 302.507 (2017) banorë. Në Qarkun e Fierit rrjedh lumi Shkumbini. Qarku i Fierit është dominuar nga zona e Myzeqesë, në të ndodhet lokaliteti i lashtë historik qyteti ilir Apollonia

- **Forma dhe mënyra e organizimit**

Struktura organizative e miratuar, sipas pasqyrës si vijon:



**2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.**

**2.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2022 - 2023.**

**1.1. Programimi PBA-së dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2023:**

Nga Prefekti i Qarkut nuk kanë dalë urdhrat për ngritjen e grupit të punës për hartimin e PBA për çdo fazë të tij, gjë e cila është shoqëruar edhe me mungesën e takimeve për çdo fazë të përgatitjes së PBA-ve, edhe me mos nxjerrjen e urdhrave nga ana e Titullarit për ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP).

Nuk ka të dokumentuar kërkesat për nevojat buxhetore nga secili sektor, por *rezultoi se* PBA-të dhe Plani vjetor hartohen duke u mbështetur në realizimin e zërave buxhetorë të dy viteve pararendëse.

Ndonëse nga Titullari kanë dalë çdo vit urdhrat për ngritjen e GMS me nr. 07 datë 12.01.2022 me nr. 47 prot., datë 12.01.2022 dhe nr. 07 datë 11.01.2023 me nr. 27 prot., datë 11.01.2023, nga auditimi *rezultoi se* nuk ka takime të dokumentuara të GMS për të diskutuar mbi tavanet buxhetore dhe nevojave të institucionit për investime.

**Tabela 1:** Programimi i shpenzimeve në PBA 2022-2024 dhe i detajuar sipas programeve.

Nr.	PBA 2022-2024 Shpenzimet sipas programeve	Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Administrata e Prefektit të Qarkut Fier	37,389	92.8 %	41,150	92.8 %	40,376	92.5 %
2	Gjendja Civile	2,890	7.2 %	3,210	7.2 %	3,268	7.5 %
	<b>TOTALI</b>	<b>40,279</b>	<b>100 %</b>	<b>44,360</b>	<b>100 %</b>	<b>43,644</b>	<b>100 %</b>

Burimi: Prefekti i Qarkut Fier/SFSHM

Nga analiza e detajuar e informacioni të pasqyruar edhe në tabelë, *rezulton* se diferencat e buxheteve nga një vit në tjetrin për secilën PBA, ka ardhur si rezultat i planifikimit të këtyre shpenzimeve:

Rikonstruksioni i godinës së Prefekturës (*hidroizolim i tarracës, shtrim me parket dhe meremetim i mureve të brendshme të katit të parë*) – realizuar në vitin 2023;

Shtesa e pagave sipas VKM – realizuar në vitin 2023;

Planifikim për 2 punonjës me kontratë për përpunim të dokumentacionit të arkivës – pa miratuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Brendshme

Për shtimin në strukturën organizative të 1 punonjësi IT – pa miratuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Brendshme;

Kompletim i sallës së mbledhjeve me pajisje zyre dhe pajisje kompjuterike sipas një draft preventivi paraprak– i pa miratuar nga Drejtoria e Buxhetit në Ministrinë e Brendshme;

Kërkesat 3,4,5 si të përcaktuara, nga ana e SFSHM/Prefekti i Qarkut Fier përsëriten çdo vit me hartimin e PBA dhe Planit vjetor.

Programet buxhetore të Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier për buxhetin e vitit 2022 dhe vitit 2023, hartuar dhe miratuar nga Ministria e Brendshme [MB] referuar programeve të miratuara nga MFE për tu patur në konsideratë nga Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme gjatë përgatitjes së PBA-ve, pasqyrohen si në tabelën më poshtë:

**Tabela 2:** Të dhënat mbi programet buxhetore.

Në 000/lekë

Udhëzimi nr. 7 datë 25.02.2022			Kodi buxhetor	Emërtimi i Programit Buxhetor	Viti 2022		Viti 2023	
Funksioni	N/ Funksioni	Kodi Programit			Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	011	01160	1160	Prefektura e qarkut Fier	31,301	29,209	41,639	39,156
		01170	1170	Gjendja Civile	3,339	3,023	3,796	3,723
<b>20 Programe</b>			<b>2 Programe</b>		<b>34,640</b>	<b>32,233</b>	<b>45,435</b>	<b>42,878</b>

Burimi: Prefekti i Qarkut Fier/Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi *rezulton* se PQ Fier ka planifikuar fonde për dy programe: Prefekti i Qarkut Fier dhe Gjendja civile. Për vitin 2022 buxheti i miratuar në total është në vlerën 34,640 mijë lekë dhe për vitin 2023 është planifikuar në vlerën totale 45,435 mijë lekë ose 10,795 mijë lekë më shumë se ai i vitit 2022; Rritja e buxhetit nga viti 2022 në vitin 2023 në vlerën prej 10,795 mijë lekë ka ardhur si rezultat i planifikimit të fondeve në zërin “investime” – punime e rikonstruksione të godinës së prefekturës, në zërin “shpenzime operative” – aredimin e sallës së mbledhjeve etj.

Gjithashtu edhe realizimi i buxhetit ka ardhur në rritje nga viti 2022 në vitin 2023 me 10,645 mijë lekë; Për vitin 2022 realizimi fakt/plan është në masën 93.1% dhe për vitin 2023 është në masën 94.4%.

Në hartimin e PBA merret në konsideratë Instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

**Tabela 3:** Ndarja e shpenzimeve sipas zërave buxhetorë në PBA 2022-2024.

Nr.	PBA 2022-2024 Shpenzimet sipas programeve	Viti 2022		Viti 2023	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	27.368	68 %	29.750	67.1 %
2	Sigurime (601)	4.571	11.3 %	4.910	11.1 %
3	Shpenzime operative (602)	7.000	17.4 %	7.500	16.9 %
4.	Shpenzime për investime (231)	840	2.1 %	2.000	4.5 %
5.	Transferta për buxhetet familjare dhe individët (606)	500	1.2 %	200	0.4 %
	<b>Totali</b>	<b>40.279</b>	<b>100 %</b>	<b>44.360</b>	<b>100 %</b>

Burimi: SFSHM/PQ Fier

Nga analiza e detajuar e informacioni të pasqyruar edhe në tabelën e mësipërme, *rezulton* se peshën më të madhe në buxhet e ka zëri “paga” nga 67.1% deri në 70.6% dhe peshën më të vogël e ka zëri “transferta për buxhete familjare dhe individë” nga 0.4% deri në 1.2%. Gjithashtu edhe rritje e ndjeshme në buxhet nga viti në vit është parashikuar për zërin “paga”.

Shpenzimet buxhetore të planifikuara dhe realizuara në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier për Planin e buxhetit të vitit 2022 dhe vitit 2023, pasqyrohen si në tabelën më poshtë:

**Tabela 4:** Të dhënat mbi shpenzimet buxhetore.

Në 000/lekë

Emërtimi i shpenzimit	Viti Plan	2022 Fakt	Diferenca	%	Viti Plan	2023 Fakt	Diferenca	%
600	22,796	21,817	979	96	31,786	30,101	1,685	
601	4,516	3,627	889	80	5,413	4,991	422	92
602	6,568	6,038	530	92	6,336	5,970	366	94
230-231	200	191	9	95	1,800	1,799	0,816	100
606	560	560	0	100	100	17	83	17
Mj. në ruajtje 466	0	0	0		90	67	23	74.5
<b>Totali</b>	<b>34,640</b>	<b>32,232</b>	<b>4,708</b>	<b>93.1</b>	<b>45,435</b>	<b>42,878</b>	<b>2,557</b>	<b>94.4</b>

Burimi: Prefekti i Qarkut Fier

Gjatë vitit 2022 Prefekti i Qarkut Fier nuk ka patur investime, ndërsa për vitin 2023 ka patur vetëm 1 investim, respektivisht objekti “Rikonstruksion i godinës së Prefekturës Fier” me vlerë projekti 1,800 mijë lekë dhe vlerë kontrate të realizuar 1,799 mijë lekë ( e mbyllur).

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore dhe në mbështetje të dispozitave të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, me UMF nr. 3, datë 16.01.2021 etj. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga MB me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo vit buxhetor.

**Tabela 5:** Ndryshimet në buxhet (shtesa apo pakësime) sipas programeve për çdo zë.

Mijë lekë

Art	Emërtimi / 2022	Plani	Ndryshimet shtesa	Ndryshim pakësim	Plani ndrysh.	Realizimi	Difer	%
600	Paga shpz.tjera	22,056		(-1,760)	20,296	19,359	937	95
601	Kont.sig.shoq shënd	4,213		(-110)	4,103	3,217	886	78

602	Mallra e shërbim	7,012		(-840	6,172	5,912	260	96
606	Trans. Buxh. Familjar		530		530	530	0	100
231	Shpenz për investime	0	200		200	191	9	96
<b>01160</b>	<b>Shuma:</b>	<b>33,281</b>	<b>730</b>	<b>(-)2710</b>	<b>31,301</b>	<b>29,209</b>	<b>2,092</b>	<b>93</b>
600	Paga shpz.tjera	2,200	300		2500	2,458	42	98,3
601	Kont. Sig.shoq shënd	365	48		413	410	3	99
602	Mallra e shërbime	0	396	0	396	126	270	32
606	Trasfert tek individët	0	30	0	30	30	0	100
<b>01170</b>	<b>Shuma:</b>	<b>2,565</b>	<b>774</b>	<b>0</b>	<b>3339</b>	<b>3,024</b>	<b>315</b>	<b>91</b>
<b>Buxheti TOTALI</b>		<b>35,846</b>	<b>1,504</b>	<b>(-)2,710</b>	<b>34,640</b>	<b>32,233</b>	<b>2,407</b>	<b>93</b>

Nga auditimi rezulton se në buxhetin e vitit 2022 janë shtuar 730 mijë lekë në programin 01160 në llog. 606 dhe llog. 231 dhe pakësuar 2,710 mijë lekë nga llog. 600, llog. 601 dhe llog. 602, lëvizje të cilat e kanë çuar planin e ndryshuar të programit 01160 nga 33,281 mijë lekë në 31,301 mijë lekë;

Në programit 01170 janë shtuar 774 mijë lekë në llog. 600, llog. 601, llog. 602 dhe llog. 606, ndërsa nuk ka patur pakësime, pasi shtesat janë siguruar nga pakësimi i llogarive të programit 01160, duke e çuar planin e ndryshuar të këtij programi nga 2,565 mijë lekë në 3,339 mijë lekë dhe planin total nga 35,846 mijë lekë në 34,640 mijë lekë.

**Tabela 6:** Ndryshimet në buxhet (shtesa apo pakësime) sipas programeve për çdo zë.

Mijë lekë

Art	Emërtimi / 2023	Plani	Ndryshimet	Ndryshim pakësim	Plani ndrysh.	Realizimi	Difer	%
600	Paga shpz.tjera	21,896	+6,690		28,586	26,942	1,644	94
601	Kont. sig.shoq shënd	4,303	+550		4,853	4,463	390	92
602	Mallra e shërbim	6,300	0		6,300	5,934	366	94
606	Trans. buxh. familjar	100	0		100	17	83	17
231	Blerje pajisje zyre	459	0		459	458	1	100
231	Ndërtime rikonstruk.	1,800	0	(-)459	1,341	1,341	0	100
<b>01160</b>	<b>Shuma :</b>	<b>34,858</b>	<b>7,240</b>	<b>(-)459</b>	<b>41,639</b>	<b>39,155</b>	<b>2,484</b>	<b>94</b>
600	Paga shpz.tjera	2,600	+600		3,200	3,159	41	99
601	Kont. sig.shoq shënd	430	+130		560	528	32	94
602	Mallra e shërbim	0	+36		36	36	0	100
606	Trans. buxh. familjar	0	0		0	0	0	0
<b>01170</b>	<b>Shuma :</b>	<b>3,030</b>	<b>766</b>		<b>3,796</b>	<b>3,723</b>	<b>73</b>	<b>98</b>
<b>Buxheti TOTALI:</b>		<b>37,888</b>	<b>8,006</b>	<b>(-)459</b>	<b>45,435</b>	<b>42,878</b>	<b>2,557</b>	<b>94,3</b>

Burimi: Prefekti i Qarkut Fier/SFSHM

Nga auditimi rezultoi se në buxhetin e vitit 2023 janë shtuar 7,240 mijë lekë në programin 01160 në llog. 606 dhe llog. 601 dhe pakësuar 459 mijë lekë nga llog. 231, lëvizje të cilat e kanë çuar planin e ndryshuar të programit 01160 nga 34,858 mijë lekë në 41,639 mijë lekë;

Në programit 01170 janë shtuar 766 mijë lekë në llog. 600, llog. 601, llog. 602, ndërsa nuk ka patur pakësime, pasi shtesat janë siguruar nga pakësimi i llogarive të programit 01160, duke e çuar planin e ndryshuar të këtij programi nga 3,030 mijë lekë në 3,796 mijë lekë dhe planin total nga 37,888 mijë lekë në 45,435 mijë lekë.

Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të viteve 2022 dhe 2023, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lëvizjet në buxhet.

- Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar



nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës.

Art.	PQ Fier nga Buxheti i shtetit Viti 2022. Në 000/lekë								
	Emërtimi	Fakti i vitit para ardhës Viti 2021	PBA Plan Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	Çelja në thesar 2022	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	% e realizimit
600	Paga	21,943	27.368	24.256	22.796	24.256	21.817	979	96 %
601	Sigurime Shoqërore	3,556	4.571	4.578	4.516	4.578	3.627	889	80 %
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	5,562	7.000	7.012	6.568	7.012	6.038	530	92 %
603	Subvencione								
604	Transferta Korente të Brendshme								
605	Transferta Korente të Huaja								
606	Transf. për Buxh. Fam. & Individ	602	500	0	560	0	560	0	100 %
<b>Nën-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>31,663</b>	<b>34,439</b>	<b>35,846</b>	<b>34,440</b>	<b>35,846</b>	<b>32,041</b>	<b>2,398</b>	<b>89.4</b>
230	Kapitale të Patrupezuara								
231	Kapitale të Trupezuara		840	0	200	0	191	9	95 %
<b>Nën-Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>0</b>	<b>840</b>	<b>0</b>	<b>200</b>	<b>0</b>	<b>191</b>	<b>9</b>	<b>95</b>
<b>Totali (korrente + kapitale)</b>		<b>31,663</b>	<b>35,279</b>	<b>35,846</b>	<b>34,640</b>	<b>35,846</b>	<b>32,232</b>	<b>2,408</b>	<b>89.9</b>

Art.	PQ Fier nga buxheti i shtetit. Viti 2023. Në 000/lekë								
	Emërtimi	Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	PBA Plan Viti 2023	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	Çelja në thesar 2023	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	Realizimi ne %
600	Paga	21.817	27.428	24.496	31.786	24.496	30.101	1.685	95 %
601	Sigurime Shoqërore	3.627	4.581	4.733	5.413	4.733	4.991	422	92 %
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	6.038	8.600	6.300	6.336	6.300	5.970	366	94 %
603	Subvencione								
604	Transferta Korente të Brendshme								
605	Transferta Korente të Huaja								
606	Transf. për Buxh. Fam. & Individe	560	500	0	100	0	17	83	17 %
<b>Nën-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>32,041</b>	<b>41,109</b>	<b>35,529</b>	<b>44</b>	<b>43,499</b>	<b>41,049</b>	<b>2,556</b>	<b>94.4</b>
230	Kapitale të Patrupezuara								
231	Kapitale të Trupezuara	190.800	1.000	0	1.800	0	1.799	816	100 %
232	Transferta Kapitale								
<b>Nën-Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>190,800</b>	<b>1,000</b>	<b>0</b>	<b>1,800</b>	<b>0</b>	<b>1,799</b>	<b>816</b>	<b>100</b>
<b>Totali (korrente + kapitale)</b>		<b>32,232</b>	<b>42,109</b>	<b>35,529</b>	<b>45,435</b>	<b>43,499</b>	<b>42,878</b>	<b>2,556</b>	<b>98.6</b>

Burimi: SFSHM/Prefekti i Qarkut Fier

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelat e mësipërme *rezulton se* ka diferenca të vlerave të PBA-ve dhe të Projektplaneve vjetore si në raport me planin fillestar ashtu edhe me atë të ndryshuar, që në gjykimin e grupit të auditimit tregon për planifikim jo të studiuar të fondeve buxhetore në PBA mbi nevojat e institucionit, duke mos u mbështetur në kërkesat e strukturave por vetëm në realizimet e viteve të mëparshme.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me miratim nga ministria e linjës, të pasqyruara këto edhe në tabelat respektive.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi gjithashtu se analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj; gjatë vitit 2023 është bërë raportimi periodik 4 mujor, 8 dhe 12 mujor i realizimit të buxhetit në MB.<sup>2</sup>

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuar sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitet 2022/ 2023 rezultoi se PBA 2022-2024 dhe 2023-2025 të jetë realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Ndryshimet e bëra për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve.

- Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Shpenzimet buxhetore të planifikuara dhe realizuara në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier për Planin e buxhetit të vitit 2022 dhe vitit 2023, pasqyrohen si në tabelën më poshtë:

**Tabela 7: Të dhëna mbi treguesit e buxhetit (shpenzimet).**

Në 000/lekë

Emërtimi i shpenzimit	Viti 2022		Diferenca	%	Viti 2023		Diferenca	%
	Plani	Fakti			Plani	Fakti		
600	22.796	21.817	979	96	31.786	30.101	1,685	94.7
601	4.516	3.627	889	80	5.413	4.991	422	92
602	6.568	6.038	530	92	6.336	5.970	366	94
230-231	200	191	9	95	1.800	1.799	0,816	100
606	560	560	0	100	100	17	83	17
Mj. në ruajtje 466	0	0	0		90	67	23	74.5
<b>Totali</b>	<b>34,640</b>	<b>32,232</b>	<b>2,408</b>	<b>88</b>	<b>45,435</b>	<b>42,878</b>	<b>2,557</b>	<b>94.4</b>

Burimi: Prefekti i Qarkut Fier/SFSHM

Duke bërë analizën e të dhënave të tabelës rezultoi se:

- Për vitin 2022 peshën kryesore në buxhet e zë llog. 600 “Paga personeli” në vlerën 22,796 mijë lekë dhe peshën më të vogël e zë llog. 230-231 “Investimet” me vlerën 200 mijë lekë. Pesha specifike e llogarive (600-601) të shpenzimeve ndaj totalit të shpenzimeve, është 27,312 mijë lekë ose 78.9%, ndërsa “Investimet” zënë 0.6% të totalit të buxhetit të planifikuar.

- Për vitin 2023 peshën kryesore në buxhet e zë llog. 600 “Paga personeli” me 31,786 mijë lekë dhe peshën më të vogël e zë llog. 230-231 “Investime” me 1,800 mijë lekë. Pesha specifike e llogarive (600-601) të shpenzimeve ndaj totalit të shpenzimeve, është 37,199 mijë lekë ose 81.9%, ndërsa “Investimet” zënë 4% të totalit të buxhetit të planifikuar.

Realizimin e plotë e ka zëri “investime” në masën 100%. Ndërsa me mos realizim buxheti paraqiten llog. 600 – 601, kjo ka ardhur si rezultat i fondit të llogaritur për pagën e 2 vendeve vakante: N/Prefektit të Lushnjës vakant nga tetor i vitit 2021 dhe Përgjegjës Sektorit të Monitorimit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara, ka qenë me leje lindjeje shtator 2022-tetor 2023 dhe ka dhënë dorëheqjen.

Mos realizimi i llog. 602 ka ardhur për mos miratim të shpenzimeve për aredimin e sallës së mbledhjeve me pajisje zyre dhe pajisje kompjuterike.

Për zbatimet e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Fier si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Fier, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar të vitit, të miratuar nga Buxheti i shtetit ose të diktuar nga transferata e deleguar nga pushteti qendror. Për rishikimet e buxhetit, rezulton se është respektuar disiplina buxhetore, si në planifikim ashtu edhe në realizim.

<sup>2</sup> Informacioni i detajuar pasqyrohet mëposhtë në rubrikën Monitorimi i buxhetit

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë, *rezulton* se Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier parashikon në PBA vetëm të ardhura nga pullat e Gjendjes civile. Vlera e të ardhurës është parashikuar me rritje nga viti në vit në të dy PBA-të: nga 1, 440 lekë deri në 1,500 lekë për PBA 2022-2024 dhe nga 1,460 lekë në 1,520 lekë për PBA 2023-2025.

**Tabela 7:** *Nga akt Rakordimi me Degën e Thesarit Fier në mbyllje të çdo viti buxhetor përfshirë në periudhën tonë audituese.*

Nr.	Llog. të ardhurës	Emërtimi i të ardhurës	Progresive dhjetor 2022
1	7113013	Nga shitja e dokumenteve të ankandit	0
2	7113099	Të tjera nga mallra e shërbime	0
3	7081006	Taksa e akteve dhe pullave	72,450
4	7190880	Të tjera jo tatimore	48,000
<b>Totali</b>			<b>120,450</b>
Nr.	Llog. të ardhurës	Emërtimi i të ardhurës	Progresive dhjetor 2023
1	7113013	Nga shitja e dokumenteve të ankandit	0
2	7113099	Të tjera nga mallra e shërbime	0
3	7081006	Taksa e akteve dhe pullave	41,275
4	7190880	Të tjera jo tatimore	11,512
<b>Totali</b>			<b>52,787</b>

*Burimi: SFSHM/PQ Fier*

Akt Rakordimi i datës 12.01.2023 për të ardhurat e vitit 2022 për llogari të PQ Fier dhe Akt Rakordimi i datës 08.01.2024 për të ardhurat e vitit 2023 për llogari të PQ Fier, janë nënshkruar nga specialisti i Degës së Thesarit Fier, përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve mbështetëse (NZ) i Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier dhe nga Prefekti i Qarkut Fier.

- Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Ministrinë Brendshme:

Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 207 prot., datë 21.02.2023 dhe atë nr. 289 prot., datë 09.03.2024 ka përcjellë mbylljen e llogarive vjetore për vitet 2022 dhe 2023 në Ministrinë e Brendshme, Degën e Thesarit dhe Drejtorinë e Statistikave Fier.

Në zbatim ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 65, Udhëzimin e MF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, *rezulton se* janë bërë raportimet 4, 8 dhe 12 mujore në Ministrinë e Brendshme, sipas formateve të kërkuara nga MB edhe në rrugë elektronike; “Raportim mbi situacionet e shpenzimeve, të ardhurave dhe detyrimeve të prapambetura për 12 mujorin” me shkresën nr. 69 prot., datë 18.01.2023 për vitin e mbyllur buxhetor 2022 dhe me shkresën nr. 49 prot., datë 09.01.2024 për vitin e mbyllur buxhetor 2023.<sup>3</sup>

- Vlerësimi i risqeve buxhetore.

Nga të dhënat e PBA 2022-2024/2023-2025 dhe Planin vjetor 2022/2023, Prefekti i Qarkut Fier nuk ka planifikuar fonde buxhetimi për programin “likuidimi i detyrimeve të prapambetura”, pasi PQ Fier *nuk ka detyrime të prapambetura.*

Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier ka raportuar çdo vit debitorët ndaj tij, dhe i ka klasifikuar si “debitorë pa shpresë arkëtimi.”

**Tabela 7:** *Të dhëna mbi debitorët deri me 31.12.2023, shprehur në lekë.*

Nr. debitor	Viti i krijimit	Shuma totale	Arsyeja e krijimit
3	1999	200,900	Raport Audit i MB
7	2002	18,708	-//-
5	2009	162,000	Raport i KLSH
7	2013	524,197	Raport Audit i MB
1	2014	64,196	Raport i KLSH
1	2016	60,000	Raport Audit i MB
<b>24</b>		<b>1,896,257</b>	

*Burimi: PQ Fier/Punoi: Grupi i auditimit*

<sup>3</sup> *Informacion i detajuar në tabelën e ndryshimit të planit vjetor të buxhetit*

Nga ana e SFSHM është raportuar me mbylljen e pasqyrave financiare edhe Prefekti i Qarkut Fier, e kontabilizuar në llog.468 “*debitorë të ndryshëm*” .

Nga auditimi *rezulton se* nga SFSHM:

- Është bërë njoftimi i debitorëve nëpërmjet shërbimit postar;
  - Me mbylljen e Pasqyrave Financiare është bërë raportimi në Degën e Thesarit, Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Statistikave Fier;
  - Me mbylljen e vitit ushtrimor, akt rakordimeve me thesarin, çdo fillim viti nuk është njoftuar Sektori Juridik mbi listën e debitorëve, me qëllim planifikimin vjetor të ndjekjes së procedurave ligjore;
  - Është vënë në dijeni Prefekti i Qarkut, por nga ana e tij nuk janë marrë masat për të mbledhur në një takim GMS mbi trajtimin e kësaj çështjeje, për një analizë të detajuar mbi arsyet e lënies në heshtje për një periudhë disavjeçare (nga 1999 deri më tani), personat përgjegjës, si dhe hartimin e një plan masash për arkëtimin e detyrimit në buxhetin e PQ Fier;
  - Nuk janë ndjekur hapat procedurale administrativë dhe më pas ligjorë (sipas rastit) për arkëtimin e detyrimit të mbartur ndër vite, për të cilin ka një paketë të plotë ligjore për të siguruar arkëtimin e detyrimit në favor të Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier.
- Nga Njësia e AB të Ministrisë së Brendshme, në Raportin Përfundimtar të Auditimit me nr. 1079/5 prot, datë 15.04.2024 dhe me nr. 355/2 prot. të PQF datë 17.04.2024, lidhur me situatën e debitorëve është lënë ky Rekomandim:

*“Menaxhimi i lartë i organizatës të marrë masa për gjetjen e adresave të personave fizikë e juridikë debitorë, të kërkojë zyrtarisht nga DPP Shtetit, DPGJ Civile dhe nga IS Shoqërore, adresat e vendbanimit dhe të punësimit të tyre, të kërkojë në GJA të Shkallës së Parë Fier arkëtimin i 23 debitorëve të krijuar në vite (para vitit 2014) në vlerën 1,896,257 lekë”.*

Për këtë rekomandim Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier në Planin e veprimit, i ka kthyer këtë përgjigje NJAB/MB mbi masat e marra për zbatimin e tij: *“Nga ana e SFSHM janë bërë procedurat për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët vullnetarisht. Përsa i përket kërkitimit në Gjykatë, kanë kaluar prej vitesh afatet për ngritjen e padisë. Për këtë fakt është informuar edhe MB me shkresën nr. 478 datë 22.05.2020 ku është kërkuar miratimi i listës së debitorëve si të pashpresë për arkëtim”.*

*Për mos marrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët, nuk është zbatuar Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH” (i ndryshuar), Kapitulli II (nenet 41-45), duke ngarkuar me përgjegjësi: **L.SH**, me detyrë ish- Prefektit të Qarkut Fier, periudha 01.01.2022 deri më 31.12.2023, në cilësinë e nëpunësit zbatues; **S.Ç**, me detyrë Përgjegjëse Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e nëpunësit zbatues.*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 852/2 prot, datë 30.8.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit" nga M.I dhe S.Ç, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me konstatimin tuaj për fondin rezervë, sqarojmë se bazuar në ligjin 9936 neni 5, “Buxheti i Shtetit “Fondi i kontigjencës përdoret për të mbuluar efektin e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimit mbi fondet e miratuara” nuk realizon të ardhura, si njësi e qeverisjes së përgjithshme, dhe jemi të kategorizuar nivel i dyte si NA njësi vartëse e Ministrisë së Brendshme, këto fonde krijohen dhe financohen nga niveli i pare autorizues Ministria e Brendshme, po kështu fondi rezerve përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të planifikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit, po kështu edhe planifikimi dhe përdorimi i fondit rezervë bëhet nga niveli i parë autorizues.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

*Pë sa sqaruar në lidhje me fondin rezervë pretendimi juaj merret në konsideratë..*

**Pretendime të Subjektit:**

*Mbi Rekomandimi nr.6: Nga analiza e debisë se kredisë se krijuar ne vite ne vlerën progresive prej 1896257 leke për 23 debitorë dhe e deklaruar ne instancat përkatëse, rezulton se nga ana e titullarit te GMS nuk janë bere analizat e duhura për te hartuar plane masash për arkëtimin e debisë se mbartur nder vite ne kundërshtim me*

ligjin 10296/2010, "Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin" nenet 8,9,10,11,12,27 si edhe manuali mbi MKF, miratuar me urdhrin 54 te Ministrit te Financave nr. 8980 prot, date 15.07.2010 i ndryshuar, Kreu II, paragrafet 2,6,7,8 dhe 9, udhezimi nr. 21, date 25.10.2016, "Për nëpunësit zbatues te te gjitha niveleve, Udhëzimit nr.16, date 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit te MFK dhe koordinatorit te riskut ne njësitë publike". Gjithashtu nga ana e SFSHM nuk janë ndjekur hapat administrative dhe ligjore, konkretisht me mbylljen e vitit ushtrimor, akt akordimeve me thesarin çdo fillim viti nuk është njoftuar Sektori Juridik mbi listën e debitorëve me qellim planifikimin vjetor për ndjekjen e procedurave ligjore si edhe nuk janë ndjekur hapat procedurale administrative dhe me pas ligjore për arkëtimin e detyrimit ne vite për te cilën ka një pakete te plote ligjore për te siguruar arkëtimin e detyrimit, në kundërshtim me ligjin nr.9920 date 19.05.2008, "Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë i ndryshuar kreu "X" , "Mbledhja me force e detyrimit". Parashtrijmë qëndrimin tone si sektor finance dhe Shërbime Mbështetëse se kjo shume detyrimi ka mbi 10 vite qe qëndron ne këtë nivel ne vlerën 1896257 leke për 23 debitorë ne vite te cilët janë pa shprese arkëtimi dhe arsytet i kemi relatuar me shkresat përkatëse datojnë nga viti 1999, dhe se ktori i financës ka ndjekur te gjithë hapat administrative ,duke jo vetëm njoftuar sektorin juridik por bashkërisht është konceptuar edhe shkresë drejtuar ministrisë se brendshme nga te dy sektorët me nr. 478 Datë 22.05.2020 "Kërkesë për Miratim". Për sa më sipër për mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi L.SH, me detyrë Ish-Prefekt i Qarkut Fier, periudha 01.01.2022 deri më 31.12.2023. S.Ç, me detyrë Përgjegjëse Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues". Për atë çfarë ju keni cituar më sipër, ju theksoj se për debitorët, shumica e detyrimeve të tyre janë të pasqyruar dhe në pasqyrat financiare të Institucionit tonë nuk rezultojnë debitorë për detyrime tatimore por për arsye të tjera (shih dosjen e informacionit për secilin debitor). Në ligji Nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në Kreun XI citohet "Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguara". Pra, për të gjithë këta debitorë nuk kemi të bëjmë me detyrime tatimore të papaguara, por debitorë për arsye të tjera të dala nga Auditime apo Kontrolle të herëpashershme. Prandaj, argumenti juaj ligjor nuk është në përputhje me veprimtarinë e Institucionit tonë. Nga lista e debitorëve rezulton se debitori i fundit është krijuar në vitin 2016, vit ky që L.SH nuk ka qenë Prefekt i Qarkut dhe S.Ç nuk ka qenë Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Gjithsesi, nga ana e Përgjegjëses së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëses janë ezuaauruar të gjitha hapat ligjore të arkivuar në dosjen e debitorit sipas relacionit sqarues. Gjatë vitit 2018 dhe 6 mujorit të parë 2019, Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier janë bërë përpjekje mbi vjeljen e të ardhurave nga debitorët. Në vitin 2018 është nisur shkresa Nr. 2038 datë 13.12.2018 për marrje të dhënash drejtuar: Drejtorisë Vendore të Policisë Fier; Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë; Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier; Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Vlorë Zyra e Gjendjes Civile Bashki Fier; Zyra e Gjendjes Civile Bashkia Vlorë

Të dhënat e kërkua konsistojnë në gjetjen e adresave të sakta të banimit, nëse janë në marrëdhënie pune apo pension ose figurojnë të regjistruar në biznese private.

Janë kthyer përgjigje me shkresat: Nr. 719 Prot. Datë 26.12.2018, nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkia Fier, me adresat të cilat janë në sistem; Nr. 291 Prot. Datë 28.12.2018, nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkia Vlorë+, me adresat të cilat janë në sistem; Nr. 7999/1 Prot datë 20.12.2018 nga drejtorja e policisë Vlorë rezulton se nuk janë punonjës policie; Nr. 25038 Prot. Datë 26.12.201 nga Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve; Nr. 66627/1 Prot. 26.12.2018 nga Drejtorja e Sigurimeve Shoqërore Rajonale Vlore; Nr. 6674 Prot. 17.12.2018 nga Drejtorja e Sigurimeve Shoqërore Rajonale Vlore, dega e Kontributeve; Nr. 6679 Prot. 17.12.2018 nga Drejtorja e Sigurimeve Shoqërore Rajonale Vlore, dega e informatikës; Nr. 6809 Prot. 17.12.2018 nga Drejtorja e Sigurimeve Shoqërore Rajonale Vlore, dega e arkives.

Çdo vit është dërguar informacion dhe relacionet shpjeguese mbi debitorët. Janë dërguar nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier, në bazë të të dhënave të siguruara nga drejtoritë, të gjithë debitorëve shkresa zyrtare dhe fatura për arkëtim sipas shume përkatëse për secilin debitor me shkresën Nr. 850 Prot. Datë 17.05.2019, për 24 debitorë. ( Bashkangjitur shkresa për secilin debitor dhe fatura për arkëtim). Rezulton se janë kthyer pa marrë ndijeni nëpërmjet postës 9 persona, 1 i vdekur, 6 nuk janë gjendur sipas të dhënave të dërguara nga institucionet përkatëse, 1 në Angli dhe 1 në Amerikë. Janë raportuar pranë Drejtorive përkatëse në Ministrinë e Brendshme me shkresën NR. 9789 datë 04.12.2018 "Evidentimi i atyre pa shpresë arkëtimi" për debitorët dhe me shkresën Nr. 478 Datë 22.05.2020 "Kërkesë për Miratim". Përpjekjet e vazhdueshme për arkëtimin e debitorëve kanë vazhduar dhe nuk janë ndërprerë asnjëherë nga ana e Institucionit tonë.

Në vitin 2021 Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse me shkresën Nr. 1329 Prot. Datë 04.11.2021 deri në shkresën Nr. 1329/21 është drejtuar secilit debitor përsëri.

Gjithsesi me këmbënguljen dhe vullnetin e Prefektit në detyrë në vitin 2022 L.SH për ta çuar përpara procesin e debitorëve, të cilët disa rezultojnë nga viti 1999 ndoshta dhe për t'i çuar drejt organeve gjyqësore dhe se duke qenë një pjesë e mirë janë debitorë për më shumë se 10 vite, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe përgjegjësia e këtij Sektori S.Ç me Shkresën Nr. 401 Prot. Datë 11.04.2022 "Informacion mbi debitorët ndër vite" i ka dërguar një informacion Prefektit në detyrë ku përfshihet një përmbledhje e punës së kryer nga Sektori i Financës, mbi krijimin e dosjeve për secilin debitor me dokumentet shoqëruese që janë gjetur në arkivo ndër vite...dhe hapat administrative

Me Shkresën Nr. 401/2 Datë 12.04.2022 "Kthim përgjigje" relacion dërguar titullarit te Institucionit dhe Sektorit Juridik (Në dispozicion me dosje te veçantë për secilin debitor dhe fletë inventari për çdo debitor). Si përfundim, Nëpunësi Zbatues mban përgjegjësi për pjesën që i takon dhe theksojmë se këta debitorë vijojnë nga viti 1999. Nga

data e emërimit si Nëpunëse Zbatuese (Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dt.13.08.2018) dhe në vazhdimësi nuk janë krijuar debitorë pa shpresë arkëtimi.(nga 13/08/2018). Besoj se me hapat e ndjekura nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ndër vite, i është hapur rruga ndjekjes së debitorëve nëpërmjet proceseve gjyqësore. Shkaqet e nxjerrjes si debitor janë në dosjen personale të gjithsecilit të punuar nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të cilat sot gjenden të Protokolluara në Arkivën e Institucionit. Pra, nuk ka vend interpretimi ligji Nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në Kreun XI citohet "Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar". Për veprimet apo mosveprimet në lidhje me debitorët, mendoj se është përgjegjësia e Sektorit Juridik ta interpretojë ligjërisht.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Lidhur me observacionin tuaj mbi rekomandimin nr. 8, ju sjellim në mënyrë të përsëritur në vëmendjen tuaj si më poshtë vijon: Grupi i auditimit gjatë procesit të auditimit pasqyron të dokumentuar (në Akt Konstatime, Akt Verifikime dhe në Projekt Raport) veprimet apo mosveprimet të cilat bien ndesh me kuadrin ligjor. Ato çka ju keni përshkruar në paragrafin e parë të observacionit tuaj sigurisht janë parë dhe marrë në konsideratë. Kjo do të thotë që nga ana e NZ referuar kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi nuk janë ndjekur të gjitha hapat e duhura si vijon:

1)- T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit Rrugor kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);

- Drejtorisë së Përgjithshme/Rajonale së Tatimeve dhe 6 Bashkive të përfshira në Qarkun Fier për të njoftuar (në raste se ka) subjektet fizike /juridike me administrator debitorët tuaj, apo nga ana e bashkive për tu njohur abonentëve familjarë detyrimin tuaj dhe për marrjen e masave shtrënguese nëpërmjet UKT, si agent tatimor i bashkive; ky bashkëpunim ndërinstytucional mbështetet në VKM nr. 867 datë 10.12.2014 "Për procedurat e bashkëpunimit në Institucionet e Administratës shtetërore" i ndryshuar Kreu I e II;

2) Mosvënia në dispozicion çdo fund apo fillim viti ushtrimor e listës së debitorëve edhe Sektorit juridik të Prefektit të Qarkut Fier;

3) Mungesa e mbledhjes së GMS dhe parashtrimi i problematikës për njohje, diskutim dhe marrje masash për zgjidhje prej tij;

Gjithashtu ju sjellim në vëmendjen tuaj se referuar Ligjit nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Manualit MFK dhe Rregullores së brendshme miratuar nga Ministri i Brendshëm, mosveprimet kanë sjellë mos përmbushjen nga ana e NA dhe NZ të detyrave dhe përgjegjësie funksionale për arkëtimin e detyrimit nga ana e debitorëve ndër vite. Përsa cituam, pretendimi juaj nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

**- Mbi verifikimi i masave të programit të emergjencave dhe mbrojtjes civile [EC-MC] për masat e marra për fatkeqësitë natyrore: si tërmetet, përmbytjet, dëmtimet nga zjarri, vlerësimet e dëmeve nga fatkeqësi të ndryshme për përmirësimin e cilësisë së jetës së njeriut.**

Institucionet dhe strukturat vendore të mbrojtjes civile institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile, në nivel vendor, janë:

a) Prefekti i qarkut;

b) Komisioni i mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkie;

c) Bashkitë;

ç) Strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe të strukturave qendrore të mbrojtjes civile.

Referuar përcaktimeve të kuadrin ligjor, grupi i auditimit pas komunikimit, përgatiti edhe një pyetësor mbi të cilin do jepet një pasqyrim i aktivitetit të Prefektit të Qarkut Fier dhe strukturës përgjegjëse për SPPMC për zbatimin e tij- Ligjit nr. 45/2019 "Mbi mbrojtjen civile" neni 28.

Në përgjigje të pyetësorit bërë nga Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier (dërguar me e-mail dt. 28.6.2024), mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi rolin dhe përgjegjësitë e këtij institucioni për Emergjencat Civile, rezulton si më poshtë vijon:

**1. Struktura përgjegjëse për Emergjencat Civile në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier:**

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni në Strukturë	Emërimi në pozicion
1	K.Y	P/Sekt i Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile	08.11.2021

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni në Strukturë	Emërimi në pozicion
2	T.S	Spec.Sekt i Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile	03.05.2016
3	E.H	Spec. Sekt i Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile	03.05.2016
4	B.XH	Spec. Sekt i Planifikimit dhe Mbrojtjes Civil	28.02.2023

Stafi i Sektorit të Emergjencave Civile [SPPECK] ka në përbërjen e tij 4 punonjës, referuar dhe në zbatim të Strukturës organizative miratuar me Urdhrin nr. 4 datë 12.01.2016.

2. Konfirmimet me ligjshmërinë të VKB-ve të miratuara nga Këshillat Bashkiakë të 6 Bashkive: Fier, Divjakë, Lushnje, Mallakastër, Patos, Roskovec, janë sipas aneksit 1.4 bashkëlidhur RPA.

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë rezulton se nga Prefekti i Qarkut Fier në të gjitha rastet janë konfirmuar ligjshmëria e VKB për miratimin e PBA dhe Planeve buxhetore vjetore, pasi nga bashkitë janë planifikuar fonde për emergjencat civile, pavarësisht se jo në çdo rast janë në masën e përcaktuar në Ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 65 pika 1.

3. Nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier është hartuar dhe miratuar dokumenti i Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë për Qarkun Fier me Urdhrin e Prefektit nr. 30, datë 02.11.2023. Ky dokument është hartuar nga ekspertë kombëtar të mbështetur nga UNDP në kuadër të projektit RESEAL. Prefektura e Qarkut Fier si dhe gjashtë bashkitë e këtij qarku janë përzgjedhur nga AKMC për implementimin e këtij projekti pilot që po zhvillohet në gjashtë bashkitë e qarkut Fier dhe në prefekturë për hartimin e dokumenteve strategjike të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë.

Me shkresën nr. 1145, datë 09.11.2023 është dërguar në AKMC Urdhri dhe dokumenti i Vlerësimit të Riskut të miratuar. Deri në 02.11.2023 Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier nuk ka patur dokument të vlerësimit të Riskut.

4. Nga Prefekti i Qarkut Fier nuk është hartuar dhe as miratuar Plani i Emergjencave Civile për periudhë 2019 e në vijim me daljen e Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 14 pika 5, pasi Plani Kombëtar i Emergjencave Civile u miratua me VKM nr. 807, datë 28.12.2023 "Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile" dhe ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare më datë 12.01.2024. Nga Prefekti i Qarkut Fier deri në miratimin e VKM nr. 807/2022 ka operuar me Planin e Qarkut për Emergjencat Civile të miratuar më datë 15.03.2017, në zbatim VKM-së Nr. 835, datë 3.12.2004 "Plani Kombëtar për Emergjencat Civile.

Gjatë kësaj periudhe Prefekti i Qarkut Fier ka bërë dhe përditësime në ato elemente të planit (sistemin e lajmërimit, deklarimin e kapaciteteve), të cilat nuk varen nga Plani Kombëtar i Emergjencave Civile dhe janë dërguar në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, me qëllim analizimi dhe planifikimi, së bashku me Planet e Masave dhe Planet e Veprimet.

5. Nga 6 Bashkitë e Qarkut Fier gjatë viti 2023 janë miratuar me Vendim të KB përkatës "Dokumentin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë". Hartimi i këtyre dokumenteve është bërë në kuadër të projektit RESEAL. Këto vendime janë depozituar në Institucionin e Prefektit.

Institucioni i Prefektit Fier ka marrë informacion nga bashkitë për risqet nëpërmjet njohjes me dokumentin e miratuar të Vlerësimit të Riskut Vendor.

Për masat e marra është marrë informacion nëpërmjet Planeve të Masave të miratuara të cilat bashkitë i kanë depozituar në Institucionin e Prefektit. Informacioni mbi masat e marra nga bashkitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, është përcjellë edhe nëpërmjet shprehjes së ligjshmërisë së VKB të miratuar për përdorimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

Nga shkresat e PQ Fier dërguar Bashkive, Bordit të Kullimit dhe Agjencisë së Zonave të mbrojtura, u kërkohet masat konkrete dhe investimet e kryera për minimizimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore. Nga 6 bashki, vetëm Bashkia Patos nuk ka nisur informacion mbi masat dhe investimet për mbrojtjen civile.

Raportimi në AKMC nga ana e Prefektit të Qarkut Fier është bërë nëpërmjet shkresës nr. 1145 prot., datë 09.11.2023.

6. Përgjatë periudhës 2022-2023, nga strukturat vendore të MC janë raportuar rreth 400 situata emergjente, pjesa më e madhe e të cilave janë shkaktuar nga zjarret. Institucioni Prefektit, çdo ditë merr nga Qendra Kombëtare Operacionale e Mbrojtjes Civile buletin mbi rreziqet natyrore me të dhëna të përgatitura nga IGEO. Kur në buletin, konstatohen “*risk i moderuar rreziku*”, ky informacion iu dërgohet strukturave vendore të Mbrojtjes Civile; kur konstatohet “*rrezik i lart*”, informacioni iu dërgohet strukturave vendore të M. Civile, mediave lokale apo edhe DPD popullatës së rrezikuar (*nëpërmjet komunikimit me Administratorët e Njësive Administrative apo edhe Kryetarët e fshatrave*).

7. Nga Prefekti i Qarkut Fier, GMS (*i cili deri në 31.12.2023 nuk është ngritur*) dhe SPPECK nuk janë bërë analiza të detajuara ku të përcaktohen prioritetet për nevojat e AKMC të investimeve emergjente të nevojshme në nivel qarku, me qëllim parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin nga fatkeqësitë. Kjo sipas arsyetimit të SEK ka ardhur pasi bashkitë janë ende në fazën e hartimit dhe miratimit të dokumentit të Strategjive Vendore për Zvogëlimin të Riskut nga Fatkeqësitë, që po zhvillohet në kuadër të projektit RESEAL. Mungesa e analizave është shoqëruar edhe me mungesën e raporteve për në AKMC.

8. Nga baza e të dhënave Kombëtare Krijohet dhe mirëmbahet nga AKMC sipas rregullave të VKM nr. 345/2022 “*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë*”. Referuar pikës 11 të VKM nr. 345/2022, Bashkitë kanë detyrim hedhjen dhe përditësimin e të dhënave parësore në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, ndërsa Prefekturat kanë detyrimin të sigurojnë që bashkitë nën juridiksionin e vet të hedhin dhe përditësojnë të dhënat në lidhje me dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë. Në datën 25 të ç’do muaji SPPECK raporton elektronikisht në AKMC informacionin e përditësuar sipas *aneksit 1.2 bashkëlidhur RPA*.

9. Nga auditimi i informacionit të vënë në dispozicion, rezulton se: *për vitin 2022* tabela me të dhënat mbi fatkeqësitë natyrore kryesisht zjarr, është përpiluar nga SPPECK në PQ Fier mbi raportet e dërguara nga 6 bashkitë e Qarkut Fier. Kështu janë në total 210 raste të regjistruara ku numri më i lartë është regjistruar në Bashkia Fier me 79 raste ose 9.1% të totalit; numrin më të vogël të rasteve e ka Bashkia Divjakë me 10 raste ose 4.8% e totalit.

Nga ekonomia pyjore janë regjistruar 8 raste ku janë djegur 9.2 ha pyje nga të cilat 6.2 ha ose 67.4% i përkasin Bashkisë Fier;

Për ullishte dhe agrume janë regjistruar 47 raste me një sipërfaqe prej 9 ha, 10614 rrënjë ullishte dhe 2 agrume; dëmin më të madh e ka patur bashkia Lushnje me 4795 rrënjë ullinj ose 45.2% të totalit, numrin më të vogël Bashkia Roskovec me 200 rrënjë ullinj ose 1.9% të totalit;

Sipërfaqe djerrë janë regjistruar 95 raste me një vlerë të sipërfaqes prej 506.4 ha, ku numrin më të lartë e ka bashkia Lushnje me 29 raste ose 30.5% dhe sipërfaqe prej 296.2 ha;

Ndërtesa banimi janë regjistruar 47 raste dhe 3 janë publike/biznesi, ku numri më i lartë është regjistruar në bashkinë Fier me 25 ndërtesa banimi ose 53.2% e totalit dhe 3 publike/biznesi ose 100% e totalit; numrin më të pakët të dëmit e ka bashkia Divjakë me 1 ndërtesë banimi ose 2.1 të totalit të rasteve;

Depo bari janë regjistruar 7 raste me numër të dengjeve të barit të djegur prej 7530, ku numrin më të lartë e ka Bashkia Fier me 4300 dengje ose 57.1% të totalit të dëmit dhe pa asnjë rast Bashkia Patos;

Automjete në total janë regjistruar 3 raste, ku 2 raste janë regjistruar në Bashkinë Roskovec dhe 1 në Bashkinë Mallakastër.

*Për vitin 2023* të dhënat mbi fatkeqësitë natyrore kryesisht zjarr, është më e plotë në përmbajtje të klasifikimit të informacionit të detajuar dhe është përpiluar nga AKMC, u konstatua se informacioni i përpiluar nga AKMC dhe vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk rezultoi i përpunuar nga SPPECK të Prefektit të Qarkut Fier, për një informacion të saktë dhe të qartë



mbi gjendjen dhe që do shërbente si bazë për të analizuar dhe hartuar planin e ri të masave parandaluese për periudhën në vijim, të dhëna sipas aneksit 1.3 bashkëlidhur RPA.

Në rrugë elektronike në datën 29.07.2023 ora 10.55 SPPECK/Prefekti i Qarkut Fier dërgoi një informacion shtesë, duke iu referuar akt konstatimit nr. 5 datë 25.07.2024, të cilin po e pasqyrojmë në tabelën e mëposhme:

Informacioni i humbjeve nga fatkeqësitë natyrore në Prefekturën e Qarkut Fier - Viti 2023															
Bashki	Nr	Ek.pyjore			Ullishte/agrume				Sip Dierr		Ndërtesa		Depo Bari		Autom jet
		Nr	Sip/ha	Sip djeg	Nr	Sip/ha	Rrenj djeg	Agrm ha	Nr	Sip/ha	Banim	Publ bizn	nr	Sasi/dëng	Nr
Fier	63	17	1006.2	175	9	44.7	4940	220	23	144.45	13	0	1	50	0
Lushnje	52	0	0	0	2	55	664	2	35	120.66	10	1	2	1000	2
Mallakastër	13	0	0	0	5	31	660	0	5	6.7	1	1	1	120	0
Divjakë	27	1	0.1	0	3	1	130	20	22	53.353	1	0	0	1040	0
Patos	31	1	0.2	0	5	48.4	1136	0	21	16.31	2	0	0	0	2
Roskovec	27	3	9.5	0	8	18.3	1145	0	11	19.5	3	0	0	260	2
ADZM	0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>213</b>	<b>22</b>	<b>1016</b>	<b>175</b>	<b>32</b>	<b>198</b>	<b>8675</b>	<b>242</b>	<b>117</b>	<b>361</b>	<b>30</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>2470</b>	<b>6</b>

Burimi: SPPECK PQF/Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi i informacionit të vënë në dispozicion dhe pasqyruar në tabelat përmbledhëse rezulton se: për vitin 2023 tabela mbi fatkeqësitë natyrore kryesisht zjarr, është përpiluar nga SPPECK në PQ Fier mbi raportet e dërguara nga 6 bashkitë e Qarkut Fier.

Kështu janë në total 213 raste të regjistruara pra janë 3 raste më shumë se në vitin 2022, ku numri më i lartë është regjistruar në Bashkinë Fier me 63 raste ose 29.6% të totalit; numrin më të vogël të rasteve e ka Bashkia Mallakastër me 13 raste ose 6.1% e totalit.

Nga ekonomia pyjore janë regjistruar 22 raste, pra 14 raste më shumë se viti 2022, ku janë djegur 175 ha pyje e cila i përket Bashkisë Fier;

Për ullishte dhe agrume janë regjistruar 32 ose 15 raste më pak se në vitin 2022, me një sipërfaqe prej 198 ha, 8675 rrënjë ullishte dhe 242 ha agrume; Pra numri i rasteve ka ardhur në rënie por sip e përfshirë është 189 ha më shumë, rrënjë ullinj të djegur janë 1939 rrënjë më pak dhe 240 ha agrume më shumë se në vitin 2022; demin më të madh e ka patur Bashkia Fier me 4940 rrënjë ullinj ose 57% të totali, numrin më të vogël Bashkia Divjakë me 130 rrënjë ullinj ose 1.5% të totalit;

Sipërfaqe dierrë janë regjistruar 117 raste ose 22 raste më shumë se në vitin 2022 me një vlerë të sipërfaqes prej 361 ha, ku numrin më të lartë e ka bashkia Lushnje me 35 raste ose 29.9% dhe sipërfaqen e dëmtuar e ka Bashkia Fier prej 144.45 ha ose 40% e sipërfaqes në total; numrin më të vogël e ka Bashkia Mallakastër me 5 raste dhe sipërfaqe të dëmtuar prej 6.7 ha;

Ndërtesa banimi janë regjistruar 30 raste dhe 2 janë publike/biznesi ose 17 raste më pak për banesat dhe 1 rast më pak për ndërtesa publike/biznesi se në vitin 2022, ku numri më i lartë është regjistruar në bashkinë Fier me 13 ndërtesa banimi ose 43.3% e totalit dhe me nga 1 ndërtesë publike/biznesi ose 50% e totalit për Bashkitë Mallakastër dhe Lushnje; numrin më të pakët të demit e kanë Bashkitë Divjakë dhe Mallakastër me 1 ndërtesë banimi ose 3.3% të totalit të rasteve dhe Bashkitë Fier, Divjakë, Patos dhe Roskovec me asnjë rast ndërtesë publike/biznesi;

Depo bari janë regjistruar 4 raste ose 3 raste më pak se në vitin 2022 me numrin total të dëngjeve të barit të djegur prej 2470 ose 5060 dëngje më pak, ku numrin më të lartë e ka Bashkia Divjakë me 1040 dëngje ose 42.1% të totalit të demit dhe me asnjë rast Bashkia Patos; Automjete në total janë regjistruar 6 raste ose 3 raste më shumë se në vitin 2022, ku nga 2 raste janë regjistruar në Bashkitë Lushnje, Patos dhe Roskovec.

**Konstatim:** Nga informacioni përmbledhës i evidencave dhe pasqyruar në tabelat e mësipërme, mbi bilancin e dëmeve të shkaktuara në territorin e qarkut Fier, rezulton se në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 ka përkeqësim të gjendjes nga fatkeqësitë natyrore/zjarret në: numrin e rasteve, sipërfaqet e ekonomive pyjore të djegura, sipërfaqet e ullishteve, numrin e pemëve agrume, numrin e mjeteve të djegura.

Mbi kapacitetet e vëna në përdorim për normalizimin e situatave të fatkeqësive natyrore/kryesisht zjarre, sipas bashkive të Qarkut Fier, nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë, *rezulton se:*

*Për vitin 2022*, numri total i forcave që kanë marrë pjesë në përmirësimin e situatave të krijuar nga zjarret janë:

- 279 forca zjarrfikës, ku numrin më të lartë e ka bashkia Fier me 101 ose 36.2% dhe numrin më të vogël bashkia Divjakë me 13 ose 4.7% të numrit total të kësaj kategorie;
- 1244 mjete zjarrfikës, ku numrin më të lartë e ka bashkia Fier me 419 ose 33.9% dhe numrin më të vogël bashkia Divjakë me 45 mjete ose 3.6% të totalit;
- 297 forca policore; - 8 forca të armatosura; - 368 forca të bashkisë; - 1018 forca vullnetare; - 85 forca nga ADZM.

Informacion për vitin 2023							
Bashkite	F.zjarrfikëse	M.zjarr	F.Polic	Forc.Armat	F.Bashki	Forc.Vullnet	Sh.pyj/ADZM
Fier	144	723	178	85	314	835	56
Lushnje	79	335	151	35	171	382	6
Mallakastër	20	242	27	0	25	13	5
Divjakë	28	128	14	0	4	28	0
Patos	44	263	88	40	102	85	27
Roskovec	57	216	64	0	10	24	2
<b>Totali</b>	<b>376</b>	<b>1907</b>	<b>522</b>	<b>160</b>	<b>626</b>	<b>1367</b>	<b>96</b>

*Për vitin 2023*, numri total i forcave që kanë marrë pjesë në përmirësimin e situatave të krijuar nga zjarret janë:

- 376 forca zjarrfikës ose 97 më shumë se në vitin 2022, ku numrin më të lartë e ka Bashkia Fier me 144 ose 39.3% dhe numrin më të vogël Bashkia Mallakastër me 20 ose 0.5% të numrit total të kësaj kategorie;
- 1907 mjete zjarrfikës ose 663 më shumë se në vitin 2022, ku numrin më të lartë e ka Bashkia Fier me 723 ose 37.9% dhe numrin më të vogël Bashkia Divjakë me 128 mjete ose 6.7% të totalit;
- 522 forca policore ose 225 më shumë se në vitin 2022, ku numrin më të lartë e ka Bashkia Fier me 178 ose 34.1 të totalit, dhe numrin më të vogël e ka Bashkia Divjakë me 14 ose 2.7%;
- 160 forca të armatosura ose 152 më shumë se në vitin 2022, ku numrin më të lartë e ka Bashkia Fier me 85 ose 5.3% të totalit dhe me asnjë Bashkitë Mallakastër, Divjakë dhe Roskovec;
- 626 forca të bashkisë ose 258 më shumë se në vitin 2022, ku numrin më të lartë e ka Bashkia Fier me 314 ose 50.2% të totalit dhe numrin më të vogël e ka Bashkia Divjakë me 4 ose 0.6% të totalit;
- 1367 forca vullnetare ose 349 më shumë se në vitin 2022, ku numrin më të lartë e ka Bashkia Fier me 835 ose 61.1% të totalit dhe numrin më të vogël e ka Bashkia Mallakastër me 13 ose 1% e totalit;
- 96 forca nga ADZM ose 11 raste më shumë se në vitin 2022, ku numrin më të lartë e ka ADZM Fier me 56 ose 58.3% e totalit dhe me asnjë është ADZM Divjakë.

**Konstatimi:** Nga informacioni përmbledhës i evidencave dhe pasqyruar në tabelat e mësipërme, mbi kapacitetet njerëzore dhe material/teknike e mekanike të angazhuara për normalizimin e situatës në territorin e Qarkut Fier shkaktuar nga zjarret, rezulton se në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 *ka rritje të numrit të tyre si rezultat i përkeqësimit të gjendjes* nga fatkeqësitë natyrore/zjarret në: forcat zjarrfikëse, mjetet zjarrfikës, forcat e policisë, forcat e armatosura, forcat e bashkisë, forcat vullnetare dhe nga ADZM.

**Konstatimi:** Nga informacioni përmbledhës i evidencave dhe pasqyruar në tabelat respektive, rezulton se për të dy vitet 2022 e 2023 territori i Bashkisë Fier rezulton të jetë përfshirë me numrin më të lartë të rasteve nga fatkeqësitë natyrore/zjarret dhe me bilancin më të lartë të dëmeve të shkaktuara, të cilat kanë ardhur në rritje nga viti 2022 në vitin 2023, dhe rrjedhimisht me numrin më të lartë të kapaciteteve angazhuar në operacionet për normalizimin e situatës.

10. Nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier nuk është dokumentuar asnjë akt të lidhur apo plane masash të miratuara në kuadër të bashkëpunimit apo bashkërendimit të veprimtarisë mes Prefekturës së Qarkut Fier dhe atyre të qarqeve fqinje, kryesisht mbi zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, me qëllim bashkimin e kapaciteteve të tyre për trajtimin e çështjeve të përbashkëta në këtë fushë, në moszbatim të nenit 28 pika I të Ligjit nr. 45/2019 “për mbrojtjen civile”. Bashkëpunimin e realizojnë thjesht në bazë të parimit të subsidiaritetit konformë nenit 7, ligji 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

Nga SPPECK na u komunikua: “Gjatë situatave emergjente mbajmë kontakte të vazhdueshme dhe monitorojmë në kronologji situatën, kur konstatohet nga të dhënat e administruara se kapacitet në nivel vendor janë rezauruar, kërkohet mbështetje nga qarqet fqinje apo edhe nga strukturat të tjera qendrore. Kjo procedurë realizohet nëpërmjet kërkesave, rast pas rasti”.

*Nga sa më lart, arrihet në konkluzionin se menaxhimi i situatave të fatkeqësive natyrore duke u mbështetur thjesht në parimin e subsidiaritetit, rikon efektivitetin e tij, pasi nuk dihet paraprakisht numri dhe lloji i kapaciteteve të mbrojtjes civile që disponon çdo NJVQV e Institucionit të Prefektit të Qarqeve fqinje si dhe mundësisë së vënies në dispozicion në çdo kohë e rast, si dhe masën e mbulimit të territoreve të përfshira nga fatkeqësia.*

11. Nga Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier, nuk janë zhvilluar kontrole mbi zbatimin e masave të marra nga bashkitë e qarkut për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile; Por informacioni merret nëpërmjet takimeve që organizon Prefekti i Qarkut Fier me Komisionin e Mbrojtjes Civile. Strukturat Vendore të Mbrojtjes Civile raportojnë mbi marrjen e masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë. Pra Prefekti i Qarkut Fier dhe SPPECK nuk ka një plan periodik apo vjetor kontrolli në NJVQV për zbatimin masave të marra prej tyre për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

*- Masat e marra nga Prefekti i Qarkut Fier për zbatimin e Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8 “Përgjegjësitë kryesore të Prefektit të Qarkut” (detyrat dhe kompetencat mbi emergjencat civile).*

1. Institucioni i Prefektit të Qarkut raporton pranë Drejtorisë për çështjet Vendore dhe Prefekturat, pranë Ministrisë së Brendshme. Raportojnë çdo ditë të enjte në Kryeministri të Zyra operacionale e situatës [ZOS], lidhur me veprimtaritë kryesore të sektorit tonë. Raportimi bëhet në rrugë zyrtare elektronike. Nga auditimi rezulton se raportimet janë bërë rregullisht, por në mungesë të regjistrimit të raporteve në regjistrin e protokollit institucional. Konstatohet se nga ana e Prefektit të Qarku Fier dhe struktura përgjegjëse Sektori i Monitorimit të Komptencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, nuk ka një regjistër për regjistrimin e raportimeve të kryera, me qëllim ruajtjen e gjurmës së auditimit.

Formati i raportit ndahet në 3 kategori nëpërmjet 3 ngjyrave të ndryshe që identifikojnë situatat me njëra – tjetrën. Ngjyra e kuqe për situata emergjente, ngjyra e verdhë për situata më pak emergjente ( alert) dhe ngjyra jeshile që lidhet me aktivitetet që kemi kryer ose në të cilat kemi marrë pjesë.

2. Shkresat mbi informimin çdo gjashtë muaj të institucioneve qendrore për veprimtarinë e strukturave të tyre të varësisë, në nivel qarku. Institucioni i Prefektit të Qarkut raporton pranë Drejtorisë për çështjet Vendore dhe Prefekturat, pranë Ministrisë së Brendshme.

Drejtoritë rajonale raportojnë në mënyrë të pavarur dhe kanë detyrimin sipas legjisllacionit me të cilin operojnë të raportojnë në institucionet qendrore pra bazuar nga cili institucion e kanë varësinë.

3. Institucioni i Prefektit të Qarkut nuk ka praktikë mbi marrëveshjet e lidhura me institucionet homologe. Njoftimet nga ana e PQ Fier për takim të Komisionit të Mbrojtjes Civile në situata paraemergjente ose emergjente.

4. Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier çdo vit iu dërgon shkresë 6 bashkive lidhur me kalendarin e festave zyrtare: për vitin 2022 me shkresën nr. 120 prot., datë 01.02.2022; për

vitin 2023 me shkresën nr. .... Prefekti i Qarkut njoftohet personalisht për pjesëmarrjen në festat zyrtare.

5. Nga ana e SFSHM merren masa dhe në vijimësi raportohet mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit, por *rezulton* se Plane pune të miratuara për forcimin e kapaciteteve institucionale në zbatim të programeve të buxhetit të shtetit nuk ka, pasi dhe takime të GMS nuk janë realizuar.

6. Plani vjetor për vitin 2022 dhe vitin 2023 hartohen në fillim të vitit dhe dorëzohen fizikisht tek Sekretari i Përgjithshëm.

a. Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier drejton Komitetin e turizmit dhe task – forcën. Është realizuar koordinimi dhe është ofruar bashkëpunimi nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut bazuar në kërkesat e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për bashkëpunim me NJVQV për një mbarëvajtje sa më të mirë të Sezonit Turistik dhe për sigurimin e një sezoni të suksesshëm turistik. Janë zhvilluar mbledhjet e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit:

b. Institucioni i Prefektit të Qarkut drejton Komitetin Rajonal të Luftës Kundër trafikimit të Personave KRAT dhe Tryezën Teknike Rajonale për Luftën Kundër Trafikimit të Personave. Janë ndjekur aktivitetet për dhunën në familje, dhunën ndaj grave dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Janë realizuar takimet pranë Institucionit të Prefektit.

*Për vitin 2023*, Prefekti i Qarkut ka ndjekur edhe paketën e sigurisë në shkolla, si një nismë e Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Është raportuar çdo ditë të premtë në mënyrë elektronike në adresë të Ministrisë së Brendshme, lidhur me veprimtarinë e çdo aktori të përfshirë në paketën e sigurisë në shkolla. Të gjithë këta aktorë kanë raportuar në një grup të përbashkët, të krijuar në rrjetin wcap. Nga auditimi rezulton se nuk ka patur raste mosmarrëveshesh nga drejtuesit e institucioneve.

7. Institucioni i Prefektit të Qarkut kërkon çdo muaj në mënyrë elektronike veprimtarinë e degëve territoriale. Degët territoriale raportojnë pranë institucionit të Prefektit dhe ky raport dërgohet zyrtarisht në Ministrinë e Brendshme, konform nenit 10 të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

8. Nga Prefekti i Qarkut Fier nuk janë miratuar plan kontrole të cilat synojnë marrjen e masave për zbatimin e programit të qeverisë, për ushtrimin e funksioneve dhe plotësimin e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e degës përkatëse.

- Nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier grupit të auditimit iu komunikua se nga ana e tyre nuk janë paraqitur mendime ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore mbi projekte të ndryshme për zhvillimin e territorit të qarkut për përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve dhe sigurinë sepse sipas tyre nuk është kërkuar. Konstatohet se ky mosveprim nga ana e Prefektit të Qarkut Fier është në kundërshtim të Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 10 pika b;

- Nga ana e Prefektit të Qarkut Fier i është kërkuar Degës Territoriale informacion periodik mbi veprimtarinë e tyre institucionale, konform nenit 10 pika ç të Ligjit nr. 107/2016. Rezulton se institucionet e Degës Territoriale Fier kanë raportuar brenda afatit Prefektin e Qarkut Fier.

9. Nga auditimi konstatohet se deri në 31.12.2023 nga PQ Fier nuk ka një databazë ose regjistër ku të jenë listuar kërkesat dhe ankesat e shtetasve për vitin 2022/ 2023.

Kërkesë – ankesat e qytetarëve trajtohen nga Sektori i Monitorimit të Kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara. Edhe pritja e këtyre qytetarëve realizohet nga ky sektor. Bazuar në natyrën që kanë kërkesë – ankesat, ju drejtoheni me shkresë zyrtare institucionit përkatës. Të gjitha kërkesë – ankesat e paraqitura pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut u janë adresuar institucioneve përgjegjëse, por konstatohet se nuk ka një praktikë të ndjekur deri tani që Institucionet të cilave iu është adresuar zgjidhja e problemit të qytetarit/ve nuk e ka vënë në dijeni PQ Fier mbi vijueshmërinë e procedurës dhe statusin e problemit.

10. Institucioni i Prefektit të Qarkut bashkëpunon me Policinë e Shtetit vazhdimisht për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, në zbatim të nenit 12 të Ligjit nr. 107/2016, ka patur bashkëpunim me Policinë e Shtetit.

Prefekti i Qarkut Fier ka raportuar rregullisht ministrive përgjegjëse dhe Kryeministrisë mbi aktivitetin mujor dhe vjetor të saj, mbështetur edhe në raportet periodike të veprimtarisë së degëve territoriale të Qarkut Fier.


Për sa më lart, mosveprimet nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier dhe strukturave përgjegjëse për Emergjencat civile janë në kundërshtim me:

- Ligji nr.45 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen civile”;
- Ligji nr. 107 dt. 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar;
- VKM nr. 923 datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimin e komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”;
- VKM nr. 345 datë 26.05.2022 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë”;
- Rregulloren e Brendshme e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 175 datë 09.07.2020, Kreu II neni 7, neni 8, neni 13, nga personat përgjegjës: **L.SH**, me detyrë ish-Prefekt i Qarkut Fier deri datë 31.12.2023, **A.V**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Prefekturës dhe **K.Y**, me detyrë Përgjegjës SPPECK.

- **Mbi zbatimin e procedurave për Inventarizimi i aseteve.**

Grupi i auditimit referuar Udhëzimit të MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”, ku të gjitha njësitë e sektorit publik, kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, konstatojë se:

Praktikat e procedurave të inventarizimit për periudhën 2022 - 2023.



Skema e Procedurës së Inventarizimit

Nga Prefekti i Qarkut Fier janë zbatuar dispozitat referuar Udhëzimit të MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

2. Praktika shkresore për ngritjen e komisioneve për vitet: 2019, 2020, 2021 dhe 2022 dhe statusi i çdo faze të procedurës së Inventarizimit të Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier, është si më poshtë vijon:

Viti	Urdhrat Brendshëm për Komisionet e Inventarit Fizik & vlerësim paraprak	Relacion	Urdhrat Brendshëm për Komisionet e Vlerësimit	Relacion	Urdhrat Brendshëm për Komisionin e Asgjesimit	Relacioni	Vlera e aktiveve vlerësuar të dëmtuara/për asgjesim(në lekë)	Statusi Procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit
2022	*UB. 1098 prot. dt. 21.10.2022	*Nr. 104 prot. dt. 27.01.2023	UB. 1099 prot dt. 21.10.2022	Nr. 108 prot dt. 27.01.2023	Nuk ka	Nuk ka	334,758	Nuk ka

	1 shkresë		1 shkresë		Nuk ka		334,758	Nuk ka
2023	*UB. 28 prot dt. 11.01.2023	Nr. 1306 prot dt. 29.12.2023	UB. .29 prot. dt.11.01.2023	Nr. 1306/1 prot. Dt.29.12.2023	Nuk ka	Nuk ka	828,345	Nuk ka
	1 shkresë		1 shkresë		Nuk ka		828,345	Nuk ka

Punoi: Grupi i auditimit

### **Konstatime:**

- Me UB nr. dhe me nr. 1098 prot., dt. 21.10.2022 dhe UB nr. 8 dhe me nr. 28 prot., datë 11.01.2023 është caktuar **E.S** Kryetar i komisionit të inventarizimit të aktiveve për 2 vite radhazi 2022 dhe 2023, duke mos zbatuar kriteret e Udhëzimit të MF nr. 30/2011 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 84.
- Urdhrat e miratuar nga Prefekti nuk kanë të përcaktuar afatin kohor që duhet të realizohet procedura e inventarizimit të aktiveve të PQ Fier, duke riskuar për zvarritje të procedurës;
- Prefekti i Qarkut Fier nuk ka miratuar Rregullore të unifikuar<sup>4</sup> “Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve (inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve), në kundërshtim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 6,7,8,9 dhe 17,18,19;
- Për vitet 2022 dhe 2023 nga ana e SFSHM nuk është hartuar regjistri i aktiveve, mbi të cilin bën verifikimet fizike. Komisioni i caktuar për inventarizimin vjetor të aktiveve; komisionet e inventarit fizik dhe të vlerësimit paraprak kanë përpiluar relacionin me listën e aktiveve të dëmtuara për procedura të mëtejshme (tabela 1) – në vlerat respektive: 334,758 lekë dhe 828,345 lekë. Nga ana e NA nëpërmjet UB nr. 28 datë 21.10.2022 dhe UB nr. 09 datë 11.01.2023 janë ngritur komisionet e vlerësimit përfundimtar të tyre, me qëllim nxjerrjen e aktiveve të dëmtuara për jashtë përdorimit/asgjësimit, kjo në zbatim të Udhëzimit nr. 30/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kreu IV paragrafi 3 pika 96;
- NZ ka ndjekur përmbylljen e procesit të inventarizimit për fazën e parë “verifikimit fizik dhe vlerësimit paraprak për vitet 2022 dhe 2022, duke hartuar përmbledhësen e inventarëve sipas zyrave/magazinave dhe personave që i kanë në ngarkim, si dhe regjistrin e aktiveve afatgjata për llog. 202, llog. 210, llog. 212, llog. 213, llog. 214, llog. 215, llog. 218.
- Sektori i Financës dhe i Shërbimeve mbështetëse ka krijuar regjistër manual dhe elektronik të aktiveve sipas formatit të miratuar në Udhëzimin nr. 30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, por që nuk është bërë pjesë e praktikës së inventarizimit, përcjellë te Titullari për njohje dhe miratim;
- Titullari i Institucionit të PQ Fier me Urdhër të brendshëm, referuar Relacionit të inventarëve të vlerësuara të dëmtuara për jashtë përdorimit, në bashkëpunim me NZ duhet të analizojë kategoritë e veçanta të tyre (pajisje kompjuterike, kondicionerë, TV etj.), për të cilat në mungesë të një specialisti IT si pjesë e stafit, duhet një ekspert i fushës për vlerësim përfundimtar të gjendjes së tyre. Kjo ndikon në vendimmarrjen mbi statusin e aktivitetit në periudhën e ardhme, sipas Udhëzimit nr. 30/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Kreu IV pika 95-106;
- Titullari i Institucionit të PQ Fier nuk ka nxjerrë veçmas Urdhrin për ngritjen e komisionit të nxjerrjes dhe asgjësimit të aktiveve të vlerësuara të dëmtuara për jashtë përdorimit, në kundërshtim me Kreun IV pika 96-101.

Nga verifikimi i dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti, rezultoi se nga ana e Titullarit kanë dalë Urdhrat e Brendshëm për krijimin e GMS.

Në Urdhrat e Brendshëm të Titullarit nuk është caktuar Koordinatori i Riskut dhe Koordinatori MFK, referuar Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, neni 8. Nuk janë hartuar grafikët e takimeve vjetore të GMS dhe rrjedhimisht nuk ka as dokumentim të takimeve të realizuara gjatë viteve 2022 e 2023, në moszbatim të Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin” dhe Manualit MFK.

<sup>4</sup> Sektori i Financës dhe shërbimeve mbështetëse ka hartuar Rregullore të vetën.

Regjistri i aktiveve të Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier në mënyrë të përmbledhur si në tabelat më poshtë:

Magazina	Gjendja në lekë
31.12.2022	2,478,399
31.12.2023	2,179,289.72

Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Nr.	Ushtrimi Mbyllur 2023	Nr.	Ushtrimi i Mbyllur 2022	Ushtrimi i Mbyllur 2021
<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>		<b>27,855,986</b>		<b>27,761,304</b>	<b>29,247,196</b>
210	Toka, Troje, Terrene		2,410,440	1	2,401,440	2,401,440
212	Ndërtesa e Konstruksione		18,635,129	3	18,275,141	19,236,991
215	Mjete Transporti		957,677	2	1,197,096	1,496,370
218	Inventar ekonomik		5,881,740	297	5,887,627	6,112,395

Në RPA të realizuar nga NJAB e MB përcjellë në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me nr. 1079/5 prot., datë 15.04.2024 dhe regjistruar në Institucionin e PQ Fier me nr. 355/2 prot datë 17.04.2024, lidhur me procedurën e inventarizimit janë lënë këto 2 Rekomandime:

*“R.1-(i rikërkuar) Menaxhimi i lartë të marrë në analizë gjetjen për aktivin e rezultuar mangut dhe të ngarkojë Sektorin e financës dhe Sektorin juridik që të kryejë gjurmën e auditimit për përcaktimin e personit përgjegjës për mjetin me targë FR xxx B me nr. Shasie WDB123,,,,1784 rezultuar mangut nga inventarizimi fizik, në përfundim të merret në evidencë kontabile duke e pozicionuar në llogarinë përkatëse sipas përcaktimit në kërkesat e ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe raportimin në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.* Nga Institucioni i PQ Fier ky Rekomandim është pranuar, janë caktuar personat përgjegjës për zbatimin e tij dhe është raportuar mbi masat e marra. Për këtë me shkresën nr. 743/2 prot., datë 30.07.2020 të Prefektit të Qarkut janë cilësuar personat përgjegjës së ngjarjes si dhe është bërë kallëzim në polici. Çështja është në Prokurori.

*R.2- Nëpunësi zbatues brenda strukturës të caktojë personin përgjegjës për krijimin e regjistrit kontabël të aktiveve”.*

Nga Institucioni i PQ Fier është pranuar Rekomandimi i lënë, janë caktuar personat përgjegjës për zbatimin e tij, si dhe konfirmuar statusi i zbatuar.

#### **Konkluzion:**

1. Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier nuk ka miratuar Rregulloren e unifikuar “Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve (inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve).
2. Nuk janë realizuar takime të GMS ku të diskutohen dhe të merren masat e nevojshme për miratimin e një baze të plotë rregullatore lidhur me dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.
3. Nga ana e Prefektit i Qarkut Fier në cilësinë e NA dhe Koordinatorit të Riskut/ Koordinatorit MFK dhe e Nëpunësit Zbatues, nuk janë ndjekur rigorozisht të gjithë hapat e procedurës së inventarizimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar), neni 8,9,10,11,12 dhe 27; Manualin mbi Menaxhimin Financiar dhe kontrollin; Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; Udhëzimin nr. 16, dt. 20.07,2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Udhëzimin nr. 21/2016 “Për menaxherët e të gjitha niveleve”; Rregullore e Brendshme e Institucionit të Prefektit të Qarkut miratuar me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 175 datë 09.07.2020 dhe me nr. 3815/1 prot., datë 09.07.2020, duke ngarkuar me përgjegjësi: **L.SH**, me detyrë ish-Prefekti i Qarkut Fier për periudhën 01.01.2022-31.12.2023 dhe **S.Ç**, me detyrë Përgjegjës SFSHM, në cilësinë e NZ.

- **Mbi strukturën organizative, organikën dhe zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2023 në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier).**

*- Verifikim mbi strukturën organizative, organika dhe zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2023 në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier”.*

Prefekti i Qarkut Fier, është njësi në varësi të Ministrisë së Brendshme. Struktura Organizative dhe niveli i pagave miratohen me VKM, ndërsa buxheti për zhvillimin e aktivitetit të saj miratohen nga Ministria e Brendshme. Misioni i Prefektit të Qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave, në nivel qarku. Për një ushtrim efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave institucionale dhe në arritjen e objektivave në rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional rajonal, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative, për Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Urdhrin nr. 4 datë 12.01.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Fier”, është kompozuar struktura organizative për të përmbushur misionin dhe arritur objektivat.

Struktura organizative e miratuar e Prefektit të Qarkut Fier:

<b>EMËRTIMI</b>	<b>Nr.</b>
Prefekti	1
Sekretar	1
<i>N/Prefekti Mallakastër</i>	1
<i>N/Prefekti Lushnje</i>	1
Koordinator/Sekretar i Përgjithshëm	1
Spektori i Monitorimit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara	6
Spektori i Zhvillimit Urban	3
Spektori i Planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave	4
Spektori Juridik	4
Spektori i Financës dhe shërbimeve mbështetëse	7
<b>Gjithsej</b>	<b>29</b>

<b>Viti</b>	<b>Buxheti faktik i llog 600+601</b>	<b>Nr. i Drejtorive</b>	<b>Nr. i Sektorëve</b>	<b>Nr. i stafit Plan / Fakt</b>	
2016-2021		0	5	29	29
2022	25,443,491	0	5	29	27
2023	35,091,984	0	5	29	27

*Burimi: Prefekti i Qarkut Fier*

Struktura organizative e Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier përmban **29 punonjës** dhe për viti 2022 ka funksionuar me **28 punonjës**, pasi Nënprefekti i Lushnjës ka dhënë dorëheqjen. Ndërsa për vitin 2023, struktura organizative e Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier përmban 29 punonjës dhe ka funksionuar me 28 punonjës dhe është mbyllur me **27 punonjës**, pasi është larguar duke dhënë dorëheqjen në përfundim të afatit vjetor të lejes së lindjes, edhe përgjegjësja e SMKVFDD.

**Konstatim:** Formularët e përshkrimit të pozicioneve të punës nuk kanë përfshirë nënrubrikën e kritereve të përgjithshme/formimin arsimor e profesional/vjetërsinë e çdo pozicioni, në moszbatim të kërkesave në VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i



ndryshuar, Lidhja 3; Udhëzimi nr. 01 datë 31.05.2017 i DAP “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në Shërbimin civil”.

Struktura e Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier është hartuar/miratur me Urdhrin nr. 4 datë 12.02.2016 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së administratës së Prefektit të Qarkut të Fierit”, ku specifikohen elementët që duhet të përmbajë: pozicioni, kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion, numrin e personelit për çdo pozicion, në përputhje kjo me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu nga tabela rezultoi se ka rikompozime të njësive të strukturës, lëvizje të numrit të personelit dhe qarkullim të tyre brenda njësisë. Si rezultat i ristrukturimeve të Drejtorive apo sektorëve që janë shoqëruar edhe me pozicione të reja, ka patur efekte të cilat si vendeve vakante që janë në Prefekti i Qarkut Fier, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Viti	Numri i Punonjësve		Diferenca
	Plan	Fakt	
2022	29	27	2
2023	29	27	2

Burimi: SFSHM/Prefekti i Qarkut Fier

Njoftimet për vendet vakante publikohen edhe në stendat e institucionit dhe në web-in e Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier, si organ epror i saj. Për pozicionet marrëdhëniet e punës të cilave rregullohen me Kod Pune, rezultoi se nuk dërgohet shpallja e vendit vakant në Shërbimin Kombëtar të Punësimit/Portali i punësimit, në moszbatim të Ligjit nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 19 pika 2.

Vendet vakante (2) janë krijuar si rezultat i largimeve të punonjësve për arsye të ndryshme (me dorëheqje).

Viti 2022-2023				
Emër Mbiemër	Filluar punë	Larguar	Pozicioni në strukturë	Statusi (nc/kp)
Fatjona Prifti	24.01.2020	30.10.2023 (dorëheqje)	Përgjegjëse MKV&FD	NC
		2022	Nënprefekt i Lushnjës	
		01.10.2022	Specialist SPPECK	NC

Nuk ka procese gjyqësore të nisura nga punonjës të larguar.

- Nga verifikimi i disa dosjeve të personelit gjatë periudhës audituese 01.01.2022-31.12.2023, rezultoi se dokumentacioni i tyre përgjithësisht ishte i plotë konform VKM nr. 117/2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit” i ndryshuar me VKM nr. 833/2020 datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrimit Qendror të personelit” kreu I pika 1, Kreu II pika 4, por ndryshimet e personelit në pozicione brenda të njëjtit sektor apo nga një sektor në tjetrin, nuk është shoqëruar me krijimin e një praktike të re me dokumentacion të përditësuar dhe të sistemuar në fashikull, ndonëse i përkasin të njëjtës dosje personeli.

- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse [SFSHM], si struktura përgjegjëse për personelin, njofton për çdo rast Koordinatorin (tani Sekretarin e Përgjithshëm dhe Prefektin) mbi vendet vakante në strukturën organizative të njësisë publike. DAP çdo vit nxjerr Urdhrrat për ngritjen e Komisionit që ndjek procedurën e punësimit: njoftimi, konkurrimi, shqyrtimit të dokumentacionit të aplikuesit, etj., dhe ka afat një vjeçar. Ky komision përbëhet prej 5 anëtarësh, ku 2 prej tyre janë Sekretar i Përgjithshëm dhe Përgjegjës i Sektorit të Financave dhe shërbimeve mbështetëse; ndërsa 3 anëtarë janë përfaqësues të DAP.

- Nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier janë paraqitur kërkesa verbale në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të MB dhe parashikuar në PBA, mbi nevojat e institucionit për shtim të një pozicionit të specialistit IT dhe punësimit të dy punonjësve me kontratë të përkohshme (3

mujore) për shërbimet e arkivës. Këto kërkesa duhet të bëhen prezente në shkresën e nevojave për rekrutim që dërgohen çdo fundviti në Ministrinë e Brendshme. Ato duhet të përmbajnë: argumentimet për çdo pozicion shtesë, klasifikimin e vendeve të punës, numri i punonjësve për pozicion, klasifikimin e pagës.

- Niveli i pagave të Prefektit të Qarkut Fier miratohen me VKM, dhe te Lidhjet bashkëngjitur tyre përcaktohen Kategoria/klasa, Grupi, shtesa për vjetërsi, shtesa për vështirësi dhe shtesa për pozicion.

Paketa e rezistencës sociale;

- Nga auditimi mbi hartimin dhe miratimin e strukturës organizative dhe organigramës në strukturën e Prefekti i Qarkut Fier **u konstatua se nuk ka pozicione të caktuara** me status të “Grup i veçantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) kategori të ndryshme: persona me aftësi të kufizuar, jetimë, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptiane etj.) si personel administrativ apo të atyre me klasa; Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier nuk ka të punësuar me këtë status. Pra nuk ka gjetur zbatim Ligji nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligji nr.15/2019 dt.13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”. Pra rezulton se nga Prefekti i Qarkut Fier, nuk janë respektuar aktet ligjore e nënligjore për dhënie përparësie rekrutimit të personave të grupit të veçantë.

- Gjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2023 janë punësuar dy specialistë me statusin “ekselent”, në zbatim të VKM nr. 586, datë 30.08.2019 “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore” i ndryshuar;

- Gjatë periudhës audituese 01.01.2022-31.12.2023, nuk ka patur të punësuar me kontratë provizore (3 mujore);

- Gjatë periudhës audituese 01.01.2022-31.12.2023, nuk ka patur të punësuar me kohë të pjesshme;

- Nga praktika e listëpagesave (borderove), rezulton se praktika është e plotë me listëprezencën përmbledhëse, raportet mjekësore, kërkesat e personelit për ditë pushimi të miratuara nga titullari etj. Gjithë dokumentacioni shkresor është nënshkruar nga personat përgjegjës: menaxheri i njësisë përkatëse (përgjegjës sektori), përgjegjësi i burimeve njerëzore, Sekretari i përgjithshëm / Titullari.

- Listëpagesat mujore janë nënshkruar nga specialiste e financës për pagat dhe përgjegjësi i Sektorit të financës; Listëpagesat dhe urdhër shpenzimet përkatëse dorëzohen në 3 banka të nivelit të dytë, konform procedurave të dokumentuara ligjore.

- Lëvizjet brenda organikës janë realizuar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi;

- Në strukturën e Prefekti i Qarkut Fier , referuar fushës së aktivitetit të saj, ka 2 pozicione me shkallë vështirësie që punonjësit e këtyre pozicioneve në përmbushje të detyrës gjatë orarit zyrtar, trajtohen financiarisht brenda kuadrit ligjor.

- Në librin e kontabilizimit të pagave, nuk rezultojnë punonjës të paguar jashtë strukturës së miratuar.

- Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit mbi sigurimet shoqërore të punonjësve në PQ Fier, janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8434 datë 28.11.2008 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ligjit nr. 9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore në RSH”;

- Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier nuk rezultojnë punonjës të angazhuar në fushatën zgjedhore të Majit 2023;

- Sipas listëpagesave të verifikuara në librat e bankës për vitet 2022 dhe 2023, është zbatuar struktura sipas vendimeve të miratuara.

Në Raportin e Auditimit të ushtruar nga NJAB e MB përcjellë në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier, është lënë ky Rekomandim: “*Menaxhimi i lartë i Institucionit në bashkëpunim me DAP të kryejë procedurat e duhura administrative për plotësimin në organikë të vendeve vakante, lënë nga auditimet e mëparshme. Për periudhën e audituar mbeten vetëm 2 vende vakant (përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara, Nënprefekti i Lushnjës)*”.

Nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier është pranuar rekomandimi, janë caktuar personat përgjegjës për zbatimin e tij dhe është konfirmuar statusi “në vazhdimësi”<sup>5</sup>.

*Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, si dhe nenet 9, 10, 11 të Ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Udhëzimi i vitit 2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”*

1) Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, me persona përgjegjës: **L.SH ish- Prefekt i Qarkut Fier nga 01.01.2022 deri më 31.12.2023 dhe S.Ç Përgjegjës i SFSHM.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 852/2 prot, datë 30.8.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit" nga M.I dhe S.Ç, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendime të Subjektit:**

*Mbi Rekomandimi nr.8: Prefekti i Qarkut Fier në bashkëpunim me Sektorin e Financës dhe Sektorin Juridik, të marrin masa për:*

- Të zbatuar të gjitha hallkat e procedurës së inventarizimit të aktiveve të njësisë, kryesisht atë të nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjësimit të atyre të amortizuara sipas kuadrit ligjor në fuqi;
- Miratimin e një strategjie dhe Rregulloreje të unifikuar institucionale për menaxhimin e aktiveve, risqeve dhe ruajtjen e aktiveve të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi;
- Ngritjen e një grupi pune me ekspertë të fushës për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të atyre aktiveve (të llog. 218 “inventor ekonomik” dhe llog. 218/1 “pajisje kompjuterike”), vlera e mbetur e të cilave është e papërfillshme por që janë në gjendje pune;

*Nisjen e procedurave të ri/vlerësimit të aktiveve (llog. 210 “toka troje terrene” dhe llog. 212 “godina e konstruksione”) në ASHK Rajonale Fier, për të mundësuar regjistrimin në kontabilitet me vlerë reale të tyre.*

*Sqarojmë: Është ngritur urdhri i vlerësimit, nxjerrjes jashtë përdorimit dhe procedura e asgjësimit është në proces, pasi disa nga këto materiale duan specialist IT, i cili nuk është në strukturë të Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier. Këto materiale janë në ruajtje për zëvendësim të disa pjesëve për riparim ose zëvendësim sipas flet hyrjeve ekstra në datë 27.01.2023 dhe 29.12.2023. Është bërë miratimi i listës përfundimtare të aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit nga NA, për vitet 2022, 2023, është kryer procedura për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit (asgjësimi është në proces për arsyet e përmendura më lart).*

*Nga auditimi i dokumenteve dhe urdhrave është caktuar E.S Kryetar i komisionit të inventarizimit të aktiveve për dy vite radhazi 2022 dhe 2023 duke mos zbatuar kriteret e udhëzimit 30/2011 date 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 84 ku citohet se inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy here me radhe në të njëjtin vend nga i njëjti komision”*

*Bazuar në VKM 305, datë 05.04.2017, (Për disa shtesa ne VKM nr. 142 date 13.04.2014 te këshillit te ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, lidhja 3/1 pika 4, mbajtja e inventarëve është detyrë e specialistit të financës z. E.S dhe është vetëm specialisti i Financës i përsëritur dhe jo anëtarët e tjerë te komisionit. (sqarojmë se ne organike jemi 27 punonjës bashkë me shoferin e pastruesen hiq titullarët , dy me leje lindje, 20 vota mbetemi te shpërndarë neper komisione sipas urdhrave për zhvillimin e aktivitetit funksional te institucionit dhe ndonjë anëtar është përsëritur) Ligji Nr.10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 15, pika 2, “Nëpunësit zbatues dhe menaxherët e tjerë kanë të drejtën e delegimit të detyrave në vartësit funksionale duke specifikuar kërkesat për raportim dhe realizim të detyrave”, dokumentet bashkëngjitur.*

*Ne rekomandimin nr.8 cilësohet se ne urdhrat e brendshëm të titullarit nuk është caktuar Koordinatori i Riskut dhe Koordinatori i MFK si detyrime të përcaktuara nga Neni 8 i Ligji 10296 dt.08.07.2010. Sqarojmë; Ligji 10296 dt.08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin” në nenin 8, pika 3 të tij citon " Titullarët e njësisë publike, të përmendura në pikat 2 e 3 të nenit 3 të këtij ligji, mund të caktojnë një nëpunës të nivelit më të lartë drejtues dhe t'i ngarkojnë atij përgjegjësi që janë të barasvlershme me ato të nëpunësit autorizues". Së pari: Ligji nuk e përdor emërtimin Koordinator Risku apo Koordinator të MFK .Se dyti: Neni 8 i ligjit Ligji 10296 dt.08.07.2010 bën fjalë për një të drejtë, jo për një detyrim për të deleguar përgjegjësitë tek një person tjetër, nëpunës të nivelit më të lartë drejtues, përgjegjësi këto që janë të barasvlershme me ato të nëpunësit autorizues. Në këtë rast Prefekti i Qarkut Fier nuk e ka ushtruar të drejtën për të deleguar përgjegjësit e NA tek një person tjetër. Por kjo nuk përbën kundërshtim as me frymën dhe as me germën e ligjit.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Lidhur me observacionin tuaj mbi rekomandimin nr. 8, ju sjellim në mënyrë të përsëritur në vëmendjen tuaj si më poshtë vijon:

<sup>5</sup> Rekomandimet e lëna nga NJAB të MB pasqyrohen për një informacion sa më të plotë mbi aktivitetin e PQ Fier dhe merren të mirëqena nga grupi i auditimit të KLSH.

1. Grupi i auditimit gjatë procesit të auditimit pasqyron të dokumentuar (në Akt Konstatime, Akt Verifikime dhe në Projekt Raport) veprimet apo mosveprimet të cilat bien ndesh me kuadrin ligjor. Ato çka ju keni përshkruar në paragrafin e parë të observacionit tuaj sigurisht janë parë dhe marrë në konsideratë. Si çdo procedurë dhe ajo e inventarizimit për çdo etapë të saj ka një afat të përcaktuar kohor, i cili as nuk është përcaktuar në Urdhrat e brendshëm të Titullarit dhe sigurisht që as nuk janë dhënë sqarime në një dokument të hartuar nga NZ dhe miratuar nga NA; Pra ju nuk keni shprehur pezullimin e procedurës së asgjësimit në mënyrë të argumentuar deri në një moment tjetër si dhe në vijim, nuk keni marrë asnjë masë për të kompletuar komisionin e nxjerrjes jashtë përdorimit / asgjësimit me specialist IT. Për këtë arsye, pretendimi juaj nuk merret në konsideratë nga Grupi i auditimit.
2. Mbi pretendimin tuaj e shprehur në paragrafin e dytë, ju sjellim në vëmendjen tuaj se në komisionin e verifikimit fizik të aktiveve të njësisë mund të caktohen të gjithë punonjësit e njësisë publike me përjashtim të NZ dhe referuar pikës 84 të Udhëzimit nr. 30/2011 "Mbi inventarizimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik" pretendimi juaj nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.
3. Mbi pretendimin tuaj e shprehur në paragrafin e tretë, ju sjellim në mënyrë të përsëritur në vëmendjen tuaj se mosnjohja mjaftueshëm nga gjithë personeli i PQ Fier me ligjin nr. 10296/2010 "Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Manualin MFK si dhe Udhëzimeve nr. 16 datë 20.07.2016 "Për Koordinatorin e MFK dhe Koordinatorin e Riskut në Njësitë Publike" dhe atij nr. 21 datë 25.10.2016 "Për Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve", ka rezultuar ndër të tjera me mosveprime të NA edhe si koordinator i Riskut por edhe me mosaktimin nga ana e tij të Koordinatorit të MFK dhe të Koordinatorit të Riskut, duke sjellë mospërbushje në masë të plotë të detyrave si titullar i njësisë të caktuara në kuadrin ligjor të sipër cituar dhe atë rregullator të njësisë, në arritjen e objektivave institucionale. Për sa cituam, pretendimi juaj nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

## **2.2. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, për periudhën 01.01.2022 -31.12.2023.**

Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier çdo vit realizon blerje të punëve, furnizimit me mallrave ose shërbime nëpërmjet edhe procedurave të prokurimit me vlerë të vogël (BVV), në zbatim të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe paketës së Udhëzimeve të MF – APP<sup>6</sup> në periudhën 2022-2023.

Referuar Regjistrin të parashikimeve dhe Regjistrin të realizimeve të procedurave rezulton se ky regjistër ka si referencë vlerën e *llogarisë kontabël 602* me nënllogaritë përkatëse, duke pasqyruar vetëm emërtimin llogarive sipas Nomenklaturës së llogarive kontabël. Nga komunikimi verbal subjekti përcolli arsyetimin se i është referuar llog.602 "shpenzime operative" për kuadrim financiar.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e procedurave të prokurimit me vlera të larta dhe të vogla, rezulton se:

Për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar gjithsej **28** procedura me fond limit 10,444 mijë lekë dhe vlerë kontrate 9,822 mijë lekë, për diferencën 621 mijë lekë, ku sipas periudhave paraqitet si vijon:

**Për vitin 2022**, nga Prefektura e Qarkut Fier janë realizuar gjithsej **13** procedura me fond limit 4,682,407 lekë, me vlerë kontrate të lidhur prej 4,365,189 lekë, me një diferencë prej 317,218 lekë, nga e cila:

- a- *Me vlerë të lartë 1 procedura me fond limit 3,291,280 lekë pa TVSh, procedurë me objekt "Shërbimi i ruajtjes së objektit" e cila është bërë e përqendruar nga MB.*
- b- *Me vlerë të vogël janë 12 procedura me fond limit 1,391,127 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur 1,073,909 lekë ose më pak për vlerën 317,218 lekë. Pjesëmarrës në procedura gjithsej 30 OE, nga ku janë skualifikuar 11 OE.*
- c- *Në totalin e procedurave me vlerë të vogël, 9 procedura me fond limit 756,960 lekë dhe vlerë kontrate 691,789 lekë janë me fond limit nën 100,000 lekë.*

<sup>6</sup> MF Ministria e Financave. APP Agjencia e prokurimit publik

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është ngritur me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 04 prot., datë 11.01.2022, i përbërë nga P.F Kryetar, S.Ç dhe L.GJ anëtarë.

Regjistri fillestar i parashikimeve është hartuar në tejkalim të afatit ligjor<sup>7</sup>, në kundërshtim me VKM nr. 285 /2021 neni 3 pika 3, në të cilin citohet:

“Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të nevojave, gjatë periudhës shtator – dhjetor të çdo viti, përgatit regjistrin për vitin ushtrimor në vijim, bazuar në ligjin që miraton parashikimet buxhetore afatmesme. Në çdo rast, afati maksimal i hartimit të regjistrit është jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës”.

Regjistri i parashikimeve ka pësuar 2 ndryshime (shtim procedurash) nga regjistri fillestar por pa ndryshuar vlerën totale të fondit limit të parashikuar.

**Për vitin 2023**, nga Prefektura e Qarkut Fier janë realizuar gjithsej **15** procedura me fond limit 5,762,106 lekë, me vlerë kontrate të lidhur prej 5,457,780 lekë, me një diferencë prej 304,326 lekë, nga e cila:

a- Me vlerë të lartë 2 procedura me fond limit 4,408,593 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate 4,263,888 lekë pa TVSh. Në procedurat me vlerë të lartë, procedura me objekt “Shërbimi i ruajtjes së objektivit” është bërë e përqendruar nga MB.

b- Me vlerë të vogël janë 13 procedura me fond limit 1,353,513 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur 1,160,892 lekë ose më pak për vlerën 192,621 lekë. Pjesëmarrës në procedura gjithsej 61 OE, nga ku janë skualifikuar 27 OE.

c- Në totalin e procedurave me vlerë të vogël, 10 procedura me fond limit 683,333 lekë dhe vlerë kontrate 552,559 lekë janë me fond limit nën 100,000 lekë.

Me urdher nr. 06, datë 11.01.2023 (prot 30), të ish- Prefektit L.SH është ngritur Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, i përbërë nga: zj. L.S (Kryetare), P.F dhe S.Ç. Për vitin 2023 ky komision nuk është ndryshuar.

Me shkresën nr. 130 prot, datë 2.2.2023 është dërguar në Ministrinë e Brendshme regjistri i prokurimeve viti 2023, me vlerë totale 5,291,665 lekë pa TVSh.

Me shkresën nr. 206 prot, datë 21.2.2023 është përcjellë për Degën e Thesarit regjistri i procedurave viti 2023, me vlerë 5,291,665 lekë.

Me shkresën nr. 1004 prot, datë 26.9.2023, është përcjellë Degën e Thesarit regjistri i parashikimit me ndryshim, ku procedura shërbim ujë me vlerë 158,333 lekë është reduktuar në vlerën 33,333 lekë, si dhe shtuar procedura me fond limit 269,705 lekë.

Me shkresën nr. 1120/1, prot, datë 01.11.2023 është dërguar në Degën e Thesarit regjistri i parashikimit të procedurave viti 2023 (me ndryshime), për vlerën 8,100,000 lekë pa TVSh, ku procedura rikonstruksion zyre me fond limit 1,500 mijë lekë është ndarë në dy si: rikonstruksion zyre 1,117 mijë lekë dhe pajisje zyre 382 mijë lekë.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjeve fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurave si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, për periudhën objekt auditimi (01.01.2022 – 31.12.2023), rezulton se:

### ➤ **Për aktivitetin e vitit 2022**

Në regjistër janë përfshirë edhe vlera e shpenzimeve për pagesa shërbimesh jashtë procedurave të prokurimit dhe konkretisht: pagesa të faturave të energjisë (FSHU), pagesa të faturave ndaj UK sha, etj, në moszbatim të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar, Kreu II neni 3 pika 1, kjo për të dy periudhat objekt auditimi;

Procedurat e prokurimit BVV nuk kanë një përkrahje të shkurtër të mallrave, punëve apo shërbimeve që janë parashikuar për prokurim në moszbatim të Kreut I neni 2 pika 2/a ku citohet “....një përkrahje të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të

<sup>7</sup> Ligji nr. 115 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”

nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës”, sipas Aneksit 1 bashkëlidhur, jo për të dy periudhat objekt auditimi.

Grupi sipas materialitetit vlerësoj për auditim 3 procedura me fond limit 634,167 lekë ose 46% e fondit të prokuruar. Nga procedurat e audituara u konstatuan disa parregullsi në shkëlje me aktet ligjore të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimin nr. 03 datë 08.01.2018, si dhe Udhëzimin nr. 05 datë 25.06.2021.

Një informacion mbi planifikimin e procedurave për blerje me vlerë të vogël për mallra/grupmallra dhe shërbime/grupshërbime të të njëjtës natyrë, funksioni apo subjektet në cilësinë e OE me të njëjtën fushë aktiviteti, pasqyrohen në tabelën më poshtë:

GR	Nr. RR	Objekti i prokurimit në parashikim	Lloji i objektit	Financimi	Fondi limit	Vlera totale (me TVSh)
1		Pjesë këmbimi, goma bateri	mallra	Buxh.MB	72,000	128,162
		Shpenzime të tjera mjete transporti /aditiv+vaj		-/-	2,600	
		Pjesë këmbimi, goma dhe bateri /aditiv+vaj			18,000	
		-Pjesë këmbimi, goma dhe bateri/ferrota I-II;			11,000	
		Pjesë këmbimi, goma dhe bateri/ filtra -Shërbime të tjera transporti			24,562	
2		Shtypje e letrave me vlerë/lidhje aktesh Gj.Civile	mallra		118,200	126,000
		Shtypje e letrave me vlerë/lidhje aktesh Gj. Civile			7,800	
3		Shërbime te tjera/kartolina	mallra		27,000	209,904
		-Të tjera materiale dhe shërbime operative			18,000	
		-shpenzime mirëmbajtjeje/Certifikata mirënjohjeje				
		Kancelari/blerje artikujsh kancelarie			141,744	
		Blerje Kancelarie/ Letër zig-zag/kartela etj.			23,160	
		Shpenzime të tjera materiale e shp. Operative/flamuj të Ukraines			45,000	
4		Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës/blerje brave	mallra		2,000	5,600
		Shpenzime te tjera materiale dhe operative/bashkues plastik +zorre uji			5,400	
5		Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës /bojë printeri	Mallra /shërbime		47,520	248,320
		Shërbime të tjera/antivirus			10,000	
		Pajisje zyre/ print,copy,scan			190,800	

Nga auditimi mbi regjistrin e parashikimeve dhe atë të realizimit të prokurimeve për blerje me vlerë të vogël pasqyruar në tabelat e mësipërme u konstatua se: për mallra/grupmallra dhe shërbime/grupshërbime të njëjta, janë parashikuar në 5 raste procedura për të cilat është copëtuar fondi, ku në 4 raste me vlera në tejkallim të vlerës limit 100,000 lekë, kështu: **G 1**-rezulton se janë blerë mallra dhe kryer shërbimet në vlerën totale 128,162 lekë për mallra të të njëjtës natyrë por të kategorizuara të ndara duke çuar në anashkallim të procedurës së prokurimit dhe realizimin e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë te OE; **G 2** – për lidhje aktesh të Gjendjes civile në vlerën totale prej 126,000 lekë nuk i janë nënshtruar procedurës së prokurimit por janë realizuar veçmas ndonëse janë të të njëjtës natyrë dhe të realizuara te i njëjti OE; **G 3** – për mallra të kategorisë ‘kancelari’ me vlerë totale 209,904 lekë, rezulton se nuk janë përfshirë në procedurën e parashikuar dhe të realizuar ”blerje kancelarie” me vlerë të fondit limit prej 142,000 lekë edhe procedurat për blerje mallrash ([kartolina], [çertifikata mirënjohje], [letër zig-zag, kartela, etj.] etj.) të cilat ndonëse janë të të njëjtës natyrë e lloj nuk janë përfshirë në procedurën e përshtuar më lart; **G 5** – procedura për blerje bojë printeri nuk është përfshirë në procedurën e blerje prit/copy/skan në vlerën prej 190,800 lekë, ndonëse janë të të njëjti lloj dhe të ofruara nga OE me të njëjtën fushë veprimtarie duke i realizuar si blerje më vete. Për sa më lart rezulton në kundërshtim me nenin 56 pika 11 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimi nr. 4 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrimit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrimit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, Udhëzimi nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, Udhëzimi nr. 05, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në manualin teknik që shoqëron Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike.

*Nga dosjet e 2 procedurave të parashikuara dhe realizuar në vitin 2022, rezulton si më poshtë vijon:*

**D1.** *“Blerje artikuj kancelarie:* Kërkesa nr. 522 prot., datë 13.05.2022 për 25 artikuj kancelarie; Proçes Verbali i llogaritjes së Fondit limit nr. 540/1 prot., datë 23.05.2022 për artikujt objekt prokurimi; Urdhër Prokurimi nr. 01 dhe nr. 540 prot., datë 23.05.2022; Ftesë për ofertë nr. prot., 540/2 datë 23.05.2022; Proçes Verbali i marrjes në dorëzim datë 22.06.2022 ku mungon firma e një prej anëtarëve të komisionit (I.Q.); Fletë hyrje nr. 9 datë 22.06.2022 (kopje); praktika dokumentare nga sistemi SPE; *Dokumentet e dorëzuar nga OE fitues* me nr. 540/3 prot., datë 09.06.2022; Vërtetim i DRT Durrës nr. T06158747 datë 18.05.2022, Vërtetim i DTTV Bashkia Durrës nr. 4449 prot., datë 18.05.2022; Vërtetim i OSHEE nr. 9998726-DM datë 23.05.2022; Vërtetim i DRT Durrës “për pagesën e sigurimeve shoqërore” nr. T06158717 datë 18.05.2022; Formulari i ofertës nga OE; Çertifikata elektronike nr. M21307517P datë 11.01.2022; Ftesë për ofertë dt. 09.06.2022; Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit datë 09.06.2022; Deklarata mbi konfliktin e interesit datë 09.06.2022; Çertifikatë e Regjistrimit Tatimor nr. serial SN 791086-01-22; Ekstrakt QKB datë 04.04.2022; konfirmim i llogarisë së Bankës (Credins Bank); konfirmim i regjistrimit në portalin e-albania; Akt Marrëveshje e lidhur për përdorimin e aplikacionit për fiskalizimin datë 10.01.2022 me faturën e shërbimit nr.650/2022.

**D2.** *Blerje Pajisje Kompjuterike:* Urdhër Prokurimi nr. 30 dhe nr. 1116 prot., datë 31.10.2022; Ftesë për ofertë nr. 1117 prot., datë 31.10.2022; praktika dokumentare nga sistemi SPE për dhjetë OE të kualifikuar: shpallja e prokurimit, lista e OE pjesëmarrës, lista e OE të kualifikuar, lista sipas klasifikimit përfundimtar, njoftimi i fituesit, konfirmimi ose tërheqja nga procedura (sipas rastit), proçes verbali i kalimit të OE i radhës; dokumentacioni i OE pjesëmarrës (3 OE), por të tërhequr nga gara; *Dokumentet e dorëzuar nga OE fitues* me nr. 1117/4 prot., datë 23.11.2022; Çertifikatë e Regjistrimit Tatimor nr. serial SN 590335-05-19; Ekstrakt QKB datë 05.11.2022; Vërtetim elektronik i DRT Fier “për pagesën e sigurimeve shoqërore” nr. T07178214 datë 05.11.2022; Vërtetim i DRT Fier nr. T07178248 datë 05.11.2022; Çertifikata elektronike ; Kontratë Shërbimi për përdorimin e aplikacionit për fiskalizimin datë 03.03.2022; Vërtetim i OSHEE nr. 4897 prot., datë 18.11.2022; Vërtetim i DTTV Bashkia Patos datë 14.11.2022; ftesë për ofertë; formulari i ofertës & katalogu; deklarata e konfliktit të interesit; deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit; deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike.

Nga auditimi i dosjeve dhe analiza e informacionit të pasqyruar në tabelën përmbledhëse u *konstatua se* në 2 dosjet e procedurave të prokuruar kishte mangësi të dokumentacionit si dhe në *“blerje print/copy/skan”* mungonte nënshkrimi i punonjësës së magazinë dhe nënshkrimi i një anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim (I.Q.), në kundërshtim me VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- *Dokumentacioni i praktikave për BVV deri në vlerën 100,000 lekë.*

Nga auditimi i dokumentacionit në procedurat BVV deri në vlerën e fondit 100,000 lekë u *konstatua se:* dokumentacioni nuk ishte i organizuar në dosje ku dhe të mundësohej inventarizimi i tyre; kërkesa e paraqitur te Sekretari i përgjithshëm për blerjen e mallrave që i nevojiten njësisë nuk ishte i shoqëruar me dokumentacionin e cilësuar në përmbajtjen e saj, konkretisht: mungonte testimi i tregut, procesverbali përmbledhës dhe Vendimi ku përcaktohet

fondi limit i mallrave; deklarata e konfliktit të interesit të anëtarëve të komisionit BVV; Urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim nuk ishte pjesë e praktikës; dokumentacioni i OE ku ishte realizuar blerja e mallit apo shërbimit; gjithashtu në rastet si:  
 - "blerje brave", mungon kërkesa si dhe nuk është përfshirë shpenzimi për montimin e saj;  
 - "blerje goma", me nr. 89/2022 kërkesa e pa regjistruar në regjistrin e protokollit të institucionit;  
 - "blerje siguracion mjete", kërkesa e pa regjistruar në regjistrin e protokollit të institucionit;  
 - "blerje lule natyrale" pa testimin e tregut;  
 - "shërbim larje makinave të institucionit", pa rinovuar kontrata për periudhën 01.01.2022-31.12.2022;  
 - nr. protokollit në një rast mungonte nënshkrimi i punonjësit të magazinës, nënshkrimi i një anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim të mallit; mungesa e regjistrimit të procesverbaleve në regjistrin e protokollit të institucionit, në kundërshtim me Bnormat Teknike Profesionale dhe metodologjike të Shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë dhe Vendim nr. 4, datë 19.6.2017 "Për Miratimin e "Rregullores së Njësuar të Punës me dokumentet në Autoritetet Publike të Republikës së Shqipërisë".

Personat përgjegjës të procedurës: **P.F**, me detyrë Specialisti Sektori Juridik, në cilësinë e KBVV; **S.Ç**, me detyrë P/Sektorit të Financës, në cilësinë e anëtarit të KBVV; **L.GJ**, Specialisti MKV & FG, në cilësinë e anëtarit të KBVV.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 852/2 prot, datë 30.8.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit" nga M.I, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

*Procedurat e prokurimit deri në 100 mijë lekë janë konforme ligjit, nuk janë në dosje të vecantë por janë si dokumenta vertetuese të qepura me banken.*

*Urdhëri i titullarit ju është vënë në dispozicion nga arkiva nuk e kemi qepur bashkë me dokumentat e tjera deri në momentin që nuk ka një urdher tjetër për ndryshim komisioni, anëtarët e komisionit hartojnë procesverbalin dhe e firmosin atë rregullisht.*

*Per shembull kancelari, materiale pastrimi, furnizime dhe materiale të tjera të përgjithshme janë në një grup me zera të ndryshme sipas klasifikimit buxhetor dhe nuk mund të prokurohen bashkë sepse nuk kanë të njëjten natyrë por edhe nëse kanë janë paraqitur kërkesat në kohë të ndryshme, për shembull materiale për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës. (dokumentat bashkëngjitur)*

*Nëse nga prokurimi i një grupi kemi kursim nga tenderi këto pjesë të mbetur nuk mund të lemë pa e realizuar, referuar ligjit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "Per menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë".*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Për sa pretendoni mbi gjetjet e KLSH-së, sqarojmë se nuk qëndrojnë, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur, në lidhje me urdhëri i titullarit nga KLSH është theksuar se mungon urdhëri për komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave. Po kështu dhe çpëzimi janë për artikujt të cilat janë trajtuar në material ku është bërë dhe shpjegimi përkatës se cilët mallra është bërë çpëzimi. Pretendimi nuk qëndron.

➤ **Për aktivitetin e vitit 2013.**

Grupi sipas materialitetit vlerësoj për auditim 3 procedura me fond limit 670,180 lekë ose 49.5% e fondit të prokuruar.

**1- Të dhëna mbi objektin e prokurimit:**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje kancelari"</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> "blerje me vlerë të vogël"; REF-71618-06-06-2023; Urdhri nr. 20 datë 29.5.2023	<b>1.1 Specialistët e hartimit të kriterëve kualifikuese (Ftesës për Ofertë), Njësia e Prokurimit</b> 1- L.S 2- S.Ç 3- P.F	<b>2 Komisioni i Përcaktimit të Fondit Limit</b> 1- L.S 2- S.Ç 3- P.F	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> 1. G.M 2. E.Ç 3. K.B



<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 150,000 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 97,000 lekë Fitues: L.	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 53,000 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 8.6.2023	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Prefekturës.	<b>9. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 12 B/OE b) S'kualifikuar 6 B/OE, për ofertë mbi FL. c) Janë kualifikuar 6 OE/BOE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 30 ditë</b>		

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

**a- Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:**

Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se nuk ka kërkesë paraprake nga sektorët e Prefekturës që Qarkut Fier, mbi nevojën e blerjes së mallrave. Nuk është bërë verifikimi mbi gjendjen e materialeve në fund të vitit 2022, sa është nevoja për vitin 2023 dhe sa duhen sipas kërkesës së sektorëve për vitin 2023.

Komisioni për përcaktimin e fondit limit “për blerje kancelari”, ka hartuar procesverbalin nr. 568/1, datë 29.5.2023, me të cilin ka përcaktuar fondin limit, bazuar në çmimet referues të vitit 2022 të unifikuara dhe çmimet e blerjeve të vitit 2022, duke bërë dhe testimin e tregut. Referuar të dhënave të procesverbalin dhe dosjes së procedurës, konstatohet se nuk ka një analizë se ku faktikisht është mbështetur komisioni në llogaritjen e këtij fondi, pasi bashkëlidhur nuk ka as oferta të OE dhe as numër kontrate të ngjashme nga vitet e kaluara, veprime në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenin 12, 13 dhe 76, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**b- AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:**

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit “për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi” dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, nga njësia e prokurimit, në lidhje me këtë procedurë, përgjithësisht kriteret e pjesëmarrjes (kërkesat e veçanta të kualifikimit) janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, nuk është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit.

Grupi i auditimit konkludon se, në dosjen e prokurimit nuk janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisionit mbi konfliktin e interesave, mosveprim i cili bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 13, pika 5, Neni 73, pika 4; Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; Normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

**c- Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.**

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 12 B/OE, për të cilët, KPBBV ka kryer vlerësimin paraprak (pa komunikim në SPE me OE) dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	Shoqëria OE/BOE	Oferta pa TVSH	Kualifikuar / Skualifikuar
1	L.	97,000	Kualifikuar
2	E.	102,000	Kualifikuar
3	M.	109,800	Kualifikuar
4	I.	117,000	Kualifikuar
5	H.12	120,000	Kualifikuar
6	A.	125,000	Kualifikuar

Nr.	Shoqëria OE/BOE	Oferta pa TVSH	Kualifikuar / Skualifikuar
7	S. 2022	133,333	Skualifikuar/ oferta mbi fondin limit
8	J.	141,667	Skualifikuar/ oferta mbi fondin limit
9	E.	200,000	Skualifikuar/ oferta mbi fondin limit
10	IT.	200,000	Skualifikuar/ oferta mbi fondin limit
11	O.	276,000	Skualifikuar/ oferta mbi fondin limit
12	S.	400,000	Skualifikuar/ oferta mbi fondin limit

Nga sistemi elektronik i prokurimit (SPE) rezulton se janë skualifikuar **6 OE** pasi kanë paraqitur oferta me vlerë mbi fondin limit.

Sipas të dhënave të sistemit, nga KPBBV nuk është hartuar dhe mbajtur procesverbal mbi vlerësimin e procedurës, duke vlerësuar si fitues shoqërinë “L.” me ofertë 97,000 lekë pa TVSh, më të leverdishme se OE e tjerë të kualifikuar.

Nga auditimi rezulton se OE i shpallur fitues është në kushtet e zbatimit të dispozitave ligjore të Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi plotëson kriteret e vendosura nga AK Prefektura Fier.

Me urdhër të titullarit nr. 10 prot., datë 11.01.2023 (prot nr. 30) është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim, të cilët me procesverbalin e datës 29.6.2023, nr. Ekstra, kanë marrë në dorëzim mallrat. Me urdhër shpenzimit nr. 174, datë 2.8.2023 nga Prefektura Qarkut Fier është likuiduar fatura e shërbimit datë 29.6.2023 për vlerën 116,400 lekë me TVSh.

*Nga auditimi nuk u konstatuan parregulësi në marrjen dhe likuidimin e mallrave.*

## **2- Të dhëna mbi objektin e prokurimit:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim”</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “blerje me vlerë të vogël”; REF-81070-09-25-2023; Urdhri nr. 27 datë 20.9.2023	<b>1.1 Specialistët e hartimit të kriterëve kualifikuese(Ftesës për Ofertë),Njësia e Prokurimit</b> 1- L.S 2- S.Ç 3- P.F	<b>2 Komisioni i Përcaktimit të Fondit Limit</b> 1- L.S 2- S.Ç 3- P.F	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> 1. G.M 2. E.Ç 3. K.B
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 162,500 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 83,000 lekë Fitues: N.V		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 79,500 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 10.10.2023	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Prefekturës.		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër 23 B/OE b) S’kualifikuar 24 B/OE, për ofertë mbi FL. c) Janë kualifikuar 6 OE/BOE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 1 ditë</b>			

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

### **a- Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:**

Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se nuk ka kërkesë paraprake nga sektorët e Prefekturës që Qarkut Fier, mbi nevojën e blerjes së mallrave. Nuk është bërë verifikimi mbi gjendjen e materialeve në fund të vitit 2022, sa është nevoja për vitin 2023 dhe sa dihen sipas kërkesës së sektorëve për vitin 2023.

Komisioni për përcaktimin e fondit limit “Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim”, ka hartuar procesverbalin nr. 991, datë 20.9.2023, bazuar në çmimet referues të vitit 2022 të unifikuara dhe çmimet e blerjeve të vitit 2022, duke bërë dhe testimin e tregut. Referuar të dhënave të procesverbalin dhe dosjes së procedurës, konstatohet se nuk ka një analizë se ku faktikisht është mbështetur komisioni në llogaritjen e këtij fondi, pasi bashkëlidhur nuk ka as oferta të OE dhe as numër kontrate të ngjashme nga vitet e kaluara, veprime në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenin 12, 13 dhe

76, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

***b- AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriereve”:***

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit “për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriereve për kualifikimi” dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, nga njësia e prokurimit, në lidhje me këtë procedurë, përgjithësisht kriteret e pjesëmarrjes (*kërkesat e veçanta të kualifikimit*) janë përcaktuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Dosja fizike e prokurimit, nuk është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit.

Grupi i auditimit konkludon se, në dosjen e prokurimit nuk janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisionit mbi konfliktin e interesave, mosveprim i cili bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 13, pika 5, neni 73, pika 4, si dhe Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; Normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

***c- Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.***

Në këtë procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë **23 B/OE**, për të cilët, KVO-ja ka kryer vlerësimin paraprak (pa komunikim në SPE me OE).

Nga **23 OE** pjesëmarrës, pas vlerësimit janë kualifikuar **6 OE** dhe skualifikuar **17** janë skualifikuar sipas të dhënave të tabelë.

Në përfundim nga OE e mbetur në garë, KPBBV ka vlerësuar si fitues shoqërinë “N.V” me ofertë **83,000 lekë pa TVSh**. *Procedura mbyllur datë 25.10.2023 (sipas sistemit)*

Nga verifikimi i dokumentacionit të OE fitues, konstatohet se nuk plotëson të gjitha kriteret sipas ftesës së ofertës, konkretisht:

- *Vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike nr. 5561/1 prot, datë 01.8.2023, ku thuhet se është deri në fund të muaj Qershor 2023. Sipas ftesës procedura është hapur data 10.10.2023, pra nga subjekti duhej paraqit vërteti për pagesën deri në fund të muajt Gusht 2023;*
- *Nuk paraqet vërtetim bankar (IBAN);*
- *I gjithë dokumentacioni është I fotokopjuar **por jo noterizuar** (pika 11 e ftesës).*

Në kushtet e mosplotësisht të këtij kriteri, OE i shpallur fitues duhet të ishte skualifikuar dhe KPBBV të vijonte procedurat me operatorin e radhës, *duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KPBBV: L.S, me detyrë specialiste prokurimesh (kryetare); B.XH me detyrë Specialiste e Emergjencave Civile dhe D.S me detyrë Specialist në Sektorin Juridik.*

Mosveprimet e konstatuara më sipër, bien në kundërshtim me Ligji nr. 160, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 92, pika 3, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82, pika 2, si dhe Udhëzimi i APP-së nr. 5, datë 25.06.2021 pika 17.

Me urdhër të titullarit nr. 10 prot., datë 11.01.2023 (prot nr. 30) është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim, të cilët me procesverbalin e datës 26.10.2023, nr. Ekstra, kanë marrë në dorëzim mallrat. Me urdhër shpenzimit nr. 251, datë 9.11.2023 nga Prefektura Qarkut Fier është likuiduar fatura e shërbimit datë 26.10.2023 nr. 37/2023 për vlerën 99,600 lekë me TVSh.

*Nga auditimi nuk u konstatuan parregullsi në marrjen dhe likuidimin e mallrave.*

### 3- Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<i>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje pajisje zyre, kompjuterike”</i>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> <i>“blerje me vlerë të vogël”</i> ; REF-88235-11-20-2023; Urdhri nr. 31 datë 16.11.2023	<b>1.1 Specialistët e hartimit të kriterëve kualifikuese(Ftesës për Ofertë),Njësia e Prokurimit</b> 1- L.S 2- S.Ç 3- P.F	<b>2 Komisioni i Përcaktimit të Fondit Limit</b> 1- L.S 2- S.Ç 3- P.F	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> 1. G.M 2. E.Ç 3. K.B
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 382,680 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 349,000 lekë Fitues: P.	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 33,680 lekë	
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 22.11.2023	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Prefekturës.	<b>9. Operoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër 25 B/OE b) S’kualifikuar 10 OE/BOE, për ofertë mbi FL. c) Janë kualifikuar 15 OE/BOE	
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 1 ditë</b>			

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

#### **a- Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:**

Nga të dhënat e dosjes, konstatohet se nuk ka kërkesë paraprake nga sektorët e Prefekturës që Qarkut Fier, mbi nevojën e blerjes së mallrave. Nuk është bërë verifikimi mbi gjendjen e materialeve në fund të vitit 2022, sa është nevoja për vitin 2023 dhe sa dihen sipas kërkesës së sektorëve për vitin 2023.

Komisioni për përcaktimin e fondit limit “Blerje pajisje zyre, kompjuterike”, ka hartuar procesverbalin nr. 1175/2, datë 16.11.2023, bazuar në çmimet referues të vitit 2022 të unifikuara dhe çmimet e blerjeve të vitit 2022, duke bërë dhe testimin e tregut. Referuar të dhënave të procesverbalin dhe dosjes së procedurës, konstatohet se nuk ka një analizë se ku faktikisht është mbështetur komisioni në llogaritjen e këtij fondi, pasi bashkëlidhur nuk ka as oferta të OE dhe as numër kontrate të ngjashme nga vitet e kaluara, veprime në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenin 12, 13 dhe 76, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

#### **b- AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriterëve”:**

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, u konstatua se nga njësia e prokurimit, në lidhje me këtë procedurë, përgjithësisht kriteret e pjesëmarrjes (*kërkesat e veçanta të kualifikimit*) janë përcaktuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Referuar procedurës së sipërcituar, rezulton se dosja fizike e prokurimit, **nuk** është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit. Grupi i auditimit konkludon se, në dosjen e prokurimit nuk janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisionit mbi konfliktin e interesave, mosveprim i cili bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 13, pika 5, neni 73, pika 4, si dhe Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; Normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

**c- Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimin të ofertave nga KVO.**

Në këtë procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 25 B/OE, për të cilët, KVO-ja ka kryer vlerësimin paraprak (pa komunikim në SPE me OE).

Nga **25 OE** pjesëmarrës, pas vlerësimit janë kualifikuar 4 OE pasi oferta e paraqitur është më e madhe se fondi limit i prokuruar, 5 OE janë skualifikuar me pretendimin se ose janë tërhequr vetë ose mungesë dokumentacioni (sipas të dhënave në tabelë), për 1 OE nuk ka argument nëse skualifikohet ose jo dhe 15 OE janë kualifikuar.

Nga 15 OE të kualifikuar shoqëria ka shpallur fitues shoqërinë “P.” me ofertë 349,000 lekë, më të leverdishme se OE e tjerë në garë.

Me urdhër të titullarit nr. 10 prot., datë 11.01.2023 (prot nr. 30) është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim, të cilët me procesverbalin e datës 18.12.2023, nr. Ekstra, kanë marrë në dorëzim mallrat. Me urdhër shpenzimit nr. 280, datë 20.12.2023 nga Prefektura Qarkut Fier është likuiduar fatura e shërbimit datë 18.12.2023 nr. 10445/2023 për vlerën 418,800 lekë me TVSh.

*Nga auditimi nuk u konstatuan parregulësi në marrjen dhe likuidimin e mallrave*

*Personat përgjegjës të procedurës: L.S, me detyrë Specialiste në Sek/Financës, në cilësinë e Kryetarit të KBVV; B.XH me detyrë Specialiste Sektori Emerngjencave Civile, në cilësinë e anëtarit të KBVV; D.S me detyrë Specialist Sektori Juridik, në cilësinë e anëtarit të KBVV.*

- **Mbi auditimin e procedurës me vlerë të lartë me objekt “Rikonstruksion i godinës së Qarkut Fier”, nga ku rezultojë se:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion i godinës së Qarkut Fier.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 18 datë 14.4.2023	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> nr. 18 datë 14.4.2023 P.F R.B E.S B.GJ K.Y	<b>4. Komisioni VO</b> nr. 19, dt. 14.4.2023 L.S B.XH D.S
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur”,		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 1,498,824 lekë.	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “H.” ShPK me vlerën e ofertës 1,117,320 lekë pa TVSh.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 74.5 %.
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 11.7.2023 REF -73612-06-26-2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Ministria e Brendshme.	<b>10. Operatorë Ekonomike 8:</b> a- Skualifikuar 1 OE b- Kualifikuar 7 OE
<b>11. Ankimim</b> JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	<b>13. Përgjigje KPP</b>
<b>b. Kontrata</b>		
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Nr. 654/20, datë 21.8.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> <b>1,117,320</b> lekë me afat 25 ditë.	

**- Hartimi i projektit:**

Projekt preventivi është hartuar nga studio private “K.” me drejtues ing. E. B., kjo në zbatim të kërkesës së Prefektit të Qarkut Fier nr. 509/6 prot, datë 2.6.2023.

Sipas verifikimeve rezulton se projekt preventivi është hartuar sipas manualit të çmimeve të VKM nr. 629, datë 15.7.2015.

Nga auditimi rezulton se nga Prefektura Qarkut Fier nuk është kryer oponentca teknike, vjen në kundërshtim me kundërshtim me nenin 6 të ligjit me nr. 120/2020 *Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.*

**- Vlerësimi i kritereve:**

Me PV nr. 654/1 prot, datë 23.6.2023 nga NJP janë hartuar kriteret dhe specifikimet teknike. Me shkresën nr. 654/4 prot, datë 3.7.2023, Prefekti i Qarkut Fier ka bërë pezullimin e procedurës deri në shqyrtimin e sugjerimeve të ardhur nga APP, në format elektronik mbi disa

kritere, konkretisht: Kategori NP-2A, marangozi. Pas rishikimi të kriterëve me shtojcën (modifikim kriteresh), nga NJP janë bërë këto ndryshime:

Është hequr kategoria e licencës NP-2A dhe marangozi nga kriteret e fillimit. Procedura e hapjes nga data 10.7.2023 bëhet 11.7.2023. Me urdhër nr. 654/7 prot, datë 3.7.2023 është bërë pezullimi i procedurës.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV datë 11.7.2023 nga KVO është bërë hapja e ofertave të paraqitura, ku evidentohet se ka marrë pjesë 8OE. Me PV nr.3, datë 17.7.2023 është bërë hapja dhe vlerësimi i procedurës. Sipas këtij PV në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 8 OE ekonomike, si më poshtë vijon:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vl. Ofertuesit	Skualifikuar/ kualifikuar
1.	D.	1,195,260	Kualifikuar
2.	A.	1,145,700	Kualifikuar
3.	A.	1,171,260	<b>Skualifikuar:</b> <i>Preventivi i paraqitur ka gabime aritmetike më shumë se 2%</i>
4.	H.	1,117,320	Kualifikuar
5.	J.	1,331,141	Kualifikuar
6.	M.	1,352,853	Kualifikuar
7.	M.	1,445,100	Kualifikuar
8	N.	1,133,300	kualifikuar

Pas vlerësimit të dokumentacionit, KVO nga **8 OE** pjesëmarrës ka skualifikuar **1 OE** dhe kualifikuar **7 OE**. Nga OE e mbetur në garë KVO ka shpallur fitues shoqërinë "H.", me ofertë më të leverdishme se OE e tjerë në garë, për vlerën 1,117,320 lekë pa TVSh.

Me PV nr. 4, datë 24.7.2023 (prot 654/1), nga KVO është bërë marrja në dorëzim dhe hapja e dokumenteve të OE fitues. Me shkresën nr. 654/4, datë 24.7.2023 është plotësuar formulari i njoftimit paraprak të fituesit. Me shkresën nr. 654/17 prot, datë 2.8.2023 është plotësuar formulari i njoftimit përfundimtar.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE të skualifikuar/ dhe kualifikuar në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, konstatohet se vlerësimi i bërë nga KVO është i saktë dhe në përputhje me dispozitat e LPP.

- **Zbatimi i kontratës:**

Referuar të dhënave të financës, kontrata është likuajduar sipas USH nr. 250, datë 9.11.2023 për shumën 1,340,784 lekë (*minus garanci 5% në vlerën 67,039 lekë*), kjo referuar faturës shoqëruar me situacion nr. 22/2023, datë 19.10.2023 për të njëjtën vlerë dhe certifikatë përdorimi nr. *Ekstra*, datë 5.10.2023 ngritur me urdhrin nr. 10, datë 11.01.2023 (prot 30), i përbërë nga I.L, E.S dhe A.GJ.

Kontrata është zbatuar sipas afateve të përcaktuara 25 ditë nga data e fillimit të punimeve, pra nga data 11.9.2023 mbyllur datë 5.10.2023.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 852/2 prot, datë 30.8.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit" nga M.I, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me konstatimi se nga ana jonë mungojnë ftesat për ofertë, mos evidentimin e përlogaritjes së fondit limit dhe mos inventarizimin e dosjeve, sqarojë se:*

- *Në të gjitha rastet e procedurave të prokurimit me mjete elektronike për blerjet e vogla është dërguar ftesa për oferte të gjithë operatorëve ekonomike, pa të cilën nuk mund të bëhet i mundur zhvillimi i procedurës me mjete elektronike (bashkëngjitur dokumentacioni vërtetues).*

- *Të gjitha procedurat e prokurimit për blerjet e vogla kanë llogaritjen e fondit limit dhe menyren e llogaritjes, (bashkëngjitur procesverbalet).*

- *Te gjitha procedurat e prokurimit kanë flete inventari per dosjet perkatese (bashkëngjitur fletet e inventarit).*

**Qëndrim i grupit të auditimit.**

Për sa pretendomi në lidhje me magësitë e konstatuara, sqarojmë se merret në konsideratë vetëm fakti i ftesës për ofertë (shoqëruar me dokumentacion), ku gjatë fazës së audsimtit ky dokumentacio nuk ndodhet në dosje. Ndersa në lidhje me konstatimet për llogaritjen e fondit limit dhe inventarizimin, pretendimet nuk qëndrojnë, pasi në PV janë përshkruar të tre metodat që parashikon ligji, duke mos specifikuar metodës së adresuar. Po kështu dhe inventarizimi dhe arkivimi nuk është bërë.

### **2.3 Auditim mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, rezulton se në lidhje me natyrën e akteve të përcjella për shqyrtim prej vitit 2020 në Prefekturën e Qarkut Fier nuk përcillet çdo akt i miratuar nga Këshillat Bashkiakë, kjo në zbatim të nenit 13, pika 2 të Ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”.

Për këtë çështje, me shkresën nr. 386 datë 24.04.2023, Prefekti u ka dërguar bashkive të Qarkut Fier një analizë juridike për të saktësuar dallimin që këshillat bashkiakë duhet të bëjnë mes akteve normative dhe jo normative, marrë shkasë nga praktika e ndjekur nga bashkitë për dërgimin te Prefekti të çdo vendimi me karakter individual apo kolektiv.

#### **➤ Viti 2022**

Për vitin 2022, rezultojnë **107** akte të regjistruara dhe të trajtuara nga Prefekti i Qarkut Fier, nga të cilat **101** të bazuara në ligj dhe **5** janë konsideruar të pa pabazuara në ligj, ku për **1 (një)** akt normativ është ngritur padi administrative (Bashkia Roskovec), ndërsa për **87** akte është bërë verifikim i ligjshmërisë në vend.

**Tabela 1.** Të dhënat mbi vendimet e përcjella nga bashkisë dhe Këshilli i Qarkut Fier dhe trajtuara nga Prefekti, për vitin 2021.

Nr.	Verifikimi i ligjshmërisë së akteve normative të organeve të qeverisjes vendore									Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve		Dërguar në gjykatë		Vendime të pa konfirmuara, në proces për kërkim informacioni	
	Njësite e qeverisjes vendore	Akte të hyra tek Prefekti		Të bazuara në ligj		Të pa bazuara në ligj		Të rishqyrtuara nga OQV							
		Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog
1	Këshilli i Qarkut Fier	3	9	3	9	0	0	0	0	1	6	0	0	0	0
2	Bashkia Fier	4	18	4	18	0	0	0	0	4	15	0	0	0	0
3	Bashkia Patos	2	13	2	12	0	1	0	0	3	12	0	0	0	0
4	Bashkia Roskovec	4	23	4	19	0	3	0	0	4	19	0	1	0	0
5	Bashkia Mallakastër	1	12	1	12	0	0	0	0	3	10	0	0	0	0
6	Bashkia Lushnje	5	19	4	18	1	1	0	0	4	15	0	0	0	0
7	Bashkia Divjakë	4	13	4	13	0	0	0	0	4	10	0	0	0	0
<b>TOTALI</b>		<b>23</b>	<b>107</b>	<b>22</b>	<b>101</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>23</b>	<b>87</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

**Burimi:** Nga të dhënat e Prefekturës dhe përpunuar nga grupi i KLSH

Numri më i lartë i akteve normative të regjistruara te Prefekti i Qarkut Fier i përket Bashkisë Roskovec me **23 akte**, e ndjekur nga Bashkia Lushnjë me **19 akte**, Bashkia Fier me **18 akte**, Bashkia Divjakë dhe Bashkia Patos me **13 akte** përkatësisht, Bashkia Mallakastër me **12 akte** dhe Këshilli i Qarkut Fier me **9 akte**.

Në lidhje me natyrën e akteve të dorëzuara, sipas nenit 16 të Ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, vendimet me karakter normativ të këshillave bashkiak kanë kryesisht për objekt:

- Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok ndihmën për vitin 2022;
- Për miratimin e një shtese në buxhetin e vitit 2022 nga të ardhurat e trashëguara;

- Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025;
- Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të buxhetit;
- Paketa fiskale për sistemin e taksave e tarifave vendore, dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative;

Aktet me intervale më të pakta, që kanë një objekt ndryshe nga aktiviteti tradicional buxhetor apo financiar, janë:

- Për përcaktimin e procedurës për negociimin me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me Bashkinë e Fierit nëpërmjet marrëveshjes për pronat kufitare të cilat bashkohen për qëllime zhvillimi
- Për shpërndarjen dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile për vitin 2022
- Mbi miratimin e planit vendor për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje të romëve dhe egjiptianëve 2022-2025
- Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Roskovec.

## ➤ VENDIME TË MIRATUARA

### a- Bashkia Divjakë

Me kthim përgjigjen nr. 798/1 datë 04.08.2022 për verifikimin e ligjshmërisë së Vendimit të Këshillit të Bashkisë Divjakë nr. 30 datë 25.07.2022 “Për miratimin e akordimit të fondit të kushtëzuar për vitin 2022, në shumën 8,821,291 lekë (në masën 100 % të fondit) për familjet e banesave të cilat janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera”, Prefekti i Qarkut Fier ka konkluduar se VKB është në përputhje me ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/n, neni 54; ligji nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe me VKM nr.414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shteti për mbrojtjen civile”. VKB përkatëse është regjistruar në datë 25.07.2022 në protokollin e institucionit të Prefektit.

Në materialin e dorëzuar nga Bashkia Divjakë janë përfshirë projekt-vendimi, relacioni, fotokopje e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak, por ka mungesë të dokumentacionit bazë për çështjet si vijon:

- Çfarë emergjence civile apo fatkeqësi natyrore apo fatkeqësi të tjera ka ndodhur në Bashkinë Divjakë?

- Mungon akti i vlerësimit të dëmeve nga Bashkia Divjakë me qëllim dëmshpërblimin e qytetarëve për fatkeqësitë e ndodhura. Konkretisht, mbi çfarë aktesh ekspertize apo procesverbali të konstatimit të dëmit janë evidentuar banesat e dëmtuara dhe ka lidhje shkak-pasojë ky dëmtim me fatkeqësinë e ndodhur, apo kanë ardhur për shkaqe janë sferës së mbulimit nga mbrojtja civile?

- Sa është numri i familjeve dhe banesave të dëmtuara nga kjo fatkeqësi?

### **Baza ligjore.**

Kriteret e përdorimit të fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile parashikohen në VKM nr.414/2021, pika 3-3.1, germa (a) ku përcaktohet se:

“Fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të përdoret sipas prioritizimit, 60 (gjashtëdhjetë) %–100 (njëqind) % e fondit të dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret për akordimin e ndihmës financiare për familjet, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera, sipas kriterëve specifikë të përcaktuara në aktet nënligjore që rregullojnë ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, neni 41”.

Sa më sipër, kushti për përdorimin e fondit për qëllimin e akordimit të ndihmës financiare është i lidhur me ndodhinë e fatkeqësisë, për të cilën nuk rezulton të jetë administruar në Prefekturë asnjë informacion mbi fatkeqësinë e ndodhur në Bashkinë Divjakë.

**Si konkluzion.** Prefekti i Qarkut Fier duhet ta kishte kthyer VKB nr. 30 datë 25.07.2022 “Për miratimin e akordimit të fondit të kushtëzuar për vitin 2022, në shumën 8,821,291 lekë për



familjet e banesave të cilat janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera”, si në kundërshtim me kuadrin rregullator.

Praktika është punuar nga **K.Y**, përgjegjës i sektorit të emergjencave, specialistja e sektorit juridik **D.S**, konfirmuar nga **A.V**, Sekretar i Përgjithshëm, firmosur nga Prefekti **L.SH**.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 565/9, datë 30.8.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

*Me gjetjen jemi dakort por mendojmë se rekomandimi i mësipërm që të jetë i zbatueshëm ka nevojë për ndryshim, në mënyrë të jetë i zbatueshëm dhe që Prefekti dhe Bashkitë të jenë në pozita ligjore sugjerojmë që rekomandimi juaj të theksojë që relacioni të jetë më gjithëpërfshirës dhe shterues.*

**Qëndrim i grupit të auditimit:**

Sugjerimet tuaja lidhur me rekomandimin do të merren në konsideratë.

**b- Bashkia Fier**

Me kthim përgjigjen nr. 872/1 datë 19.08.2022, Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar ligjshmërinë e Vendimit nr. 71 datë 08.08.2022 të Këshillit të Bashkisë Fier “Për shpërndarjen dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile për vitin 2022”, regjistruar në protokollin e Prefektit datë 12.08.2022, duke e konstatuar si në përputhje me kuadrin rregullator.

Në VKB nr. 71 datë 08.08.2022, Këshilli Bashkiak Fier ka miratuar përdorimin në masën 100% të fondit të kushtëzuar në vlerën 29,209,640 lekë, e ndarë si vijon:

Nr.	Artikulli	Emërtimi	Shuma në lekë
1	231	Mbrojtje e digës së rezervuarit Libofshë	11,523,722
2	231	Mjet Tip Auto Autovinç me kosh deri në lartësi 30m	6,000,000
3	602	Uniforma dhe pajisje MZSH	11,685,919
	<b>Shuma</b>		<b>29,209,640</b>

**- Baza ligjore**

Kriteret e përdorimit të fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile janë të përcaktuara në VKM nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shteti për mbrojtjen civile”.

Në referencë të dispozitave ligjore dhe nënligjore rezulton si mëposhtë:

**Për investimin “Mbrojtje e digës së rezervuarit Libofshë”** në vlerë **11,523,722 lekë** konstatohet se është në përputhje me pikën 3.1, germa (e) “mbajtjen në gatishmëri të infrastrukturës së ujëtjes, të kullimit, të mbrojtjes nga përmbytja dhe digat e rezervuarëve në administrim të tyre”;

**Për shpenzimet operative “Uniforma dhe pajisje për MSZSH”** në vlerë **11,685,919 lekë** konstatohet se është në përputhje me pikën 3.1, germa (g) “blerje materialesh të ndryshme, që i shërbejnë veprimtarisë së strukturave të emergjencës”;

**Për investimin “Blerje mjet tip autovinç me kosh deri në lartësi 30 m”,** me vlerë **6,000,000 lekë** konstatohet se është jashtë objektivit të VKM nr. 414/2021, për kohën e vendimmarrjes.

Nisur nga të dhënat e praktikës, konstatohet se ky parashikim është bërë në muajin Maj të vitit 2023, me VKM nr. 290, datë 17.5.2023 “Për një ndryshim në vendimin nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, shkronja “ë”, e pikës 3.1.

**Si konkluzion.** Prefekti i Qarkut Fier duhet ta kishte kthyer Vendimin nr.71 datë 08.08.2022 të Këshillit të Bashkisë Fier “Për shpërndarjen dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile për vitin 2022”, si në kundërshtim me kuadrin rregullator, vetëm për pikën **2 të investimit për blerje autovinçi.**

Praktika është punuar nga **D.S**, specialiste, **A.G.J**, përgjegjëse e sektorit juridik, **K.Y**, përgjegjës i sektorit të emergjencave, konfirmuar nga Sekretari i Përgjithshëm **A.V** dhe firmosur nga Prefekti **L.SH**.

**Me kthim përgjigjen nr.621/1 prot., datë 21.06.2022**, Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar ligjshmërinë e Vendimit nr. 54 datë 08.06.2022 të Këshillit të Bashkisë Fier “*Për përcaktimin e procedurës për negociim me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me Bashkinë e Fierit nëpërmjet marrëveshjes për pronat në pronësi të saj*”. VKB përkatëse është regjistruar në protokollin e Prefektit të Qarkut datë 14.06.2022 dhe shoqërohet me dokumentacionin si: relacioni, projekt-vendimi, vendimi dhe procesverbali i dëgjësës publike. Prefekti i Qarkut Fier është shprehur se akti përkatës është në përputhje me Ligjin nr.139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1b, neni 23 pika 14 si dhe me Ligjin nr.107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*” (i ndryshuar).

**- Baza ligjore**

Në VKB përkatëse të përcjellë nga Bashkia Fier dhe në verifikimin e ligjshmërisë së kryer nga Prefekti i Qarkut Fier, baza ligjore ka mangësi. Konkretisht, si nga ana e Bashkisë ashtu edhe nga ana e Prefektit, është përmendur nenin 9 i Ligjit nr. 139/2015 për të drejtat dhe përgjegjësitë e NjQV, ku përmendet nënpika 1.1 shkronja (b).

Më tej përmendet nënpika 1.2 shkronja (c) se e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t’ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër” dhe pika (e.1), shtuar me Ligjin nr. 38/2019 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”* e cila përcakton se Këshilli Bashkiak miraton dhënien në përdorim të pronave të tretëve ose dhënien për zhvillim të pronës nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte private.

Kufijtë dhe tagri i ushtrimit të së drejtës së pronësisë së bashkive përcaktohet në nenin 9, pika 1.2, germa (a), e cila nuk është referuar si bazë ligjore as nga bashkia dhe as nga Prefekti, që parashikon se:

*“njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.*

Në rastin konkret, objekti i VKB nr. 54 datë 08.06.2022 ka specifikën që i përket formës së Partneritet Publik Privat dhe e vetmja bazë ligjore që përcakton përdorimin e formatit të bashkëpunimit me PPP është Ligji nr. 22/2018 “*Për strehimin social*” neni 52, pika 2.

**Si konkluzion**. Prefekti i Qarkut Fier duhet ta kishte kthyer VKB nr. 54 datë 08.06.2022 “*Për përcaktimin e procedurës për negociim me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me bashkinë e Fierit nëpërmjet marrëveshjes për pronat në pronësi të saj*”, për mungesë të referencës së bazës ligjore që rregullon procedurat dhe kriteret për përdorimin e formatit PPP të bashkëpunimit mes privatit dhe Bashkisë.

Praktika është punuar nga **D.S**, specialiste në sektorin juridik, konfirmuar nga **A.V**, Sekretar i Përgjithshëm dhe nënshkruar nga Prefekti **L.SH**.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 565/9, datë 30.8.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë;

**Pretendim i subjektit:**

*Me gjetjen dhe rekomandimin nuk jemi dakort Parashitjet qëndrimin tonë si më poshtë*

*Ju keni konstatuar si gjetje që objekti i VKB nr. 54 ka specifikën që ka krijuar një procedurë standarde që i përket formës së partneritetit publik privat. Por nga ana juaj ky lloj konstatimi nuk është shoqëruar edhe me argumentimin ligjor që do ta bënte bindës këtë lloj konstatimi por edhe ndihmues për ne. Pasi e keni marrë të mirëqenë që kemi të bëjmë me një formë PPP, na keni sqaruar se e vetmja bazë ligjore që lejon PPP me bashkitë është ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social” neni 52, pika 2. Por këtë e keni kundërshtuar po vetë ju kur thoni se sipas pikës 3 procedura rregullohet me VKM, vendim që nuk është miratuar ende. Vendimi Nr. 54, rregullon një marrëdhënie civile dhe procedura që ndiqet nuk rregullohet as nga legjislacioni i parashikuar nga Ligji Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe as nga legjislacioni i parashikuar nga ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”. Ligji organik Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) ka të*

rregulluar të drejtën dhe përgjegjësin e pronësisë. Konkretisht neni 9 pika 1.2 shkronja "a" parashikon se njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejtën e tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Në nenin 54 shkronja "e" përcaktohet se këshilli bashkiak miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve. Në zbatim të kësaj kompetence (neni 54 shkronja "k") këshilli ka të drejtë të miratojë norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik.

Për sa më sipër kjo vendimmarrje është e bazuar në ligj dhe me të drejtë prefekti e ka konfirmuar ligjshmërinë e saj.

#### **Qëndrim i grupit të auditimit:**

Sikurse është trajtuar, në rastin konkret VKB përkatëse ka krijuar një procedurë negociimi me zhvilluesit privatë të cilët kërkojnë të lidhin marreveshje siper marrje/shkëmbimi me Bashkinë Fier për zhvillimin e pasurive në pronësi të saj, të cilat janë kufitare me pasuritë që disponohen nga zhvilluesi

privat. Më konkretisht, bashkia do të heqë dorë nga pronësia e një trualli apo objekti shtetëror për t'ja kaluar në dispozicion privatit, në këmbim të përfitimit të një sipërfaqeje ndërtimore. Përmendja e ligjit për strehimin social dhe PPP në këtë trajtim është bërë me qëllim për të theksuar se bashkitë kanë të drejtë të miratojnë një procedurë të tillë, por vetëm në funksion të strehimit social. Konkretisht, nuk ka asnjë bazë ligjore që njeh miratimin e një procedure me objekt të kësaj natyre përveçse kuadrit ligjor të strehimit social, për të përfituar sipërfaqe ndërtimore në truallin ose truallin e pajisur me infrastrukturë në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Por, edhe kjo procedurë duhet miratuar në përputhje me VKM -në përkatëse.

Është e vërtetë se këshilli ka të drejtë të miratojë norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik, por kjo i referohet funksioneve. Në aspektin e pronave, për analogji bashkitë kanë të drejtë të japin prona me qira, por procedura për dhënien e tyre rregullohet me VKM.

Si konkluzion, kjo VKB e pamundëson edhe prefektin e qarkut për të kryer një verifikim të ligjshmërisë, për sa kohë që nuk ka një referencë tjetër ligjore që u atribuon bashkive një vendimmarrje të tillë, sa i përket procedurës. **Nuk merret në konsideratë.**

#### **➤ Vendime të kthyera si të pabazuara në ligj dhe të dërguara në gjykatë.**

Në lidhje me aktet për cilat Prefekti i Qarkut Fier ka konstatuar si të pabazuara në ligj, rezultojnë Bashkia Roskovec me numrin më të lartë me **4 akte**, ndërsa Bashkisë Patos dhe Bashkisë Lushnjë përkatësisht u janë kthyer **1 akt**, konkretisht:

Bashki	Nr. Vendimi	Vendime të konstatuara si të pabazuara në ligj	Padi
Roskovec	Vendimi Nr. 78 datë 31/10/2022	1.Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Roskovec"	Jo
	Vendimi Nr. 83 datë 31/10/2022	2."Për miratim fondesh dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencave civile për vitin 2022"	Jo
	Vendimi Nr. 23 datë 29/03/2022	3."Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022"	JO
	Vendimi Nr.21 datë 29.03.2022	4."Për një shtesë në vendimin Nr. 93, datë 25.11.2021 'Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022"	PO
Patos	Nr. 05 datë 25.02.2022	1."Për një ndryshim në shkronjën "c" pika 2 neni 54 të rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Patos"	Jo
Lushnjë	Vendimi Nr. 109, datë 30.11.2022	1."Mbi miratimin e planit vendor për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje të romëve dhe egjiptianëve 2022-2025"	Jo

#### **a- Bashkia Roskovec.**

Me kthim përgjigjen nr.361/1 datë 05.04.2022, Prefekti i Qarkut Fieri e ka konsideruar si të pabazuar në ligj Vendimin Nr. 21 datë 29.03.2022 "Për një shtesë në vendimin Nr. 93, datë 25.11.2021 'Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022'" dhe ka ngritur padi në Gjykatën Administrative të Apelit, duke kërkuar pavlefshmërinë e tij, çështje me nr.130 regjistri datë 20.04.2022.

Sipas Ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut”, neni 16, pika 1, shkronja (b/iv), në rastet kur vërehen shkelje ligjore në akt dhe vlerëson se kthimi i aktit nga organi i njësish së vetëqeverisjes vendore nuk do të jetë i frytshëm, Prefektit i lind e drejta që, pa ndjekur procedurën e përcaktuar në shkronjën (b), nënparagrafi (i), të kësaj pike, të kërkojë pavlefshmërinë e aktit drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës ndodhet organi i njësish së vetëqeverisjes vendore. Kur kërkon pavlefshmërinë e aktit në gjykatë, Prefekti i Qarkut njofton organin e njësish së vetëqeverisjes vendore.

Këshilli i Bashkisë Roskovec me vendimin Nr. 93, datë 25.11.2021 ka miratuar paketën fiskale për vitin 2022. Ky vendimi është verifikuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën Nr. 1450/1 datë 09.12.2021. Në këtë vendim nuk ka qenë e miratuar ndonjë tarifë për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit.

Këshilli i Bashkisë Roskovec, në datën 24.12.2021, ka miratuar vendimin nr. 102 “Për një shtesë në vendimin Nr. 93, datë 25.11.2021 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2022”. Në këtë vendim këshilli ka miratuar vendosjen e një tarife të përkohshme për rehabilitimin e mjedisit, në zonën naftënxjerrëse të Bashkisë Roskovec.

Prefekti me shkresën Nr. 03/1 prot. datë 11.01.2022, është shprehur për kthimin e vendimit si të paligjshëm duke e arsyetuar edhe qëndrimin e tij në bazë të Ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut” neni 16, pika 2, shkronja b/i. Pasi ky vendim u kthye si i paligjshëm nga ana e prefektit, rezultoi se Këshilli i Bashkisë Roskovec, në mbledhjen e datës 27.01.2022, e anuloi këtë vendim.

Në datën 29.03.2022, Këshilli i Bashkisë Roskovec, ka miratuar vendimin Nr. 21, “Për një shtesë në vendimin Nr. 93, datë 25.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”. Ky vendim është depozituar për verifikim ligjor në datën 02.04.2022, për të cilën ka ngritur padi.

- Argumentimi i Bashkisë Roskovec

Me VKB nr.21 datë 29.03.2022, Këshilli Bashkiak Roskovec ka vendosur të miratojë tarifën për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit sipas tabelës si vijon:

Emërtimi i tarifës	Kompania B. Albania	Kompania Albetrol sh.a	Çdo kompani në fushën e transportimit	Karburante	Gomisteri	Fabrika e përpunimit të ullirit, qumështit, drithërave
Tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit	3,000,000	2,000,000	500,000	200,000	20,000	100,000

Është përcaktuar të jetë vjetore me afat shlyerjeje 30 ditë nga momenti i marrjes së njoftimit. Në relacionin për projektvendimin përkatës me nr.2371/1 prot., nga Drejtoria e të Ardhurave arsyetohet se ky propozim bazohet në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 17 .

Në këtë kuadër bazuar në urdhrin e Kryetares së Bashkisë nr. 28 datë 14.02.2022 është hartuar një raport për verifikimin e aktiviteteve të subjekteve juridike dhe fizike që ndikojnë në mjedis, duke kontraktuar një ekspert të licencuar mjedisi për këtë qëllim.

- Argumentimi i Prefektit të Qarkut Fier

Prefekti i Qarkut Fier argumenton ndër të tjera se VKB Roskovec nr.21, datë 29.03.2022, bie në kundërshtim me qëllimin e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” për sa i përket konceptit të tarifës.

Qëllimi i ligjit është të rregullojë procedurën e vendosjes së tarifave për çdo shërbim specifik të ofruar, të një të mire specifike të përdorur nga subjekti apo të përfitimit të një të drejtë të dhënë nga bashkia. Në rastin konkret, sipas arsytimit të Prefektit, vendimi është shumë larg qëllimit të ligjit por është shumë afër qëllimit të bashkisë. Ligji ka përcaktuar se niveli i tarifës orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Pra kryefjala e ligjit, sipas Prefektit, në këtë rast është shërbimi i ofruar dhe se Bashkia Roskovec nuk ofron shërbime për të vendosur këtë tarifë.

- Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nr.80 (86-2022-741) datë 24.11.2022.

Në vlerësimin e besueshmërisë në prova dhe ligj të kërkesë padisë, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësua se kërkesa e paraqitur nga pala paditëse, Prefekti i Qarkut Fier është e pabazuar në ligj dhe në prova. Në arsyetimin e Gjykatës, ndër të tjera, theksohet se vendosja nga pala e paditur e tarifës për përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit jo vetëm që është përgjegjësi dhe kompetencë kushtetuese ligjore, por edhe procedura e ndjekur, të dhënat dhe argumentet ku mbështet vendosja e kësaj tarife justifikojnë plotësisht përmbushjen e qëllimit kushtetues e ligjor për të mbrojtur dhe përmirësuar mjedisit...”Sigurisht, përkujdesja për mjedisit, si element i përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore të njësisë së vetëqeverisjes vendore ka kosto të cilat duhet të përballohen prej saj. Për këto kosto, ashtu sikurse përcakton qartë dispozita e nenit 17 të ligjit nr.68/2017 duhet të ngarkohen me detyrime, pikësëpari ato subjektet që për vetë natyrën e veprimtarisë së tyre sjellin efekte të dëmshme në mjedis”.

**Si konkluzion,** Gjykata Administrative e Apelit ka rrëzuar padinë e Prefektit të Qarkut Fier. Për këtë vendim, Prefekti i Qarkut Fier ka ushtruar rekurs përmes Avokaturës së Shtetit në Gjykatën e Lartë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 565/9, datë 30.8.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë;

**Pretendim i subjektit:**

*Prefektit të Qarkut Fier kompetencën për të ngritur padi ia njej ligji për prefektin dhe kjo kompetencë nuk mund të çenohet me asnjë lloj forme. Prefekti në zbatim të kësaj kompetence nuk ka shkelur asnjë ligj material apo procedural që të kishte vend për gjetje nga ana juaj. (ju nuk argumentoni nga ana ligjore pse e konsideroni gjetje). Nëse do kishte shkelur ndonjë ligj në zbatim të kompetencës së tij për ngritjen e padisë këte do ta kishte referuar gjykata duke mos e marrë në shqyrtim padinë fare. Jemi para faktit kur gjykata pasi ka verifikuar kompetencën dhe juridiksionin e saj ka verifikuar edhe kompetencën për ngritjen e padisë dhe duke e gjetur të drejtë ka marrë në shqyrtim çështjen në themel. Në këto kushte nuk ka vend për gjetje nga ana juaj.*

*Për sa i përket lënies së rekomandimit, ne mendojmë se nuk keni të drejtë të shpreheni për një çështje që është ende në gjykatë dhe vendimi nuk ka marrë formë të prerë. Lënia e një rekomandimi kur çështja është ende në gjykatë intimidon administratën e prefektit në punën e saj.*

*Pavarësisht të gjithave Prefekti do të presë vendimin e Gjykatës së Lartë dhe në fund do të zbatojë vendimin e gjykatës i cili në këtë moment nuk e dimë si do të jetë, pa e paragjykuar.*

*Përfundimisht mendojmë se përderisa kjo çështje është në gjykatë, asnjë institucion përfshirë edhe KLSH-në nuk duhet ta marrë në shqyrtim dhe në këtë rast nuk ka vend as për gjetje dhe as për rekomandim. (bashkëlidhur gjeni vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit Nr. vendimin Nr. 80 (86-2022-741) datë 24.11.2022).*

**Qëndrim i grupit të auditimit:**

Në trajtimin e pikës së mësipërme, nuk është përmendur në asnjë paragraf se Prefekti ka vepruar gabim, por është bërë një pasqyrim objektiv i pretendimeve të Prefektit, të Bashkisë Roskovec dhe të Vendimit të Gjykatës. Rekomandimi i lënë ka si synim përmirësimin e vendimmarrjes me qëllim që Prefekti të shprehet vetëm për ligjshmërinë dhe jo për çështje që kanë të bëjnë me ofrimin ose jo të shërbimit, veçanërisht për attribute që ligji ua njej qartë bashkive sa i përket vendosjes apo jo të tarifave.

**Me kthim përgjigjen nr.1129/1 datë 10.11.2022,** Prefekti i Qarkut Fier ka kthyer si në kundërshtim me ligjin Vendimin e Këshillit Bashkiak Roskovec nr.83 datë 31.10.2022 “*Për miratim fondesh dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencave civile për vitin 2022*”, me qëllim rikonstruksionin e çatisë së shkollës “Alush Grepçka”. Sipas arsyetimit të Prefektit të Qarkut Fier, përdorimi i fondit për rikonstruksionin e çatisë së kësaj shkolle nuk bazohet në Ligjin nr.45/2019 “*Për mbrojtjen civile*”, pasi gjendja aktuale ku ndodhet shkolla nuk ka ardhur si pasojë e një fatkeqësi që sjell dëme të menjëhershme, por ka ardhur si pasojë e amortizimit ndër vite. Në këto kushte nuk mund të përdoret fondi i kushtëzuar për emergjencat civile, por bashkia duhet ta kishte parashikuar si investim me fonde të tjera jashtë këtij zëri buxhetor. Në arsyetimin e Prefektit të Qarku Fier, ky investim nuk bën pjesë në nënparagrafin 3.1, pika b e VKM nr.414 datë 08.07.2021 “*Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shteti për mbrojtjen civile*”, e cila parashikon

marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objektet infrastrukturore që përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e njerëzve, pronat e tyre dhe mjedisin, të cilat ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin e veprimtaritë e tij ekonomike. Si rrjedhojë, Prefekti ka konkluduar se këtë investim bashkia duhet ta kishte parashikuar si investim me fonde të tjera jashtë këtij zëri buxhetor.

- Dokumentacioni i dorëzuar nga Bashkia Roskovec.

Në relacionin nr. 96201/1 datë 26.10.2022 për VKB përkatëse, Bashkia Roskovec ka argumentuar se si pasojë e shirave të rënë kohët e fundit janë shkaktuar çarje në tarracën e shkollës dhe në disa prej klasave gjenden në prezencën e ujërave. Më tej, në relacion theksohet se duke u gjendur në prag të stinës së dimrit dhe duke patur parasysh gjendjen aktuale të çatisë, për të cilën është pezulluar edhe një investim për laboratorët e shkollës për këtë shkak, Bashkia Roskovec, me kërkesë të drejtoreshës së shkollës 9 -vjeçar, ka kërkuar përdorimin e këtij fondi. Bashkëlidhur vendimit janë dorëzuar:

- *Relacioni mbi situatën emergjente me nr.9492 prot., datë 21.10.2022*
- *Kërkesa e drejtorit të shkollës "Alush Grepçka" me nr. 7804 prot., datë 31.08.2022*
- *Kërkesa e ZVA Roskovec për bashkëpunim nr.8488 prot., datë 21.10.2022*
- *Procesverbali i konstatimit të dëmit nr.9492/1 datë 21.10.2022.*

Pas verifikimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Fier, me vendimin nr.88 datë 01.12.2022, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Roskovec ka anuluar Vendimin nr.83 datë 31.10.2022.

**Baza ligjore**

Bashkitë, për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile, përfitojnë nga buxheti qendror një fond të kushtëzuar për mbrojtjen civile.

Ligji për "Mbrojtjen civile", neni 65 përcakton se "Bashkitë, **për zvogëlimin e riskut** nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit".

Procedura dhe kriteret e përdorimit të këtij fondi janë përcaktuar në VKM nr. 414/2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", pika 3, 3.1(b) dhe pika 6.

Në rastin konkret, ligji u jep të drejtë bashkive të përdorin fondin për zvogëlimin e riskut dhe për marrjen e masave parandaluese, sikurse rezulton rikonstruksioni i çatisë, për të shmangur dëme të mëtejshme me qëllim uljen e riskut dhe parandalimin e një fatkeqësie nga shirat dhe degradimi i mëtejshëm.

Prefekti i Qarkut Fier e ka interpretuar aktin përkatës të investimit si jo në përputhje me qëllimin e masave parandaluese, duke arritur në konkluzionin se ky dëmtim "nuk sjell cenim të objektit infrastrukturë deri në atë pikë që të bëjë kërcënim serioz për jetën e nxënësve".

Ky konkludim nga Prefekti nuk bazohet në ndonjë akt ekspertize, por vetëm në interpretimin që i është bërë relacionit të hartuar nga Bashkia Roskovec dhe i përket sferës së trajtimit nga institucione të tjera që kanë tagrin dhe ekspertizën për të shprehur lidhur me rrezikshmërinë apo qëndrueshmërinë e objekteve. Për këtë qëllim, Prefekti i Qarkut Fier duhet t'i përmbahej parashikimeve dhe kushteve të VKM nr./414/2021, por në rast se e gjykonte të nevojshme për mirenaxhimin e fondit të kushtëzuar, duhet t'i kërkonte bashkisë që të kryente një akt-ekspertize mbi rrezikshmërinë e objekteve të amortizuara.

Si konkluzion, Prefekti i Qarkut Fier duhet ishte shprehur për përputhshmërinë e VKB me kuadrin rregullator.

Praktika është punuar nga **P.F**, specialist, **A.GJ**, përgjegjëse e sektorit juridik, **K.Y**, përgjegjëse i sektorit të emergjencave, **R.B** përgjegjëse e Sektorit të Zhvillimit Urban, konfirmuar nga **A.V** dhe nënshkruar nga Prefekti L.SH.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 565/9, datë 30.8.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë;

**Pretendim i subjektit:**

*Me gjetjen dhe rekomandimin nuk jemi dakort Parashitrojmë qëndrimin tonë si më poshtë:*

VKM Nr. 414 datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" pikën 1 parashikon.

Bashkitë për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile të përfitojnë nga buxheti qëndror një fond të kushtëzuar për mbrojtjen civile. Pra kemi të bëjmë me akordim të një fondi të kushtëzuar për mbrojtjen civile Rasti i rikonstruksionit të çatisë së shkollës "Alush Grepçka" është rasti tipik që bashkia duke mosplanifikuar fonde për mirëmbajtjen e shkollës kërkon të përdori fondet e kushtëzuara për mbrojtjen civile. Relacioni është një dokument i rëndësishëm që sqaron vendimmarrjen dhe Prefekti pikërisht bazuar në çfarë thotë vetë bashkia ka dalë në konkluzion se përdorimi i fondit të kushtëzuar të emergjencave civile nuk është në përputhje me VKM Nr.414. Prandaj kur Prefekti i Qarkut vëren se përdorimi i investimit është jashtë sferës së kritereve dhe qëllimit të fondit të emergjencave civile si masë parandaluese i lind e drejta ta kthejë vendimin në bazë të kompetencës që i njuh ligji siç edhe ka bërë dhe jo të ngrejë grupe pune apo të kërkojë ekspertiza që në këtë rast janë të padobishme siç ju shpreheni në rekomandim

#### **Qëndrim i grupit të auditimit:**

Trajtimi i mësipërm nuk synon të pengojë diskrecionin e Prefektit për të kërkuar dokumente shtesë për sa i përket përdorimit të investimi. Në rastin konkret, Prefekti i Qarku Fier e ka interpretuar aktin përkatës të investimit si jo në përputhje me qëllimin e masave parandaluese, duke arritur në konkluzionin se ky dëmtim "nuk sjell cenim të objektit infrastrukturë deri në atë pikë që të bëjë kërcënim serioz për jetën e nxënëse". Ky konkludim nga Prefekti nuk bazohet në ndonjë akt ekspertize, por vetëm në interpretimin që i është bërë relacionit të hartuar nga Bashkia Roskovec, megjithëse relacioni dhe dokumentacioni shoqërues tregon qartazi për një rast emergjent. **Nëse gjykohej e nevojshme, Prefekti mund të kërkojë bashkisë dokumente shtesë si akt ekspertize, gjë që nuk është bërë në rastin në fjalë.**

### **Për vitin 2022, ka rezultuar në përputhje me kuadrin rregullator verifikimi i ligjshmërisë për vendimet e këshillave bashkiakë sipas tabelës:**

Bashkia Lushnjë	Bashkia Roskovec	Bashkia Patos	Bashkia Mallakastër
VKB nr. 115, datë 21.12.2022 "Mbi një shtesë në transferatën specifike të vitit 2022, dhe mbi përdorimin e transferatës specifike për shlyerje detyrimesh të prapambetura",	VKB nr.78 datë 31.10.2022 "Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Roskovec"	VKB nr.5 datë 25.02.2022 "Për një ndryshim në shkronjën "c" pika 2 neni 54 të rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Patos",	VKB nr.53 datë 28.09.2022 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar".
VKB nr. 117 datë 21.12.2022 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore. Administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjës dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2023"	VKB nr.23 datë 29.03.2022 "Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022"		
VKB nr. 118, datë 21.12.2022, "Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 (PBA) të Bashkisë Lushnjë"			

#### **- VITI 2023**

Për vitin 2023 janë 138 akte të regjistruara dhe të trajtuara nga Prefekti i Qarkut Fier, nga të cilat 133 rezultojnë të bazuara në ligj, 5 janë konstatuar si të pa pabazuara në ligj, ndërsa për 113 akte është bërë verifikim i ligjshmërisë së akteve në vend.

**Tabela 2. Të dhënat mbi vendimet e përcjella nga bashkisë dhe Këshilli i Qarkut Fier dhe trajtuara nga Prefekti**

Nr.	Njësia e qeverisjes vendore	Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të organeve të qeverisjes vendore								Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve		Dërguar në gjykatë		Vendime të pa konfirmuara, në proces për kërkim informacioni	
		Akte të hyra tek Prefekti		Të bazuara në ligj		Të pa bazuara në ligj		Të rishqyrtuara nga OQV							
		Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog
1	Këshilli i Qarkut Fier	3	9	3	9	0	0	0	0	1	6	0	0	0	0
2	Bashkia Fier	5	22	5	22	0	0	0	0	3	18	0	0	0	0
3	Bashkia Lushnje	5	26	5	26	0	0	0	0	8	21	0	0	0	0
4	Bashkia Mallakastër	4	20	4	17	0	3	0	0	3	17	0	0	0	0
5	Bashkia Divjake	4	21	4	21	0	0	0	0	6	18	0	0	0	0

Nr.	Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të organeve të qeverisjes vendore									Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve		Dërguar në gjykatë		Vendime të pa konfirmuara, në proces për kërkim informacioni	
	Akte të hyra tek Prefekti		Të bazuara në ligj		Të pa bazuara në ligj		Të rishqyrtuara nga OQV								
	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	
6	Bashkia Patos	3	15	3	14	0	1	0	0	4	13	0	0	0	0
7	Bashkia Roskovec	7	25	7	24	0	1	0		3	20	0	0	0	0
<b>TOTALI</b>		<b>31</b>	<b>138</b>	<b>31</b>	<b>133</b>	<b>0</b>	<b>5</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>28</b>	<b>113</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

**Burimi:** Nga të dhënat e Prefekturës dhe përpunuar nga grupi i KLSH

Numri më i lartë i akteve të regjistruara në protokollin e Prefektit të Qarkut Fier i përket Bashkisë Lushnjë me 26 akte, e ndjekur nga Bashkia Roskovec me 25 akte, Bashkia Fier me 22 akte, Bashkia Divjakë me 21 akte, Bashkia Patos me 15 akte dhe Këshilli i Qarkut Fier me 9 akte.

Numri më i lartë i akteve të kthyera nga Prefekti si të pabazuar në ligj i përket Bashkisë Mallakastër me 3 akte e ndjekur nga Bashkia Patos dhe Bashkia Roskovec përkatësisht me 1 akt.

Në lidhje me natyrën e akteve të dorëzuara, sipas ligjin nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut”, neni 16, vendimet me karakter normativ të këshillave bashkiak dhe të Qarkut, që janë me intervale më të shpeshta kanë kryesisht për objekt:

- “Për dhënien e mandateve të anëtarëve të këshillit të bashkisë”
- “Për zgjedhjen e përfaqësuesve të këshillit në Këshillin e Qarkut Fier”
- Për miratimin e një shtese në buxhetin e vitit 2022 nga të ardhurat e trashëguara
- “Për miratimin e projekt dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2024-2026 faza 1”
- “Mbi miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”

Aktet me intervale më të pakta, që kanë një objekt ndryshe nga aktiviteti tradicional buxhetor apo financiar, janë:

- “Mbi përditësimin dhe miratimin e listës përfundimtare inventarit të pasurive të paluajtshme të bashkisë
- “Për miratimin e rregullores të kushteve për tregtimin në markat”
- “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të emergjencave civile 2023”
- “Për miratimin e planit të strehimit social vendor 2023-2028”.

## ➤ VENDIME TË MIRATUARA

### a- Bashkia Fier.

Me kthim përgjigjen nr.354/3 prot., datë 26.04.2023, Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar ligjshmërinë e VKB nr.35 datë 20.03.2023 të Këshillit të Bashkisë Fier “Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Fier, për njësinë administrative Levan”, duke konfirmuar ligjshmërinë pas plotësimit të dokumentacionit.

Me VKB NR.35 datë 20.03.2023, Bashkia Fier ka miratuar listën përfundimtarë me 13 pasuri. Konkretisht, me kthim përgjigjen nr.351/1 prot., datë 03.04.2023, Prefekti i Qarkut Fier ka kërkuar konfirmimin e statusit juridik për disa pasuri, për të cilën nga Bashkia Fier është kthyer përgjigje me shkresën nr.33456 prot., datë 14.04.2023.

### **Baza ligjore**

Shqyrtimi i akteve të Këshillit Bashkiak për miratimin dhe përditësimin e listës së inventarit të pasurive të paluajtshme është një kompetence e re që i është shtuar Prefektit, konkretisht me VKM nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”. Në pikën 3 germa (dh) ku përcaktohet se për pronat që përditësohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, lista e pronave, së bashku me relacionin dhe planin e rilevimit i nënshtrohet



vendimmarrjes nga këshilli bashkiak dhe verifikimit të ligjshmërisë nga prefekti, përpara se të përcillet për shqyrtim pranë ASHK-së”.

Dokumentacioni i përcaktuar më sipër është dorëzuar te Prefekti i Qarkut Fier si dhe është konfirmuar ligjshmëria, në zbatim të VKM. Megjithatë, nga ana teknike rezultojnë se:

-Ka një mospërputhje mes pasurive të inventarit të bashkisë dhe statusit juridik të konfirmuar nga ASHK, konkretisht si vijon:

Pasuria me nr.	Zona kadastrale	Sipërfaqja sipas ASHK në m <sup>2</sup>	Sipërfaqja sipas inventarit	Diferenca
96	2436	116,100	115,100	-1000 m <sup>2</sup>
50	1230	23600 (moçal)	24426 (ranishte)	-826 m <sup>2</sup>
67	1230	7400 (varreza)	14862	+7462 m <sup>2</sup>
68	1230	8700 pyll	4791	-3909 m <sup>2</sup>

Pasuria me nr.67 nuk figuron e regjistruar në regjistrat publike, sipas shkresës nr.8245 prot., datë 30.09.2022 të DVASHK Fier.

-Formulari i përditësimit nuk është plotësisht sipas formatit të VKM nr.28/2023, pasi mungojnë të dhënat mbi faktin e inventarizimit apo jo të pasurive përkatëse me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas pikës 1, germa (dh) dhe nëse janë miratuar si lista përfundimtare për transferimin në pronësi apo përdorim.

-Për disa pasuri të përfshira në inventar nuk ka informacion nëse për këto prona ka mbaruar regjistrimi fillestar, pra azhurnimi përfundimtar mbi sipërfaqet dhe statusin juridik, konkretisht si më poshtë:

Pasuria me nr.	Zona kadastrale	Lloji i pronës	Sipërfaqja
9-A	2968 (fshati Pish Poro)	Pa fryt	7100
117-A	2968 (fshati Pish Poro)	Pa fryt	14000
116-A	2968 (fshati Pish Poro)	Pa fryt	56000
115-A	2968 (fshati Pish Poro)	Pa fryt	37000

Sipas portalit ASIG, këto pasuri shtrihen në zona të paazhurnuar për të cilën nuk ka informacion juridik. Për rrjedhojë, sipas pikës 5 germa (c), nuk mund të merret informacioni për gjendjen juridike (kartelat kadastrale) të pasurisë/pasurive të paluajtshme që preket/n nga përditësimi, jo më të hershëm se 30 (tridhjetë) ditë.

Si konkluzion, ndonëse nga Prefekti është shqyrtuar dokumentacioni i kërkuar sipas VKM nr.23/2023, marrë parasysh se kjo është një shqyrtim në një fushë të re të përditësimit dhe miratimit të listës përfundimtare të pronave, Prefekti i Qarkut Fier duhet të kërkojë së pari informacion nëse ka inventar përfundimtar të miratuar apo jo me VKM për pasuritë përkatëse dhe nëse këto pasuri shtrihen në zona për të cilën ka përfunduar ose jo regjistrimi fillestar. Informacioni juridik i administruar në rastet kur ka përfunduar procesi i regjistrimit fillestar duhet të jetë në përputhje me atë çka miratohet në listat përfundimtare të pasurive nga Këshilli Bashkiak. Në relacionin që shoqëron vendimin përkatës, nga ana e Bashkisë duhet që informacioni i dërguar të jetë i saktë dhe të përputhen të dhënat e bashkisë për statusin juridik me informacion e administruar nga ASHK.

Praktika është punuar nga **D.S**, **A.GJ** sektori juridik, **R.B** sektori i zhvillimit urban dhe konfirmuar nga **A.V**, nënshkruar nga Prefekti i Qarkut **L.SH**.

**Me kthim përgjigjen nr.720/1 datë 14.07.2023**, Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar ligjshmërinë e Vendimit nr.67 datë 30.06.2023 të Këshillit Bashkiak Fier “Për shpërndarjen dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile” Ky akt është regjistruar në protokollin me datë 06.07.2023.

Me VKM nr.67 datë 30.06.2023 ka miratuar shpërndarjen dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit si vijon:

Llogaria ekonomike	Kodi i Projektit	Emërtimi i produktit	Shuma
--------------------	------------------	----------------------	-------

604	91007AG	Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve edhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e njerëzve	15,302,826
604	91007AB	Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme	6,558,293
Shuma			21, 861,119

Këtë vendimmarrje, KB e bazon edhe në shkresën nr.86/6 datë 27.03.2023 të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, e cila thekson se për vitin 2023, në degën e thesarit për artikullin 604 janë funksionale dy kode si mëposhtë:

Kodi i produktit 91707 AG-*Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve edhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e njerëzve.*

Kodi i produktit 91707 AB-*Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme.*

Në këtë kuadër, me qëllim përdorimin e fondit të kushtëzuar për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, AKMC ka kërkuar ndarjen e fondit sipas kodeve të mësipërme.

Në relacionin me nr. 5478/1 datë 23.06.2023, Bashkia Fier ka miratuar përdorimin e fondit prej 15,302,826 lekë për blerje mjeti teknologjik “skrep me goma” që nuk përputhet me përshkrimin e vendosur nga AKMC dhe në VKB përkatëse që është “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve edhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e njerëzve”.

Për këtë pikë, Prefekti i Qarkut duhet ta kishte kthyer VKB për plotësim dokumentacioni dhe për të konfirmuar nëse në referencë të shkresës së AKMC mund të përdoret fondi për blerje makinerie teknologjike apo jo.

Praktika është punuar nga **K.Y.**, përgjegjës i sektorit të emergjencave dhe mbrojtjen civile, **A.GJ, D.S** dhe konfirmuar nga **A.V.**, nënshkruar nga Prefekti **L.SH.**

#### **b- Bashkia Roskovec.**

1. Me shkresën nr.1298 datë 04.01.2024, Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar ligjshmërinë e Vendimit nr.133 datë 21.12.2023 të Këshillit Bashkiak të Roskovecit “Për përditësim në listën e inventarit, miratuar me VKM-në nr. 108, datë 17.02.2010, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kurjan, Bashkia Roskovec”.

Përmes këtij vendimi, Këshilli Bashkiak Roskovec ka miratuar përditësimin e pasurisë nr.213/1, zona kadastrale 3805 fshati Vlosh, me qëllim që inventarit t’i shtohen dy godina. Në bazë të inventarit të bashkisë, pasuria me nr. 213/1 rezulton me sipërfaqe totale 2310 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe totale ndërtesë 2310 m<sup>2</sup> tre godina me sipërfaqe parcele ndërtimore 770 m<sup>2</sup>.

#### **- Baza ligjore.**

Në zbatim të VKM nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, pika 2 germa (a).

Në rastin konkret, në dokumentacionin e dorëzuar nga Bashkia Roskovec vërehet se:

Për pasurinë nr.213/1 për të cilën kërkon ta përditësojë, Bashkia Roskovec disponon certifikatë pronësie me datë lëshimi 21.02.2023, ku rezulton sipërfaqja 8970 m<sup>2</sup> truall, pa sipërfaqe ndërtimi, çka nënkupton se regjistrimi fillestar i ASHK nuk ka paraqitur godinat. Në kartelën e pasurisë, lëshuar me datë 05.12.2023, në seksionin “D” kufizimet e pronësisë” ka shënimin se mbi këtë truall ka katër ndërtime pa leje ndërsa në përshkrime të tjera ka shënim se “mbi këtë truall ndodhen 2 objekte të rrënuara”. Mungon harta treguese kadastrale që shoqëron certifikatën e pronësisë për të vlerësuar përputhshmërinë hartografike mes planit të rilevimit të dorëzuar nga bashkia dhe hartës së administruar në ASHK. Kjo pasuri është regjistruar me VKM nr. 27, datë 27.1.2023 “Për transferimin në pronësi të bashkisë Roskovec, për njësinë administrative Kurjan, të pasurisë me numër 213, zona Kadastrale 3805, dhe për një ndryshim

në vendimin nr. 770, datë 24.9.2010, të këshillit të ministrave” që nuk i është përcjellë Prefektit nga Bashkia Roskovec.

- Formulari i inventarizimit nuk është hartuar sipas modelit të miratuar.

Si konkluzion, Prefekti i Qarkut Fier ka kryer verifikimin në përputhje, por duhet të kishte kërkuar plotësim dhe saktësim të dokumentacionit lidhur me VKB nr.133 datë 21.12.2023 të Këshillit Bashkiak të Roskovecit “Për përditësim në listën e inventarit”. Praktika është punuar nga **P.F, A.GJ, R.B**, konfirmuar nga **A.V** dhe nënshkruar nga Prefekti **R.B**.

Me Vendimin nr. 453, datë 10.7.2024, Bashkisë Roskovec i është miratuar transferimi i godinave përkatëse.

**Me shkresën nr.494/1 datë 10.05.2023**, Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar ligjshmërinë e Vendimit nr.48 datë 27.04.2023 të Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2023”, regjistruar në protokollin e Prefektit datë 28.04.2023.

Përmes këtij vendimi, Këshilli Bashkiak Roskovec ka miratuar përdorimin e vlerës prej 4,999,918 lekë për rikonstruksionin e shkarjes në rrugën Lamaj, fshati Mbërs. Ne relacionin me nr.2856/1 prot., datë 27.04.2023 shpjegohet se nga Administratori i Njesisë Administrative Kurjan përmes një shkresë është njoftuar se ka patur rrëshqitje dhe në një lagje të fshatit Mbërs, duke izoluar banorët e kësaj lagjeje dhe se kjo rrugë është e vetmja që shërben për të dërguar fëmijët në kopsht.

#### - **Baza ligjore**

Në bazë të VKM nr.414/2021, pika 3.1 germa (b), bashkitë mund të përdorin fondin për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objektet infrastrukturore që përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e njerëzve, pronat e tyre dhe mjedisin, të cilat ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin e veprimtaritë e tij ekonomike”.

Duke qenë se Mbledhja e Këshillit Bashkiak është bërë fushatës zgjedhore nuk rezulton të jetë bërë vlerësim nëse kjo mbledhje është në përputhje me Vendimin nr.9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ “*Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve*”, në zbatim të nenit 91 dhe 92/1 të Kodit Zgjedhor .

Në nenin 1, pika 2 përcaktohet se qëllimi i këtij vendimi është vendosja e rregullave në funksion të marrjes së masave, monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore e vendore si dhe administratës shtetërore, gjatë periudhës 4(katër) muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve...

Në nenin 2, germa (b) përcaktohet se “veprimtari publike” janë të gjithë veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në vendim si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Në nenin 3 germa (b) përcaktohen veprimtari publike të ndaluara si “*mbështetje dhe promovimin e projekteve dhe ose investimeve kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik si dhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, shëndetit, kuturis, rinisë, sporteve dhe arsimit publik në të gjitha nivelet dhe të infrastrukturës*”.

Praktika është punuar nga **P.F, A.GJ, K.Y** konfirmuar nga **A.V** dhe nënshkruar nga Prefekti **L.SH**.

**Me shkresën nr.125/1 datë 06.02.2023**, Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec nr.6 datë 27.01.2023 “Për një shtesë dhe ndryshim në buxhetin e vitit 2023”, shoqëruar nga projektvendimi dhe relacioni shpjegues, regjistruar në protokollin e Prefektit datë 30.01.2023.

Përmes këtij vendimi, Këshilli Bashkiak Roskovec ka miratuar një shtesë fondi prej 10,000,000 lekë me objekt “kontribut për investime në banesat sociale”, duke pakësuar të njëjtën vlerë për projekte të tjera.

Duke qenë se Mbledhja e Këshillit Bashkiak është bërë në datë 06.02.2023, në periudhën brenda 4 muajve para zgjedhjeve lokale, nga Prefekti i Qarkut Fier nuk rezulton të jetë bërë vlerësim nëse kjo mbledhje është në përputhje me Vendimin nr.9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Konkretisht, sipas Nenit 3 germa (b) të këtij vendimi normativ të Komisionit Rregullator, janë veprimtari të ndaluara për t’u promovuar ato veprimtari publike për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor në periudhën 4 mujore para datës së zgjedhjeve që përfshin mbështetjen dhe promovimin e projekteve/investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik...në shërbim të interesit publik”.

**Me kthim përgjigjen nr.125/1 datë 06.02.2023**, Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec me nr.8 datë 27.01.2023 “Për një ndryshim në VKB nr.47 datë 17.05.2029 “Për miratimin e planit social të bashkisë Roskovec 2019-2023. Në dosje administrohen projektvendimi dhe relacioni shpjegues.

Përmes këtij vendimi, Bashkia Roskovec ka shtyrë me një vit zbatimin e Planit Social të bashkisë. Në relacionin shpjegues thuhet se “referuar thirrjes për aplikim projektsh të kujdesit social shoqëror nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Social, njoftuar Bashkisë Roskovec, me shkresën nr.221 prot., datë 13.01.2023, Plani Social aktiv përbën një nga kriteret themelore për pranimin e projekt-propozimeve të Bashkisë Roskovec.

#### - **Baza Ligjore**

Në bazë të VKM Nr. 150, datë 20.3.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, pika 10 përcakton se Këshilli bashkiak miraton planin social trevjeçar të buxhetuar, si dhe kërkesën për financim(fonde) nga buxheti i shtetit, brenda muajit shkurt të çdo viti, për atë pjesë të planit që mbetet i pambështetur nga buxheti i bashkisë”.

Sikurse rezulton, plani social është tre vjeçar dhe është i lidhur ngushtësisht me buxhetin e viteve përkatëse, çka nënkupton se ligji nuk parashikon shtyrje të këtij plani, për një vit buxhetor që nuk është përfshirë në planin 3 vjeçar.

Si pasojë, Prefekti i Qarkut Fier duhet ta kishte kthyer VKB nr.47 datë 17.05.2023 si jo në përputhje me kuadrin rregullator.

Praktika është punuar nga **P.F**, specialist, **A.GJ**, përgjegjëse e sektorit juridik, konfirmuar nga **A.V** dhe miratuar nga **L.SH**, Prefekt.

#### c- **Bashkia Lushnje.**

Me kthim përgjigjen nr. 1021/1 datë 05.10.2023, Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar ligjshmërinë e Vendimit nr.75 datë 29.9.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për emergjencat civile 2023”, shoqëruar me projektvendimin dhe relacionin përkatës, duke konkluduar se është në përputhje me kuadrin rregullator. Kjo VKB ka si objekt blerjen e një mjeti zjarrfikës me autoshkallë në shumën 6,000,000 lekë.

#### **Baza ligjore**

VKM Nr. 290, datë 17.5.2023 “Për një ndryshim në vendimin nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” shkronja “ë”, e pikës 3.1, ndryshohet, si më poshtë vijon: “ë) blerjen e automjeteve për përdorim të veçantë, makinave teknologjike dhe mjeteve rrugore të veçanta, të përcaktuara si të tilla, sipas parashikimeve të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente, të krijuara si pasojë e një fatkeqësie, si edhe për shpenzime të kryera për blerje karburanti dhe pjesësh ndërrimi për automjete dhe makineri, të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente, të krijuara si pasojë e një fatkeqësie”.

Si rrjedhojë, nga ana ligjore blerja e kësaj makinerie është në përputhje me kuarin rregullator megjithatë, duhet saktësuar çështja e shkresës nr.86/6 datë 27.03.2023 të Agjencisë Kombëtare

të Mbrojtjes Civile, nëse Kodi i produktit 91707 AG-Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve edhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e njerëzve, përfshin edhe blerje automjete.

- **Vendimi i Këshillit të Bashkisë Lushnjë Nr. 30, datë 24.3.2023** “Mbi përditësimin e inventarëve të miratuar nga VKM nr. 175, datë 6.3.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të bashkisë Lushnjë, të Qarkut Fier, të pasurisë 17/122, lagje Kongresi Lushnjës”, shoqëruar nga projektvendimi nr. 24, datë 13.3.2023, i protokolluar me nr. 2240/1 prot. datë 13.3.2023, relacioni nr. 2240 prot. datë 13.3.2023, është në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 9, pika 1, nënpika 1.1/“b”, dhe nënpika 1.2 shkronja “a” dhe “c”; VKM nr. 175, datë 6.3.2021 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të bashkisë Lushnjë”; Ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e procedurave kalimtare të pronësisë në RSH”, nenet 37 dhe 39; Ligji nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë vendore” (i ndryshuar), si dhe të VKM nr. 28, datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve” pika 2, kap II pika 3 germa “dh”.

#### **Konstatimi:**

Me kthim përgjigjen nr. 345/1, datë 30.3.2023, Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar ligjshmërinë e Vendimit nr.30 datë 24.03.2023 të Këshillit Bashkiak Lushnjë “Mbi përditësimin e inventarit të miratuar me VKM nr.175 datë 06.03.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Lushnjë” të Qarkut Fier për pasurinë nr. 17/122 zk.857.

Përmes këtij vendimi, Këshilli Bashkiak ka ndryshuar zërin kadastral të pasurisë nr.17/122 me sipërfaqe 75 m<sup>2</sup> nga “rrugë” në “truall publik”, në kuadër të korrespondencës me DVASHK Lushnjë, e cila me shkresën nr.2835 datë 12.05.2022 thekson se gjatë procedurave të legalizimit për dy objekte informale, kjo sipërfaqe përdoret si oborr i objekteve përkatëse dhe se sipas planshetës së vitit 1982 nuk ka qenë pasuri e llojit “rrugë.” Pasuria pozicionohet në zonën kadastrale 8571 e cila ende nuk ka përfunduar procesin e regjistrimit fillestar.

Prefekti ka administruar dokumentacionin sipas VKM nr.28/2023, por nga ana teknike rezulton se:

-Në VKB përkatëse është përdorur si bazë ligjore, pika 3 e Kapitullit II të VKM nr.28/2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”. Por, nga auditimi rezultoi se objekti i VKB së miratuar për përditësim nuk përputhet me atë çka është vendosur për t’u realizuar, konkretisht ndryshimi i zërit kadastral. Në VKM nr.28/2023 nuk përcaktohet qartë se bashkitë kanë të drejtë të ndryshojnë zërin kadastral, po ashtu nuk është miratuar përditësimi i pasurisë përkatëse me qëllimin ligjor për regjistrimin si pronë e bashkisë, por është ndryshuar zëri kadastral me qëllim kalimin e kësaj sipërfaqeje si truall funksional për objektin e legalizuar.

Në rastin konkret, meqenëse kjo pasuri është pjesë e proceseve kalimtare të pronësisë, sipas shkronjës (ç) të pikës 1 dhe nëse nga gjendja faktike e konstatuar nga DVASHK Lushnjë rezulton se nuk është “rrugë”, me miratimin e legalizimit kjo pronë i hiqet inventarit të bashkisë.

Si konkluzion, në zbatim të pikës shkronjës (c), pikës 6 kreu II, duhej propozuar revokimi i pronësisë sipas parashikimit të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, për atë sa kjo sipërfaqe është në përputhje me kriteret e legalizimit.

**Me kthim përgjigjen nr.819/1 datë 01.08.2023**, Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar ligjshmërinë e Vendimit nr.39 datë 24.07.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për ndërhyrjen e menjëhershme në pronën publike, shkolla Hajredin Fratari”. Prefekti i Qarkut është shprehur për përputhshmërinë, por me shënimin se përdorimi i fondit duhet t’i përmbahet pikës 3.1, germa (c) të VKM nr.414/2021.

Përmes këtij vendimi, Këshilli Bashkiak ka miratuar përdorimin e vlerës prej 5,294,750 lekë, duke iu referuar VKM nr.414/2021, pika 3.1 germa (c).

Nga relacioni i Bashkisë rezulton se në çatinë e shkollës përkatës me datë 15.05.2023 ka rënë një zjarr me datë 15.05.2023, shoqëruar me procesverbal konstatimi dëmi.

Në relacionin për projektvendimin, nga Bashkia Mallakastër theksohet se ky fond do të përdoret për kryerjen e investimeve në çati, sikurse konfirmohet edhe në procesverbalin e mbajtur për vlerësimin e dëmeve. Në relacionin e mbajtur nga përgjegjësi i sektorit të planifikimit dhe mbrojtjes civile të Prefektit të Qarkut Fier theksohet se është përgjegjësi e bashkisë që këto fonde të përdoren në formë shërbimesh të ndërhyrjes së menjëhershme në shpëtimin e jetës së shtetasve, pronës private e publike, si dhe mbrojtjen e mjedisit, të cilat janë dëmtuar ose kërcënohen nga fatkeqësi të ndryshme” .

#### **VKB e rikthyer.**

Vendimit nr.39 datë 24.07.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për ndërhyrjen e menjëhershme në pronën publike, shkolla Hajredin Fratari” vjen pasi Prefekti i Qarkut Fier ka kthyer Vendimin e Këshillit bashkiak me të njëjtin objekt, konkretisht VKB nr.30 datë 27.06.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për zbatimin e investimit ndërtimi i çatisë së shkollës Hajredin Fratari”. Konkretisht, me kthim përgjigjen nr.689/1 datë 05.07.2023, nga Prefekti i Qarkut është arsyetuar se baza ligjore ku është mbështetur vendimi është vendosur në interpretim të gabuar të VKM nr.414/2021, konkretisht për shkak se kriteri shërbim që kërkon pika 3.1 germa (c) nuk përputhet me atë çka këshilli bashkiak ka miratuar, që është investimi e për rrjedhojë është kthyer në kundërshtim me VKM nr.414/2021.

Sikurse konstatohet VKB nr.39 datë 24.07.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për ndërhyrjen e menjëhershme në pronën publike, shkolla Hajredin Fratari” dhe VKB nr.30 datë 27.06.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për zbatimin e investimit ndërtimi i çatisë së shkollës Hajredin Fratari” janë në thelb të njëjta, me të njëjtën bazë ligjore dhe me të njëjtin objekt sipas relacionit, por Prefekti i Qarkut Fier ka shprehur dy qëndrime të ndryshme.

Praktika është punuar nga **P.F**, specialist, **A.GJ** përgjegjëse e sektorit juridik dhe **K.Y**, përgjegjës i sektorit të emergjencave, konfirmuar nga **A.V** dhe nënshkruar nga Prefekti i Qarkut, **L.SH**.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 565/9, datë 30.8.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë;

#### **Pretendim i subjektit:**

*Me gjetjen jemi dakort por mendojmë se rekomandimi i mësipërm që të jetë i zbatueshëm ka nevojë për ndryshim, në mënyrë të jetë i zbatueshëm. Jemi dakort me faktin që nëse një vendim ka të saktë vendosjen e ligjit apo të aktit nënligjor por është gabuar në gjetjen e pikës apo të nenit të konfirmojmë vendimin duke i vënë në dukje bashkisë pasaktësinë por kriter kryesor është që duhet të jetë vendosur ligji i duhur, që i jep të drejtë bashkisë të marrë atë vendim, në të kundërt Prefekti në zbatim të kompetencës që i njeh ligji nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut” neni 16 kthen aktin duke argumentuar arsyen.*

#### **Qëndrim i grupit të auditimit:**

Sugjerimet tuaja lidhur me rekomandimin **do të merren në konsideratë.**

#### **d- Bashkia Divjakë**

Me kthim përgjigjen nr.526/1 datë 10.05.2023, Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Divjakë nr.20 datë 10.05.2023 “Për miratimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencave civile”, shoqëruar me projektvendimin dhe relacionin përkatës, regjistruar në protokollin e Prefektit datë 02.05.2023, prej 3,031,728 lekë për

rehabilitimin e katër urave për kalimin e këmbësorëve, mjeteve të qarkullimit rrugor, duke e konsideruar edhe si ndërhyrje urgjente, sipas germës (b) të VKM nr.414/2021.

Ky fond është përdorur sipas kodit të produktit 791707 AG-*Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve*”.

Në raport me vlerësimin e përputhshmërisë me VKM nr.414/2021, VKB përkatëse është në përputhje me ligjin.

Duke qenë se Mbledhja e Këshillit Bashkiak është bërë në datë 04.05.2023, 10 ditë para zgjedhjeve lokale nuk rezulton të jetë bërë vlerësim nëse kjo mbledhje është në përputhje me Vendimin nr.9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, në zbatim të nenit 92/1 të Kodit Zgjedhor që përcakton se institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.

Në nenin 1, pika 2 përcaktohet se qëllimi i këtij vendimi është vendosja e rregullave në funksion të marrjes së masave, monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore e vendore si dhe administratës shtetërore, gjatë periudhës 4(katër) muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve...

Në nenin 2, germa (b) përcaktohet se “veprimtari publike” janë të gjithë veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në vendim si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Në nenin 3 përcaktohen veprimtari publike të ndaluara si:

(b) mbështetje dhe promovimin e projekteve dhe ose investimeve kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik si dhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, shëndetit, kulturës, rinisë, sporteve dhe arsimit publik në të gjitha nivelet dhe të infrastrukturës. Me VKB nr.46 datë 22.09.2023, Këshilli Bashkiak i Divjakë e ka shfuqizuar VKB nr.20 datë 10.05.2023, ku kërkonte ndërhyrje me statusi “urgjent” për rehabilitimin e urave, duke i rialokuar këto fonde në një projekt tjetër për emergjencat civile.

Sipas nenit 7, pika 1, germa (a) “Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike, qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë organizojnë menjëherë punën dhe marrin masat e nevojshme për garantimin e zbatimit të detyrimeve ligjore për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të veprimtarisë së tyre institucionale të administratës shtetërore, në nivel në qendror e vendor”.

**Me kthim përgjigje nr. 225/1 prot, datë 28.2.2023,** Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar në përputhje me kuadrin rregullator të VKB, si:

**- Vendimi i Këshillit të Bashkisë Divjakë Nr. 13, datë 22.2.2023** “Për miratimin e një shtese në buxhet viti 2023 nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2022”, shoqëruar nga projektvendimi Nr. 11, datë 14.2.2023, i protokolluar nr. 785 prot, datë 14.2.2023, relacioni Nr. 785/1 prot, datë 14.2.2023, është në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), neni 8 pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1/“b”, neni 54 shkronja “dh”; Ligjin Nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 6 germa “b”, neni 10 dhe neni 44, si dhe Udhëzimin i MFE nr. 9, datë 20.3.2018 “Për Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pika 103.

Vendimi i KB nr. 13, datë 13.22.2023, vendosi: “Të miratojë shtesë në buxhetin e vitit 2023 nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2022, sipas akt-rakordimit Dega Thesarit Lushnje në shumën 26,280,364 lekë, nga e cila: transfertë e pakushtëzuar në shumën 17,547,391 lekë, transfertë specifike në shumën 7,848,347 lekë dhe të ardhura jashtë limiti në shumën 884,626 lekë.

#### **e- Bashkia Patos**

Me kthim përgjigje nr. 1218/1 prot, datë 11.12.2023 Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar në përputhje me kuadrin rregullator të VKB, si :

**- Vendimi i Këshillit të Bashkisë Patos Nr. 71, datë 30.11.2023** “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave për vitin 2024”, shoqëruar nga projektvendimi Nr. 60, datë 22.11.2023, relacioni Nr. 3095/1 prot, datë 22.11.2023, procesverbal i dëgjësës publike nr. 2145/2-4, 2511/7-9, prot, datë ---- është në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), neni 8 pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1/“b”, neni 54 shkronja “f”; Ligjin Nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 3 pika 10, neni 14, si dhe të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” ( i ndryshuar) neni 35 pika 1 dhe 2; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH” (i ndryshuar), Udhëzimin e MF nr. 24, datë 2.2.2008 Për Procedurat Tatimore në RSH” (i ndryshuar), etj.

#### **➤ VENDIME TË KTHYERA SI TË PABAZUAR NË LIGJ.**

Në lidhje me aktet për cilat Prefekti i Qarkut Fier i ka konstatuar si të pabazuara në ligj rezultojn Bashkia Roskovec me numrin më të lartë me 3 akte, ndërsa Bashkisë Patos dhe Bashkisë Mallakastër përkatësisht u janë kthyer 1 akt, konkretisht sipas tabelës si më poshtë:

Bashki	Nr. Vendimi	Vendime të konstatuara si të pabazuara në ligj
Mallakastër	Nr. 8 Datë 21.02.2023	“Për miratimin e Projektit: Reabilitimi i rrëshqitjeve në rrugën Hekal-Klos-Poçem”
	Nr. 30 Datë 27.06 2023	“Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për zbatimin e investimit “ Ndërtimi i çatisë së shkollës “Hajredin Fratari” Damës Mallakastër
	Nr. 31 Datë 27.06 2023	“Për miratimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”
Patos	Nr. 20 datë 27.03.2023	“Për miratimin e fillimit të procedurës së privatizimit të ish zyrave të NFP-së me Nr. Pasurie 6/15 Z.K.2890 pajisur me certifikatë pronësie me pronar Bashkia Patos”
Roskovec	Nr. 29 datë 15/03/2023	Për miratim të përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2023”

#### **Për vitin 2023, ka rezultuar në përputhje me kuadrin rregullator verifikimi i ligjshmërisë për vendimet e këshillave bashkiakë sipas tabelës:**

Bashkia Fier	Bashkia Lushnjë	Bashkia Roskovec	Bashkia Patos	Bashkia Mallakastër	Bashkia Divjakë
VKB nr.29 datë 20.03.2023 “Për miratimin e tavanëve të shpenzimeve të buxhetit afatmesëm 2024-2026”	VKB nr.74 datë 29.09.2023 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për familjen e Znj.Arta Brahimaj, banesa e së cilës është dëmtuar nga zjarri”	VKB nr. 29 datë 15.03.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2023”	VKB Nr. 71, datë 30.11.2023 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave për vitin 2024”	VKB nr. 45 datë 28.09.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për blerje materialesh të ndryshme për mbrojtjen civile”.	VKB nr. 13, datë 22.2.2023 “Për miratimin e një shtese në buxhet viti 2023 nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2022”.
VKB nr.65 datë 30.06.2023 “Për një ndryshim në buxhetin 2023”	VKB nr.78 datë 29.09.2023 “Mbi një shtesë në buxhetin e vitit 2023 miratuar me VKB	VKB nr. 107, datë 21.12.2023, “Për miratimin e planit social Bashkia	VKB nr. 18 datë 13.04.2023 “Për miratimin e fillimit të procedurës së privatizimit të ish-	VKB nr. 31 datë 27.06.2023 “Për miratimin e dokumentit të parë të programit	



Bashka Fier	Bashkia Lushnjë	Bashkia Roskovec	Bashkia Patos	Bashkia Mallakastër	Bashkia Divjakë
	Nr. 119 datë 21.12.2022”.	Roskovec, 2024-2026”	zyrave të NFP-së me numër 6/15 pasurie, zona kadastrale 2890, pajisur me certifikatë pronësie me pronar Bashkia Patos”.	buxhetor afatmesëm 2024-2026”.	
VKB nr.66 datë 30.06.2023 “Për miratimin e dokumentit të PBA 2024-2023”	VKB nr. 79 datë 29.09.2023 Mbi një shtesë në buxhetin e vitit 2023 miratuar me VKB Nr. 119 datë 21.12.2022”.	VKB nr. 109, datë 21.12.2023, “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të bashkisë dhe ndërmarrjet variëse të bashkisë për vitin 2024”		VKB nr. 08 datë 21.02.2023 “Për miratimin e Projektit: Rehabilitimi i rrëshqitjeve në rrugën Hekal-Klos-Poçem”	
VKB nr.68 datë 30.06.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime për nivelin e taksave”	VKB nr.80 datë 29.09.2023 Për miratimin e planit të strehimit social vendor 2023-2028”.	VKB nr. 110 datë 21.12.2023“Për miratimin e dokumentit të PBA-së përfundimtare 2024-2026”.			
VKB nr.71 datë 30.06.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime mbi strukturën dhe nivelin e taksave vendore për vitin 2023”	VKB nr. 16, datë 24.2.2023“Mbi një shtesë në buxhetin e vitit 2023 nga të ardhurat e trashëguara”.	VKB nr. 115 datë 21.12.2023, “Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2023”.			
	VKB nr. 19, datë 24.2.2023 “Mbi miratimin e planit të veprimtimit të turizmit në bashkinë Lushnje 2023-2028”				
	VKB nr. 20, datë 24.2.2023 “Mbi miratimin e strategjisë së transportit publik në bashkinë Lushnje 2023-2028”				
	VKB nr. 09, datë 7.2.2023 “Mbi një ndryshim të VKB nr. 119, datë 21.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023				
	VKB nr. 27, datë 24.3.2023 “Mbi miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”.				
	VKB nr. 51, datë 30.6.2023 “Mbi një shtesë në buxhetin e vitit 2023 miratuar me VKB nr. 119, datë 21.12.2022”.				
	VKB nr. 62, datë 31.8.2023 “Për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr. 117, datë 21.12.2022 “Për sistemin e taksave/tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Lushnje dhe penalitetet për kundërvajtje administrative për vitin 2023”				

## **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e procedurave të prokurimit periudhën objekt auditimi (2022 -2023), rezulton se:

- Janë zhvilluar gjithsej 28 procedura me fond limit 10,444 mijë lekë dhe vlerë kontrate 9,822 mijë lekë, për diferencën 621 mijë lekë, *ku sipas periudhave paraqitet si vijon:*

*Për aktivitetin e viti 2022, janë realizuar gjithsej 13 procedura me fond limit 4,682,407 lekë, me vlerë kontrate të lidhur prej 4,365,189 lekë, me një diferencë prej 317,218 lekë.*

*Për aktivitetin e viti 2023, janë realizuar gjithsej 15 procedura me fond limit 5,762,106 lekë, me vlerë kontrate të lidhur prej 5,457,780 lekë, me një diferencë prej 304,326 lekë.*

- Në të gjitha procedurat e prokurimit anëtarët e komisioneve nuk kanë firmosur deklaratat e pavarësisë, në kundërshtim me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Neni 19 “Konflikti i Interesit”.

- Në të gjitha procedurat e prokurimit nuk është evidentuar përllogaritja e fondit limit, sipas përcaktimeve ligjore, pavarësisht fakti se në dosjet e procedurave paraqiten procesverbali i hartimit të fondit limit, por që nuk është dokumentuar mënyra e përllogaritjes.

- Në asnjë rast nuk është bërë inventarizimi i dosjes së prokurimit, në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 19 si dhe me germën (g), të nenit 8. Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara në Njësinë Peqin për vitin 2020 nuk janë lidhur kontratat e shërbimit mes OE të shpallur fitues dhe AK;

- Në procedurën me objekt “Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim” me fond limit 162,500 lekë, ku fitues është shpallur subjekti “N.V” me vlerë kontrate 83,000 lekë, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, në cilësinë e KVO-së ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE në kushtet që nuk kanë përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me Ligjin nr. 160, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 92, pika 3 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 82, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 38-50, të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

**1.1. Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), të marrë masa si vijon:

- Në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, duhet të vlerësojë të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës, ftesën për ofertë apo dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme.

- Me qëllim mundësimin e audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, të marrë masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit, në lidhje me procedurat e prokurimit, si dhe ato që do të zhvillohen në vijim, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në RSH.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të fondit limit deri në 100,000 lekë, rezulton se:

- Dokumentacioni nuk ishte i organizuar në dosje ku të mundësohej inventarizimi i tyre; kërkesa e paraqitur te Sekretari i Përgjithshëm për blerjen e mallrave që i nevojiten njësisë nuk ishte i shoqëruar me dokumentacionin e cilësuar në përmbajtjen e saj. Konkretisht: mungonte testimi i tregut, procesverbali përmbledhës dhe vendimi ku përcaktohet fondi limit i mallrave; deklarata e konfliktit të interesit të anëtarëve të komisionit BVV.

- Urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim nuk ishte pjesë e praktikës; dokumentacioni i OE ku ishte realizuar blerja e mallit apo shërbimit.

- Për mallra/grupmallra dhe shërbime/grupshërbime të njëjta, është konstatuar copëzim të fondeve ku vlera është në tejkallim të vlerës limit 100,000 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 56 pika 11 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimi nr. 4 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, Udhëzimi nr. 05, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në manualin teknik që shoqëron Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 38-50, të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

**2.1. Rekomandimi:** Autoriteti kontraktor (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), të analizojë situatën e krijuar dhe të marrë masa që në të ardhmen, prokurimi me vlerë deri 100,000 lekë, të kryhen sipas kërkesave dhe nevojave të veprimtarisë së saj duke shmangur kostot shtesë që mund të rëndojnë në buxhetin Prefekturës Fierit dhe shmangur procedurën e copëzimit të fondeve.

**Në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës me objekt “Rikonstruksion i godinës së Qarkut Fier” me fond limit 1,498,824 lekë, ku fitues është shpallur subjekti “H.” me vlerë kontrate 1,117,320 lekë, rezulton se nuk është kryer oponenca teknike, në kundërshtim me nenin 6, germa (a) të Ligjit me nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 38-50, të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

**3.1. Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor në bashkëpunim me personat e ngarkuar për menaxhimin e procedurave të prokurimit publik, të marrin masa për të gjitha procedurat që do prokurohen në fushën e investimeve, pavarësisht nga vlera e projektit, të mos vijohet pa marrë më parë miratimin nga institucionet e ngarkuara sipas ligjit për oponencën teknike të investimit.

**Në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA dhe planeve vjetore të buxhetit, rezultoi se:

- Nga Prefekti i Qarkut Fier nuk kanë dalë urdhrat për ngritjen e grupit të punës për hartimin e PBA për çdo fazë të tij, gjë e cila është shoqëruar edhe me mungesën e takimeve për çdo fazë të përgatitjes së PBA-ve, edhe me mos nxjerrjen e urdhrave për ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP).

- Nuk ka të dokumentuar kërkesat për nevojat buxhetore nga secili sektor.

- Ndonëse nga Titullari kanë dalë çdo vit urdhrat për ngritjen e GMS, nga auditimi rezultoi se nuk ka takime të dokumentuara të GMS për të diskutuar mbi tavanet buxhetore dhe nevojave të institucionit për investime.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7 datë 28.02.2018 të MFE "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", Kreu 2 paragrafët 2.3, 2.4, 2.5, 2.6 dhe 2.7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**4.1 Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier në bashkëpunim me Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrin masa për të zbatuar me përpikmëri çdo hap të procedurave të përgatitjes së PBA dhe planit vjetor, për të hartuar plane buxhetore që i përgjigjen nevojave të Institucionit për arritjen e objektivave.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e debisë së krijuar ndër vite në vlerën progresive prej 1,896,257 lekë e 23 debitorëve dhe e deklaruar në instancat përkatëse, rezulton se nga ana e titullarit dhe e GMS nuk janë bërë analizat e duhura për të hartuar plane masash për arkëtimin e debisë së mbartur ndër vite, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin" nenet 8, 9,10, 11, 12 dhe 27, si dhe Manuali mbi MFK miratuar me

Urdhri nr. 54 të Ministrit të Financave me nr. 8980 prot, datë 15.07.2010 i ndryshuar Kreu II, paragrafët 2.2.6, 2.2.7, 2.2.8 dhe 2.2.9; Udhëzimi nr. 21 datë 25.10.2016 "Për nëpunësin zbatues të të gjitha niveleve", Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike".

Nga ana e Prefekturës së Qarkut Fier (sektorët përgjegjës), nuk janë ndjekur hapat administrativë dhe ligjorë për arkëtimin e debitorëve, konkretisht: Me mbylljen e vitit ushtrimor, akt rakordimeve me thesarin, çdo fillim viti nuk është njoftuar Sektori Juridik mbi listën e debitorëve, me qëllim planifikimin vjetor të ndjekjes së procedurave ligjore si dhe nuk janë ndjekur hapat procedurale administrativë dhe më pas ligjorë (sipas rastit) për arkëtimin e detyrimit të mbartur ndër vite, për të cilin ka një paketë të plotë ligjore për të siguruar arkëtimin e detyrimit në favor të Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier, në kundërshtim me Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 "Kodi i Procedurave Administrative në RSH" (i ndryshuar), Kapitulli II (nenet 41-45).

- NJAB e Ministrisë së Brendshme në auditimet e ushtruara në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier, ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur arkëtimin e vlerës debitorë duke transmetuar edhe rrugët që duhet të ndiqte menaxhimi i njësisë publike, por nuk ka analizuar faktin që nga menaxhimi jo vetëm që nuk është arritur asnjë rezultat, por është kërkuar zyrtarisht pamundësia e arkëtimit të vlerës nga debitorët duke i klasifikuar ata si "të pashpresë për arkëtim". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier, në bashkëpunim me Sektorin e Financës e Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektorin Juridik, të analizojnë situatën e krijuar nga debia e akumuluar për një periudhë afro 20 vjeçare me qëllim nxjerrjen e arsyeve të mos arkëtimit të vlerës prej 1,896,257 lekë e 23 debitorëve, personat përgjegjës që nuk kanë ndjekur hapat administrativë dhe ligjorë sipas kuadrit ligjor në fuqi, arkëtimi i të cilës do ndikonte në rritjen e buxhetit të institucionit si e ardhur jotatimore e tij.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacioni mbi verifikimin e masave të programit të emergjencave dhe mbrojtjes civile [EC-MC], u konstatua se:

- Deri në 31.12.2023 *nuk është* hartuar dhe as miratuar Plani i Emergjencave Civile për periudhën 2019 e në vijim mbështetur në Ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 14 pika 5.

- Nga 6 bashki, *rezulton se* vetëm Bashkia Patos nuk ka nisur informacion mbi masat dhe investimet për mbrojtjen civile, kjo referuar shkresave të PQ Fier dërguar Bashkive, Bordit të Kullimit dhe Agjencisë së Zonave të mbrojtura, u kërkohej masat konkrete dhe investimet e kryera për minimizimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore.

- Nga Prefekti i Qarkut Fier, GMS dhe SPPECK nuk janë bërë analiza të detajuara ku të përcaktohen prioritetet për nevojat e AKMC të investimeve emergjente të nevojshme në nivel qarku, me qëllim parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin nga fatkeqësitë.

- Në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 *ka përkeqësim të gjendjes* nga fatkeqësitë natyrore/zjarret në: numrin e rasteve, sipërfaqet e ekonomive pyjore të djegura, sipërfaqet e ullishteve, numrin e pemëve të djegura/ agrume, numrin e mjeteve të djegura.

- Për të dy vitet 2022 - 2023 territori i Bashkisë Fier rezulton të jetë përfshirë me numrin më të lartë të rasteve nga fatkeqësitë natyrore/zjarret dhe me bilancin më të lartë të dëmeve të shkaktuara, të cilat kanë ardhur në rritje, dhe rrjedhimisht me numrin më të lartë të kapaciteteve të angazhuara në operacionet për normalizimin e situatës.

- Nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier nuk ka të dokumentuar asnjë akt të lidhur apo plane masash të miratuara në kuadër të bashkëpunimit apo bashkërendimit të veprimtarisë mes Prefekturës së Qarkut Fier dhe atyre të qarqeve fqinje, kryesisht mbi zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, me qëllim bashkimin e kapaciteteve të tyre për trajtimin e çështjeve të përbashkëta në këtë fushë, në kundërshtim me nenin 28 pika I të Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile".

- Nga ana e strukturave përgjegjëse e mbrojtjes civile në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier, nuk janë zhvilluar kontrole mbi zbatimin e masave të marra nga bashkitë e qarkut për

zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, por mjaftohen vetëm me informacionin që përcillet nëpërmjet takimeve që organizon Prefekti i Qarkut Fier me Komisionin e Mbrojtjes Civile. Gjithashtu nga Prefekti i Qarkut Fier dhe SPPECK *nuk janë hartuar dhe miratuar* plane periodik apo vjetor kontrolli në NJVQV për zbatimin masave të marra prej tyre për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

- Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, lidhur me veprimtaritë kryesore të Sektorit të monitorimit, rezulton se *nuk ka një regjistër* për regjistrimin e raportimeve të kryera, me qëllim ruajtjen e gjurmës së auditimit.

- Nuk janë hartuar dhe miratuar plane pune për forcimin e kapaciteteve institucionale në zbatim të programeve të buxhetit të shtetit, rezultuar kjo nga mungesa e takimeve të GMS.

- *Nuk janë miratuar* plane kontrolli të cilat synojnë marrjen e masave për zbatimin e programit të qeverisë, për ushtrimin e funksioneve dhe plotësimin e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e degës përkatëse në territorin e Qarkut Fier.

- *Nuk janë paraqitur* mendime ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore mbi projekte të ndryshme për zhvillimin e territorit të qarkut për përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve dhe sigurinë, sepse sipas tyre nuk është kërkuar, në kundërshtim të Ligjit nr. 107/2016 “*Për Prefektin e Qarkut*” neni 10 pika b.

Të gjitha kërkesë – ankesat e paraqitura pranë institucionit të Prefektit të Qarkut u janë adresuar institucioneve përgjegjëse. Por konstatohet se nuk ka një praktikë të ndjekur deri tani, që Institucionet të cilave iu është adresuar zgjidhja e problemit të qytetarit/ve të ketë vënë në dijeni PQ Fier mbi vijueshmërinë e procedurës dhe statusin e problemit të adresuar për zgjidhje. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1. Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier, Sektori i Planifikimit, Parandalimit të Emergjencave Civile dhe Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe funksioneve të deleguara, të analizojnë me vëmendje të shtuar bilancet e viteve të fundit nga fatkeqësitë natyrore për të përcaktuar arsyet dhe strukturat përgjegjëse që me veprimet joefektive apo mosveprimet e tyre kanë çuar në përkeqësimin e situatës.

- Komisioni i Mbrojtjes Civile të realizojë takime me ekspertë të fushës së mbrojtjes civile dhe jo vetëm, me qëllim analizimin e detajuar të situatave të përvitshme të krijuara nga fatkeqësitë natyrore/zjarret për hartimin e planit të masave (afatmesëm) gjithëpërfshirës mbi bazën e specifikave territoriale dhe kapaciteteve të disponueshme, për parandalimin, normalizimin dhe monitorimin e situatave të krijuara nga fatkeqësitë natyrore, për një shërbim sa më efektiv institucional në dobi të komunitetit.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në procedurën e inventarizimit të aktiveve në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier, rezulton se:

- Kryetari i komisionit për dy vite radhazi (2022-2023) është caktuar i njëjti person, në kundërshtim me Udhëzimit 30/2011 datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*” pikat 84;

- Urdhrat e miratuar nga Prefekti nuk kanë të përcaktuar afatin kohor që duhet të realizohet procedura e inventarizimit të aktiveve të PQ Fier, duke rrisur për zvarritje të procedurës;

- Nuk ka të miratuar Rregullore të unifikuar “Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve (*inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve*), në kundërshtim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 6,7,8,9 dhe 17,18,19;

- Mungesa e specialistit të fushës në evidentimin e artikujve të vlerësuar për jashtë përdorimit, kryesisht të pajisjeve elektronike, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*”, Kreu IV pika 95-106;

- Në Urdhrat e Brendshëm të Titullarit për ngritjen e GMS, *nuk është* caktuar Koordinatori i Riskut dhe Koordinatori MFK, referuar Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, neni 8;

- *Nuk janë hartuar* grafikët e takimeve vjetore të GMS dhe rrjedhimisht nuk ka as dokumentim të takimeve të realizuara gjatë viteve 2022 e 2023, në moszbatim të ligjit nr. 10296/2010 “Për

Menaxhimin Financiar dhe kontrollin” dhe Manualit MFK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier në bashkëpunim me Sektorin e Financës dhe Sektorin Juridik, të marrin masa për:

- Të zbatuar të gjitha hallkat e procedurës së inventarizimit të aktiveve të njësisë, kryesisht atë të nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjesisimit të atyre të amortizuara sipas kuadrit ligjor në fuqi;
- Miratimin e një strategjie dhe Rregulloreje të unifikuar institucionale për menaxhimin e aktiveve, risqeve që ato mbartin dhe për minimizimin e tyre, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi;
- Ngritjen e një grupi pune me ekspertë të fushës për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të atyre aktiveve (të llog. 218 “inventar ekonomik dhe llog. 218/1 “pajisje kompjuterike”), vlera e mbetur e të cilave është e papërfillshme por që janë në gjendje pune;
- Nisjen e procedurave të ri/vlerësimit të aktiveve (llog.210 “toka troje e terrene” dhe llog.212 “godina e konstruksione”) në ASHK Rajonale Fier, për të mundësuar regjistrimin në kontabilitet me vlerë reale të tyre.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi strukturën organizative, organikën dhe zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës, për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2023, rezulton se:

- Formularët e përshkrimit të pozicioneve të punës nuk kanë përfshirë nënrubrikën për kriteret e përgjithshme/formimin arsimor e profesional/vjetërsinë e çdo pozicioni, në kundërshtim me VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar, Lidhja 3; Udhëzimi nr. 01 datë 31.05.2017 i DAP “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në Shërbimin Civil”;
- Për pozicionet marrëdhëniet e punës të të cilave rregullohen me Kod Pune, rezultoi se nuk dërgohet shpallja e vendit vakant në Shërbimin Kombëtar të Punësimit/Portali i punësimit, në moszbatim të Ligjit nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 19 pika 2;
- Nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut Fier janë paraqitur kërkesa verbale në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të MB dhe janë parashikuar në PBA, mbi nevojat e institucionit për shtim të një pozicionit të specialistit IT dhe punësimit të dy punonjësve me kontratë të përkohshme (3 mujore) për shërbimet e arkivës. Këto kërkesa duhet të bëhen prezente në shkresën e nevojave për rekrutim që nga SFSHM/PQ Fier dërgohen çdo fundviti në Ministrinë e Brendshme me kërkesë të saj. Ato duhet të përmbajnë: argumentimet për çdo pozicion shtesë, klasifikimin e vendeve të punës, numri i punonjësve për pozicion, klasifikimin e pagës.
- Ndryshimet e personelit në pozicione brenda të njëjtës sektor apo nga një sektor në tjetrin, nuk është shoqëruar me krijimin e një praktike të re me dokumentacion të përditësuar dhe të sistemuar në fashikull, edhe pse i përkasin të njëjtës dosje personeli. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa për:

- Plotësimin menjëherë të vendeve vakante për zhvillim normal dhe me efektivitet të aktivitetit të institucionit të Prefektit të Qarkut Fier për arritjen e objektivave në dobi të komunitetit.
- Plotësimin e Formularit të përshkrimit të pozicioneve të punës me kriteret e domosdoshme të punësimit, plotësimin e Planit vjetor të punësimit sipas nevojave të institucionit, hartimin e një plani vjetor trajnimesh. Përditësimin dhe sistemimin e dokumentacionit në dosjet e personelit, dhënie përparësi punësimit të personave të grupit të veçantë në vendet vakante apo pozicione të tjera të përshtatshme në strukturë dhe shpalljen e vendeve vakante të pozicioneve me kod pune në AKPA, për të prezantuar një institucion gjithëpërfshirës dhe me qasje cilësore e të besueshme në komunitet.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën 2022-2023 nga bashkitë dhe Këshilli i Qarkut Fier i janë përcjellë Prefektit një total prej 245 vendime, për të cilat rezulton se 234 vendime janë konfirmuar në përputhje me kuadrin rregullator, ndërsa 11 vendime janë konstatuar në kundërshtim me kuadrin ligjor, ku për 1 vendim është ngritur padi në Gjykatën Administrative të Apelit.

Bashkitë nga ana e tyre nuk i përcjellin informacion Prefektit të Qarkut Fier mbi aktet e rishqyrtuara, pas kthim përgjigjes për mos konfirmim nga Prefekti. Si pasojë, për periudhën 2022-2023, Prefekti nuk administron një evidencë mbi statusin e rishqyrtimit për aktet e kthyera si në kundërshtim me ligjin, sipas nenit 16 pika (ii) të ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier të marrë masa që të përfshijë në programet e punës për verifikimet në vend të aktet të këshillave bashkiakë si pikë të veçantë kontrollin për aktet e kthyera në kundërshtim me ligjin, për të vlerësuar nëse janë marrë masa për anulimin apo ndryshimin e tyre, me qëllim krijimin e një evidence të plotë dhe të saktë mbi aktet e rishqyrtuara nga këshillat bashkiakë.

**Në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se për VKB nr. 30 datë 25.07.2022 “Për miratimin e akordimit të fondit të kushtëzuar për vitin 2022, në shumën 8,821,291 lekë (në masën 100 % të fondit) për familjet e banesave të cilat janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera”, të Bashkisë Divjakë, Prefekti i Qarku është shprehur se akti është në përputhje me kuadrin rregullator, kjo në mungesë të dokumentacionit bashkëshoqërues për çështjet se çfarë emergjence civile apo fatkeqësie natyrore/tjetër ka ndodhur në Bashkinë Divjakë, pasi nuk identifikohen nëse janë bërë ose jo vlerësimet e dëmeve, sikurse parashikohen në VKM nr. 414/2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, pika 3-3.1, germa (a), vendim i cili duhej kthyer nga Prefekti në kundërshtim me kuadrin rregullator. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1. Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier, për vlerësimin e vendimeve të këshillave bashkiakë për përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile, me objekt akordimin e ndihmave për banesa të dëmtuara nga fatkeqësi natyrore/të tjera, të kërkojë nga bashkitë dorëzimin e një relacioni gjithëpërfshirës dhe shterues ku të pasqyrohet qartë fatkeqësia e ndodhur dhe procedura e ndjekur nga bashkia për evidentimin e banesave të dëmtuara dhe shumat përkatëse që përfiton secila familje.

**Në vijimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në **3 raste**, në lidhje me përdorimin e fondit të emergjencave civile për blerje makinerie, rezulton se Prefekti Qarkut Fier, duhet të kishte kthyer si në kundërshtim me kuadrin ligjor, konkretisht:

-Prefekti i Qarkut Fier ka konfirmuar ligjshmërinë e Vendimit nr. 71 datë 08.08.2022 të KB Fier “Për shpërndarjen dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile për vitin 2022”, ku është miratuar blerja e mjetit tip autovinç me vlerë 6,000,000 lekë. Për kohën e vendimmarrjes është jashtë objektit të VKM nr. 414/2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”. Referuar faktit se një parashikim i tillë është bërë në muajin Maj të vitit 2023, me VKM nr. 290, datë 17.5.2023. Prefekti i Qarkut Fier duhet ta kishte kthyer si në kundërshtim me kuadrin rregullator VKB nr. 71 datë 08.08.2022, vetëm për pikën 2 të investimit për blerje autovinçi.

Gjithashtu, Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar ligjshmërinë e Vendimit nr. 67 datë 30.06.2023 të KB Fier “Për shpërndarjen dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile” për përdorimin e fondit prej 15,302,826 lekë për blerje mjeti teknologjik “skrep me goma” si dhe Vendimin nr. 75 datë 29.9.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për

emergjencat civile 2023”, të KB Lushnjë për blerjen e një mjeti zjarrfikës në shumën 6,000,000 lekë.

Këto investime nuk përputhen me përshkrimin e vendosur në shkresën nr. 86/6 datë 27.03.2023 të Agjencisë Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), e cila u ka kërkuar bashkive ndarjen e fondeve sipas kodit të produktit “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve edhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e njerëzve”, ku nuk përcaktohet blerja e makinerive. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier të marrë masa që t’i kërkojë zyrtarisht Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile konfirmimin nëse kodet e produkteve për fondin e emergjencave mundësojnë përfshirjen e shpenzimeve për blerje makinerie, për rastet e konfirmimit të vendimeve për emergjencat civile dhe ne vijim të mos miratohet ligjshmëria e vendimmarrjeve, në rastet për të cilat ato investime nuk përfshihen në kodet e miratuara.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se, Prefekti i Qarkut Fier ka shprehur dy qëndrime të ndryshme, duke e refuzuar dhe e miratuar më pas. Në rastin konkret, VKM nr. 414/2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, e lejon bashkinë që të kryejë investim, përmes germës (b) dhe Prefekti duhet ta kishte miratuar VKB fillestare vetëm me shënim për korrigjimin e referencës, *respektivisht*, ka konfirmuar ligjshmërinë e Vendimit nr. 39 datë 24.07.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për ndërhyrjen e menjëhershme në pronën publike, shkolla Hajredin Fratarit”, por me shënimin se përdorimi i fondit duhet t’i përmbahet pikës 3.1, germa (c) të VKM nr. 414/2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, si dhe ka kthyer si në kundërshtim me ligjin VKB nr. 30 datë 27.06.2023 me të njëjtin objekt. Prefekti i Qarkut ka arsyetuar se baza ligjore ku është mbështetur vendimi është vendosur në interpretim të gabuar, konkretisht për shkak se kriteri “shërbim” që kërkon pika 3.1 germa (c) nuk përputhet me atë çka Këshilli Bashkiak ka vendosur, që përbën “investim”. Sikurse konstatohet, VKB nr. 39 dhe VKB nr. 30 janë në thelb të njëjta, me të njëjtën bazë ligjore dhe me të njëjtën objekt sipas relacionit, por që nga Prefekti janë mbajtur 2 qëndrime të ndryshme. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier të marrë masa për të krijuar një vendimmarrje të unifikuar lidhur me verifikimin e ligjshmërisë për përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat. Në rast se konstatohen lapsuse apo referime të gabuara në bazën ligjore, në nenin, pikën apo germën të konfirmojë aktin duke i vënë në dukje bashkisë pasaktësinë e konstatuar.

**Në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se, Prefekti i Qarkut Fier ka verifikuar dhe ka konfirmuar ligjshmërinë e Vendimit nr. 54 datë 08.06.2022 të Këshillit të Bashkisë Fier “Për përcaktimin e procedurës për negociim me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me Bashkinë e Fierit nëpërmjet marrëveshjes për pronat në pronësi të saj”.

Objekti i VKB nr.54 datë 08.06.2022 ka specifikën që ka krijuar një procedurë standarde që i përket formës së Partneritet Publik Privat dhe e vetmja bazë ligjore që përcakton përdorimin e formatit të bashkëpunimit me PPP për bashkitë është Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social” neni 52, pika 2.

Referuar pikës 3, procedura e përzgjedhjes, mënyra e kontraktimit, forma dhe kushtet e përgjithshme të kontratës për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, vendim që nuk është miratuar. Në këto kushte, Prefekti i Qarkut Fier duhet ta kishte kthyer VKB nr. 54 datë 08.06.2022 për mungesë të referencës së bazës ligjore që i atribuon bashkisë të drejtën të përcaktojë me VKB procedurat dhe kriteret për përdorimin e formatit PPP të bashkëpunimit mes privatit dhe Bashkisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



**13.1. Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier të marrë masa që për vendimmarrje me objekt të ngjashëm t'i konsiderojë si jo në përputhje me kuadrin rregullator, derisa të qartësohet me Vendim të Këshillit të Ministrave atributi dhe tagri ligjor i bashkive për të vendosur për përcaktimin e procedurës për negociim me zhvilluesit privatë që shprehin interesin për pasuritë e paluajtshme në pronësi të tyre.

Në vijimësi

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se, Prefekti i Qarkut Fier e ka konsideruar si të pabazuar në ligj Vendimin nr.21 datë 29.03.2022 të Këshillit Bashkiak Roskovec “Për një shtesë në vendimin Nr. 93, datë 25.11.2021 ‘Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022’” dhe ka ngritur padi në Gjykatën Administrative të Apelit, duke kërkuar pavlefshmërinë e tij. Përmes VKB përkatëse, Këshilli Bashkiak Roskovec ka vendosur të miratojë tarifën për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit për subjektet “B.Albania”, “Albetrol” sh.a, çdo kompani në fushën e transportimit, karburante, gomisteri dhe fabrikat e përpunimit të ullirit, qumështit dhe drithërave.

Në argumentimin e Prefektit të Qarkut është arsyetuar se, vendimi është shumë larg qëllimit të ligjit por është shumë afër qëllimit të bashkisë. Ligji ka përcaktuar se niveli i tarifës orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Pra kryefjala e ligjit, sipas Prefektit, në këtë rast është shërbimi i ofruar dhe se Bashkia Roskovec nuk ofron shërbime për të vendosur këtë tarifë.

Në vlerësimin e bazueshmërisë në prova dhe ligj të kërkesë padisë, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se kërkesa e paraqitur nga pala paditëse (Prefekti i Qarkut Fier) është e pabazuar në ligj dhe në prova. Në arsyetimin, ndër të tjera, theksohet se “vendosja nga pala e paditur e tarifës për përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit jo vetëm që është përgjegjësi dhe kompetencë kushtetuese ligjore, por edhe procedura e ndjekur, të dhënat dhe argumentet ku mbështet vendosja e kësaj tarife justifikojnë plotësisht përmbushjen e qëllimit kushtetues e ligjor për të mbrojtur dhe përmirësuar mjedisit.... Pra, Gjykata Administrative e Apelit ka rrëzuar padinë e Prefektit të Qarkut Fier...”. Për këtë çështje, përmes Avokaturës së Shtetit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier të marrë masa që deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata e Lartë, për ngritjen e padisë në fushën e tarifave dhe taksave, të shqyrtojë vetëm përputhshmërinë ligjore nëse bashkitë kanë kompetencë ligjore për vendosjen e një tarifë, pa u shtrirë në argumentime mbi ofrimin apo jo të shërbimit, të cilat shtrihen përtej tagrit të kompetencave të Prefektit.

Në vijimësi

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se, Prefekti i Qarkut Fier ka kthyer si në kundërshtim me ligjin Vendimin e Këshillit Bashkiak Roskovec nr. 83 datë 31.10.2022 “Për miratim fondesh dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencave civile për vitin 2022”, me qëllim rikonstruksionin e çatisë së shkollës “Alush Grepçka”. Prefekti i Qarkut Fier e ka interpretuar aktin përkatës të investimit si jo në përputhje me qëllimin e masave parandaluese, duke arritur në konkluzionin se ky dëmtim “nuk sjell cenim të objektit infrastrukturë deri në atë pikë që të bëjë kërcënim serioz për jetën e nxënësve”. Ky konkludim nga Prefekti nuk bazohet në ndonjë akt ekspertize, por vetëm në interpretimin që i është bërë relacionit të hartuar nga Bashkia Roskovec dhe i përket sferës së trajtimit nga institucione të tjera që kanë tagrin dhe ekspertizën për të shprehur lidhur me rrezikshmërinë apo qëndrueshmërinë e objekteve. Për këtë qëllim, Prefekti i Qarkut Fier duhet t'i përmbahej parashikimeve dhe kushteve të VKM nr. 414/2021, por në rast se e gjykonte të nevojshme për mirënxhimin e fondit të kushtëzuar, duhet t'i kërkonte bashkisë që të kryente një akt-ekspertize mbi rrezikshmërinë e objekteve të amortizuara. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1. Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier, në bashkëpunim me bashkitë, për rastet kur vëren se përdorimi i investimit është jashtë sferës së kritereve dhe qëllimit të fondit të emergjencave civile si masë parandaluese, të ngrejë një grup pune për verifikimin e situatës në terren ose të

kërkojë një akt ekspertize nga bashkitë me qëllim që vendimmarrja e tij të bazohet në konkluzionet e këtij grupi pune.

**Në vijimësi**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i ligjshmërisë nga Prefekti i vendimeve të këshillave bashkiakë për përditësimin e inventarit të pronave, 3 raste rezultuan se:

-Për VKB nr. 35 datë 20.03.2023 të Bashkisë Fier *“Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Fier, për njësinë administrative Levan”*, ka një mospërputhje në sipërfaqe mes pasurive të përditësuar të bashkisë dhe statusit juridik të konfirmuar nga ASHK, formulari i përditësimit nuk është plotësisht sipas formatit standard, pasi mungojnë të dhënat mbi faktin e inventarizimit apo jo të pasurive përkatëse me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas pikës 1, germa ( dh) të VKM nr. 28, datë 27.1.2023 *“Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”*.

-Për VKB nr. 133 datë 21.12.2023 të Bashkisë Roskovec *“Për përditësim në listën e inventarit, miratuar me VKM-në nr. 108, datë 17.02.2010”*, me qëllim që inventarit t’i shtohen dy godina Bashkia Roskovec disponon certifikatë pronësie me datë lëshimi 21.02.2023, ku rezulton sipërfaqja 8970 m<sup>2</sup> truall, pa sipërfaqe ndërtese. Si rrjedhojë, inventari duhet të përditësohet sipas certifikatës së pronësisë dhe jo anasjelltas, sikurse përcaktohet në pikën 2, të VKM nr. 28/2023.

- Për Vendimin nr. 30 datë 24.03.2023 të Këshillit Bashkiak Lushnjë *“Mbi përditësimin e inventarit të miratuar me VKM nr.175 datë 06.03.2012”*, është ndryshuar zëri kadastral i pasurisë nr.17/122 me sipërfaqe 75 m<sup>2</sup> nga “rrugë” në “truall publik”, në kuadër të korrespondencës me DVASHK Lushnjë, e cila thekson se gjatë procedurave të legalizimit për dy objekte informale, kjo sipërfaqe përdoret si oborr i objekteve përkatëse dhe se sipas planshetës së vitit 1982 nuk ka qenë pasuri e llojit “rrugë.”

Në VKM nr. 28/2023 nuk përcaktohet qartë kompetenca e bashkive për të ndryshuar zërin kadastral, po ashtu nuk është miratuar përditësimi i pasurisë përkatëse me qëllim regjistrimin si pronë e bashkisë, por është ndryshuar zëri kadastral me qëllim kalimin e kësaj sipërfaqeje si truall funksional për objektin e legalizuar. Në rastin konkret, meqenëse kjo pasuri është pjesë e proceseve kalimtare të pronësisë, sipas shkronjës (ç) të pikës 1 të VKM nr.28/2023 dhe nëse nga gjendja faktike e konstatuar nga DVASHK Lushnjë rezulton se nuk është “rrugë”, me miratimin e legalizimit kjo pronë i hiqet inventarit të bashkisë.

Prefekti, në zbatim të pikës shkronjës (c), pikës 6 kreu II, duhej propozuar revokimi i pronësisë sipas parashikimit të nenit 8/a, të Ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, *“Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”*, i ndryshuar, për aq sa kjo sipërfaqe është në përputhje me kriteret e legalizimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1. Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier të marrë masa që për vendime të këshillave bashkiakë me objekt përditësim inventari të pronave të kërkojë nga bashkitë dorëzimin e një relacioni shterues, ku të konfirmohet statusi i pronave sipas gjendjes juridike të ASHK-së, të argumentohen arsyet e diferencave në sipërfaqe si dhe të evidentohen nëse prona e inventarizuar është objekt i proceseve kalimtare të pronësisë.

**Në vijimësi**

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se, në 2 raste, Prefekti i Qarkut Fier nuk ka bërë një vlerësim nëse vendimet e këshillave bashkiakë janë në përputhje me Vendimin nr.9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ *“Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”*, konkretisht si vijon:

- Me Vendimin nr. 6 datë 27.01.2023, Këshilli Bashkiak Roskovec ka miratuar një shtesë fondi prej 10,000,000 lekësh me objekt *“kontribut për investime në banesat sociale”*, duke pakësuar të njëjtën vlerë për projekte të tjera. Konkretisht, sipas nenit 3 germa (b) të këtij vendimi

normativ të Komisionit Rregullator, janë veprimtari të ndaluara për t'u promovuar ato veprimtari publike për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor në periudhën 4 mujore para datës së zgjedhjeve që përfshin mbështetjen dhe promovimin e projekteve/investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik në shërbim të interesit publik”.

- Me Vendimin nr. 20 datë 10.05.2023 “*Për miratimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencave civile*”, 10 ditë para zgjedhjeve Këshilli Bashkiak Divjakë ka miratuar përdorimin e vlerës prej 3,031,728 lekë për rehabilitimin e katër urave për kalimin e këmbësorëve, mjeteve të qarkullimit rrugor, duke e konsideruar edhe si ndërhyrje urgjente Me VKB nr.46 datë 22.09.2023, Këshilli Bashkiak i Divjakë e ka shfuqizuar VKB nr.20 datë 10.05.2023, ku kërkonte ndërhyrje me statusi “urgjent” për rehabilitimin e urave, duke i rialokuar këto fonde në një projekt tjetër për emergjencat civile. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1. Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier të marrë masa që për periudhën 4 muaj para zgjedhjeve, si dhe gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, të përfshijë si kriter vlerësimi të ligjshmërisë përcaktimet e Vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ me qëllim shmangien e vendimmarrjeve që bien ndesh me këto përcaktime, përgjatë periudhave zgjedhore.

**Në vijimësi**

**18. Gjetje nga auditimit:** Prefekti i Qarkut Fier ka konfirmuar ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec nr. 8 datë 27.01.2023 “*Për një ndryshim në VKB nr.47 datë 17.05.2023 “Për miratimin e planit social të bashkisë Roskovec 2019-2023”*”. Përmes këtij vendimi, Bashkia Roskovec ka shtyrë me një vit zbatimin e Planit Social të bashkisë.

Vendimi nuk është në përputhje me VKM nr. 150, datë 20.3.2019 “*Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror*”, pika 10 ku përcakton se Këshilli Bashkiak miraton planin social trevjeçar të buxhetuar, si dhe kërkesën për financim (fonde) nga buxheti i shtetit, brenda muajit shkurt të çdo viti, për atë pjesë të planit që mbetet i pambështetur nga buxheti i bashkisë”. Sikurse rezulton, plani social është tre vjeçar dhe është i lidhur ngushtësisht me buxhetin e viteve përkatëse, çka nënkupton se ligji nuk parashikon shtyrje të këtij plani, për një vit buxhetor që nuk është përfshirë në planin 3 vjeçar. Si pasojë, Prefekti i Qarkut Fier duhet ta kishte kthyer VKB nr.47 datë 17.05.2023 si jo në përputhje me kuadrin rregullator. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1. Rekomandimi:** Prefekti i Qarkut Fier për rastet e verifikimit të ligjshmërisë të vendimeve të këshillave bashkiakë që kanë si objekt shtyrjen e afateve të planeve sociale të kërkojë një argumentim buxhetor nëse shtyrja e planit social në kohë mbulohet dhe parashikohet nga buxheti pasardhës, në të kundërt t’i konsiderojë këto vendime si në kundërshtim me kuadrin rregullator.

**Në vijimësi**

## **B. MASA DISIPLINORE.**

Mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neneve, 57, 58, 59 të Ligjit nr. 152/2013 datë 17.10.2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Kreut II, pika 2 të VKM nr. 115 datë 05.03.2015 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*”, të ndryshuar, **i rekomandojmë Prefektit të Qarkut Fier**, të vlerësojë shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2023, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave, për **6 (gjashtë)** punonjësit, si më poshtë:

**a) *Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, germa (c) neni 58.***

1. **A.V**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm.
2. **A.GJ**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Juridik.
3. **K.Y**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave.
4. **D.S**, me detyrë specialist i Sektorit Juridik.
5. **R.B**, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Zhvillimit Urban.
6. **P.F**, me detyrë specialist Sektori Juridik.

Për mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative dhe mungesës së administrimit të dokumentacionit tekniko-ligjor për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në kundërshtim me germën (a) neni 8 dhe neni 16 të Ligjit nr. 107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin”, trajtuara gjerësisht në faqet 50-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**B/1.** Për të gjithë punonjësit e tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i të Auditimit, dhe **lihet në kompetencë të Prefektit të Qarkut Fier**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

## V. ANEKSE.

### Aneksi nr. 1

#### - Materialiteti dhe faktorët e riskut për subjektin Prefektura Qarku Fier.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 1% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka ulur gamën e gabimeve për tu konsideruar, duke marrë në konsideratë prapenjë të materialitetit prej 1%, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe verifikimin e tyre me evidencat periodike me Thesarin, si dhe dokumentacionin shoqërues (praktikën e urdhër transfertave).

Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (trajtuar gjerësisht në pikën e programit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin); dhe
- teste të detajeve.

Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- ✓ Risku i lidhur me shpenzimin specifik, nga ku nën gjykimin profesional të audituesit niveli i riskut për shpenzime që lidhen me llogaritë u vlerësua nga 0.7 deri 2; dhe
- ✓ Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditim, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përlllogaritjes si më poshtë:

Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
<i>Paga (600)</i>	30,101	0.70	30
<i>Sigurime Shoqërore (601)</i>	4,990	0.70	5
<i>Mallra e Shërbime (602)</i>	5,970	0.70	6
<i>Subvencione (603)</i>		0.60	0
<i>Princila + Interesa</i>		0.60	0
<i>Investime të brend. (230-231)</i>	1,799	2.00	5
<i>Te tjera transfer. korren (604)</i>	84	0.70	0
<b>Total</b>	<b>42,944</b>		
<i>Materialiteti në %</i>	2%		
<b>Materialiteti në vlerë</b>	<b>859</b>		
<i>Kalkulimi i precizionit</i>			
<b>Materialiteti</b>	<b>859</b>		
<i>Gabimi i lejuar (10% - 20%)</i>	86		
<b>Nëntotali</b>	<b>773</b>		
<i>Precizioni i planifikuar (80-90%)</i>	90%		
<b>Vlera e precizionit</b>	<b>696</b>		

## Aneksi 2.1

Të dhëna mbi komisionet e inventarizimit.

Viti	Anëtarët e Komisioneve	Objekt Inventarizimi	Nr. Anëtare	Vlerësimi zbatimin/statusi	mbi
2022 I	Komisioni i Inventarit Fizik dhe i Vlerësimit paraprak të Aktiveve				
•	Kryetari i Komisionit	PQ Fier	1	UB. 1098, dt.21.10.2022	
	E.S				
	Anëtarët e Komisionit	Aktivët e Institucionit	2	Realizuar	
	A.GJ				
	L.S				
II	Komisioni i Vlerësimit të Aktiveve të dëmtuara				
•	Kryetari i Komisionit		1	UB 1099, dt. 21.10.2022	
	S.Ç				
	Anëtarët e Komisionit		2	Realizuar	
	E.S				
	L.GJ				
	LL				
	E.H				
III-IV	Komisioni për Nxjerrje Jashtë Përdorimit & Komisioni për Ekzekutim/asgjesim të Aktiveve				
	Nuk ka			Nuk ka	
2023 I	Komisioni i Inventarit Fizik dhe i Vlerësimit paraprak të Aktiveve				
•	Kryetari i Komisionit	Aktivët e Institucionit	1	UB 28, dt. 11.01.2023	
	E.S				
	Anëtarët e Komisionit		2	Realizuar	
	I.M				
	E.S				
II	Komisioni për Vlerësimin përfundimtar të aktiveve /të dëmtuara				
•	Kryetari i Komisionit		1	UB 29, Dt. 11.01.2023	
	S.Ç				
	Anëtarët e Komisionit		4	Realizuar	
	K.Y				
	E.GJ				
	H.R				
	A.A				
III-IV	Komisioni për Nxjerrje Jashtë Përdorimit & Komisioni për Ekzekutim/asgjesim të Aktiveve				

Viti	Anëtarët e Komisioneve	Objekt Inventarizimi	Nr. Anëtare	Vlerësimi zbatimin/statusi	mbi
2022 I	Komisioni i Inventarit Fizik dhe i Vlerësimit paraprak të Aktiveve				
	Nuk ka				Nuk ka

Burimi: PQ Fier/Punoi: Grupi i auditimit

## Aneksi 2.2

### VITI 2022

Informacioni i humbjeve nga fatkeqësitë natyrore në Prefekturën e Qarkut Fier - Viti 2022															
Bashki	Nr	Ek.pyjore			Ullishte/agrumë				Sip Dierr		Ndërtesa		Depo Bari		Auto mjet
		Nr	Sip/ha	Sip djeg	Nr	Sip/ha	Rrenj djeg	Ag rm/ha	Nr	Sip/ha	Banim	Publ/bizn	nr	Sasi/dëng	Nr
Fier	79	4	14	6.2	21		3778		24	41.46	25	3	2	4300	0
Lushnje	56	1	3		17	1.5	4795	2	29	296.2	8		1	1200	0
Mallakastër	24		1		3	7.5	403		16	30.9	3		1	50	1
Divjakë	10	1	2		1		600		6	59.1	1		1	1000	
Patos	18	1	0.4		5		838		7	42.8	5			-	
Roskovec	23	1		3			200		13	35.9	5		2	980	2
ADZM															
<b>Totali</b>	<b>210</b>	<b>8</b>	<b>20.4</b>	<b>9.2</b>	<b>47</b>	<b>9</b>	<b>10614</b>		<b>95</b>	<b>506.4</b>	<b>47</b>	<b>3</b>	<b>7</b>	<b>7530</b>	<b>3</b>

Burimi: SPPECK PQF/Punoi: Grupi i auditimit

Informacioni i humbjeve nga fatkeqësitë natyrore në Prefekturën e Qarkut Fier - Viti 2023															
Bashki	Nr	Ek.pyjore			Ullishte/agrumë				Sip Dierr		Ndërtesa		Depo Bari		Auto mjet
		Nr	Sip/ha	Sip Djeg/	Nr	Sip/ha	Rrenj djeg	Ag rm/ha	Nr	Sip/ha	Banim	Publ/biznesi	nr	Sasi dëngje	Nr
Fier	63														
Lushnje	52														
Mallakastër	13														
Divjakë	27														
Patos	31														
Roskovec	27														
ADZM	-														
<b>Totali</b>	<b>213</b>				<b>1045</b>		<b>8871</b>		<b>-</b>		<b>24</b>	<b>3</b>	<b>9</b>	<b>2270</b>	<b>1</b>

Burimi: SPPECK PQF/Punoi: Grupi i auditimit

## Aneksi 2.3

### VITI 2023

Informacion për vitin 2022							
Bashkite	F.zjarrfikese	M.zjarr	F.Polic	Forc.Armat	F.Bashki	Forc.Vullnet	Sh.pyj/ADZM
Fier	101	419	82	3	161	414	5
Lushnje	67	318	88	0	129	486	6
Mallakastër	27	141	13	0	18	74	15
Divjakë	13	45	25	3	7	31	33
Patos	43	214	62	2	53	0	9
Roskovec	28	107	27	0	0	13	17
ADZM							
<b>Totali</b>	<b>279</b>	<b>1244</b>	<b>297</b>	<b>8</b>	<b>368</b>	<b>1018</b>	<b>85</b>

Informacion për vitin 2023							
Bashkite	F.zjarrfikese	M.zjarr	F.Polic	Forc.Armat	F.Bashki	Forc.Vullnet	Sh.pyj/ADZM
Fier							
Lushnje							
Mallakastër							
Divjakë							
Patos							
Roskovec							
ADZM							
<b>Totali</b>	<b>Nuk ka</b>	<b>Nuk ka</b>	<b>Nuk ka</b>	<b>Nuk ka</b>	<b>Nuk ka</b>	<b>Nuk ka</b>	<b>Nuk ka</b>

Burimi: SPPECK/PQ Fier

## Aneksi 2.4

**Konfirmimet me ligjshmerinë të VKB-ve të miratuara nga Këshillat Bashkikë të 6 Bashkive:  
Fier, Divjakë, Lushnje, Mallakastër, Patos, Roskovec.**

<b>Prefekti i Qarkut Fier - viti 2022</b>						
Emërtimi	VKB	Buxheti total miratuar	Planifikim i fondeve për EC	Vlera e fondit të planifikuar		Konfirmimi nga PQF
				Kap 1	Kap 5	
Bashkia Fier	Nr. 96 dt. 07.12.2021 Nr. 11193/2 prot., dt. 07.12.2021	2,069,911,648	PO	49,231,000	40,060,000	Nr. 1509/1 prot., dt. 22.12.2021 (konfirmuar)
				<b>89,291,000</b>		
Bashkia Lushnje	Nr. 101 dt. 23.12.2021 Nr. 9679/2 prot., dt. 24.12.2021	1,345,193,000	PO	-	26,910,760	Nr. 1549/1 prot., dt. 30.12.2021 (konfirmuar)
				<b>26,910,760</b>		
Bashkia Patos	Nr. 71 dt. 14.12.2021 nr. 3061/2 prot., dt. 17.12.2021	505,762,000	PO	2,298,000	210,000	Nr. 1518/1 prot., dt. 23.12.2021 (konfirmuar)
				<b>2,508,000</b>		
Bashkia Mallakastër	Nr. 58 dt. 20.12.2021 Nr. 4368 prot., dt.21.12.2021	1,018,299,752	PO	17,263,937	-	Nr. 1543/1 prot., dt. 30.12.2021 (konfirmuar)
				<b>17,263,937</b>		
Bashkia Roskovec		600,979,622	PO	69,010,134	2,500,000	konfirmuar
				<b>71,510,134</b>		
Bashkia Divjakë	Nr. 69 dt. 28.12.2021 Nr. 5124 prot., dt. 28.12.2021	625,111,849	PO	18,753,000	6,300,000	Nr. 13/1 prot., dt. 12.01.2022 (konfirmuar)
				<b>25,053,000</b>		
<b>Totali</b>	<b>6</b>		√			√

<b>Prefekti i Qarkut Fier - viti 2023</b>						
Emërtimi	VKB	Buxheti total miratuar	Planifikim i fondeve për EC	vlera e fondit të planifikuar		Konfirmimi nga PQF
				Kap 1	Kap 5	
Bashkia Fier	Nr. 122 dt. 14.12.2022 Nr. 10664/1 prot., dt. 06.12.2022	2,212,847,000	PO			Nr. 1314/1 prot., dt. 28.12.2022 (konfirmuar)
				<b>30,980,000</b>		
Bashkia Lushnje	Nr. 103 dt. 23.12.2021 Nr. 9679/2 prot., dt. 24.12.2021	1,526,521,323	PO			Nr. 1549/1 prot., dt. 30.12.2021
				<b>27,100,000</b>		
Bashkia Patos	Nr. 93 dt. 19.12.2022 Nr. 2919/2 prot., dt. 22.12.2022	543,737,000	PO	3,000,000	337,584	Nr. 1316/1 prot., dt. 30.12.2022 (konfirmuar)
				<b>3,337,584</b>		
Bashkia Mallakastër	Nr. 70 dt. 20.12.2022 Nr. 4368 prot., dt.21.12.2022	1,087,483,820	PO			Nr. 1302/1 prot., dt. 27.12.2022 (konfirmuar)
				<b>19,123,120</b>		
Bashkia Roskovec	Nr. 98 dt. 23.12.2022 nr. 10978 prot., dt. 27.12.2022	612,497,308	PO			Nr. 02/1 prot., dt. 06.01.2023 (konfirmuar)
				<b>1,500,000</b>		
Bashkia Divjakë		634,502,513	PO			konfirmuar
				<b>7,761,000</b>		
<b>Totali</b>	<b>6</b>		√			√

**Aneksi 2.1**

**Regjistri i realizimeve të prokurimit publik për 01.01.2022 – 31.12.2023**

**a- Regjistri i realizimit viti 2022**

Nr.	Objekti I Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e Kontratës
1	Blerje paisje kompjuterike.	166,667	159,000
2	Kancelari.	137,500	118,120
3	Materiale pastrim dezinfektim,ngrohje/ ndricim.	99,167	99,167
4	Materiale për funksionimin e paisjeve të zyres.	41,667	41,667
5	Të tjera materiale dhe shërbime speciale	330,000	105,000
6	Shërbime të sigurimit dhe të ruajtjes.	3,291,280	3,291,280
7	Shërbime të publikimit dhe printimit.	100,000	99,410
8	Shërbime të tjera.	100,000	52,500
9	Pjesë Këmbimi goma dhe bateri.	99,000	99,167
10	Shpenzime të sigurimit të mjeteve të transporti.	95,000	92,743
11	Shpenzime të tjera transporti.	49,167	38,468
12	Shpenzime për mirembajtjen e paisjeve të zyrave	72,959	68,667
13	Shpenzime per të tjera materiale	100,000	100,000
	<b>Shuma</b>	<b>4,682,407</b>	<b>4,365,189</b>

**b- Regjistri i realizimit viti 2023**

Nr.	Objekti I Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e Kontratës
1	Kancelari	125,000	97,000

<b>Nr.</b>	<b>Objekti I Prokurimit</b>	<b>Fondi Limit</b>	<b>Vlera e Kontratës</b>
2	<i>Materiale pastrim dezinfektim ngrohje/ndricim</i>	162,500	162,333
3	<i>Materiale per funksionimin e paisjeve te zyres</i>	83,333	57,250
4	<i>Furnizime dhe materiale te tjera zyre</i>	19,167	2,000
5	<i>Te tjera materiale dhe sherbimne speciale</i>	30,000	30,000
6	<i>Sherbime te sigurise dhe te ruajtjes</i>	3,291,273	3,146,568
7	<i>Sherbime te printimit dhe publikimit</i>	100,000	99,410
8	<i>Sherbime te tjera</i>	68,333	45,417
9	<i>Pjese Kembimi goma dhe bateri</i>	99,167	76,250
10	<i>Shpenzime te tjera transporti</i>	47,500	40,167
11	<i>Shpenzim per mirembajtjen e objekteve</i>	81,666	54,057
12	<i>Shpenzime per mirembajtje paisje zyresh</i>	54,167	48,833
13	<i>Shpenzime per te tjera materiale</i>	100,000	99,175
14	<i>Rikonstrukcion Godine</i>	1,117,320	1,117,320
15	<i>Blerje paisje kompjuterike</i>	382,680	382,000
	<b>SHUMA</b>	<b>5,762,106</b>	<b>5,457,780</b>

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**